



# PJESËMARRJA E TË RINJVE NË POLITIKË DHE VENDIM-MARRJE NË SHQIPËRI 2011-2015

## STUDIM KOMBËTAR



Tiranë, 2015

© Ky botim i CRCA Shqipëri mund të citohet, fotokopjohet apo printohet, por gjithnjë duke dhënë referencën përkatëse për autorët dhe organizatën. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të shitet apo botohet pa lejen me shkrim të CRCA Shqipëri. Opinionet, mendimet, pikëpamjet dhe informacioni i dhënë në këtë botim jo detyrimisht shprehin opinionet, pikëpamjet apo qëndrimet e CRCA Shqipëri apo ato të Olof Palme International Center ose Qeverisë Suedeze.



**Ky studim u realizua falë mbështetjes së:**



**Autorët:**

**Dr. Fatlinda Berisha  
Irena Shtraza (MA)  
Altin Hazizaj (MA, LLM)**



**Ekipi ndihmës:**

**Blerina Metaj  
Klaudio Pulaha  
Marinela Isuf**

**Referenca e botimit: Berisha F., Hazizaj A., Shtraza I., Pjesëmarrja e të Rinjve në Politikë dhe në Vendim-marrje në Shqipëri 2011-2015, CRCA Shqipëri, 2015.**

**ISBN: 978-9928-4247-2-3**

**© Foto: Kuvendi i Shqipërisë, CRCA Shqipëri.**

# PËRMBAJTJA

Lista e shkurtimeve .....	5
Lista e grafikëve .....	6
Mirënjohje dhe falenderime.....	7
<b>1. Përmbledhje Ekzekutive.....</b>	<b>8</b>
<b>2. Hyrje .....</b>	<b>10</b>
<b>3. Metodologjia.....</b>	<b>13</b>
3.1 Tipologjia e studimit.....	13
3.2 Instrumentet kërkimore dhe mbledhja e të dhënave.....	14
Qasja Sasiore.....	14
Qasja cilësore .....	14
3.3 Popullata e studimit.....	16
3.4 Konsideratat etike.....	17
3.5 Kufizimet e studimit .....	17
<b>4. Të rinjtë shqiptarë: pjesëmarrje dhe përfaqësim i kufizuar në politikë dhe vendim-marrje ...</b>	<b>18</b>
<b>5. Nga lëmosha drejt pjesëmarrjes? Kuadri ligjor dhe statutor për pjesëmarrjen e të rinjve në vendim-marrje dhe në politikë në Shqipëri.....</b>	<b>23</b>
5.1 Shkallët e pjesëmarrjes në vendim-marrje.....	23
5.2 Legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar për pjesëmarrjen e të rinjve në politikë dhe vendim-marrje .....	25
5.3 Politika kombëtare dhe kuadri institucional për nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në politikë dhe vendim-marrje.....	27
5.4 Statutet e Partive Politike dhe pjesëmarrja e forumeve politike të të rinjve në vendim-marrje.....	29
i) Moshë e anëtarësisë në parti dhe forumet politike të të rinjve.....	29
ii) Roli dhe përgjegjësitë e Forumeve Rinore në Partitë Politike në Shqipëri .....	30
iii) Pjesëmarrja dhe përfaqësimi në organet vendim-marrëse vendore të partisë.....	31
iv) Pjesëmarrja dhe përfaqësimi në organet vendim-marrëse qendrore të partisë .....	32
v) Forumet Rinore dhe përfaqësimi i tyre në listat e deputetëve dhe këshilltarëve bashkiakë.....	32
vi) Financimi dhe rregullimi statutor i Forumeve Rinore .....	33
5.5 Matriksi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në vendim-marrje të të rinjve dhe forumeve të tyre në partitë politike në Shqipëri.....	34
<b>6. Analiza e të dhënave: Të rinjtë në vendim-marrje e politikë-bërje në Shqipëri.....</b>	<b>35</b>
6.1 Të dhëna statistikore rreth përfshirjes së të rinjve në vendim-marrje e politikëbërje.....	35
6.1.1 Pjesëmarrja e të rinjve në vendim-marrje e politikë-bërje në nivel qendror në Shqipëri	35
a) Të rinjtë në Kuvendin e Shqipërisë .....	35
b) Të rinjtë në Qeverinë e Shqipërisë .....	36
6.1.2 Pjesëmarrja e të rinjve në vendim-marrje e politikë-bërje në nivel vendor në Shqipëri..	38
a) Të rinjtë në krye të Bashkive .....	38
b) Të rinjtë në këshilla bashkiakë .....	39
c) Ndarja sipas forcave politike e këshilltarëve nën moshën 35 vjeç.....	42
d) Ndarja sipas forcave politike të këshilltarëve djem/burra nën 35 vjeç.....	42
e) Ndarja sipas forcave politike të këshilltarëve vajza/gra nën 35 vjeç .....	43

6.2	<i>Analizë e të dhënave cilësore</i> .....	44
6.2.1	Modele sukcesi të të rinjve në vendim-marrje në nivel qendror e vendor .....	44
	Profil 1: Esmeralda Shkaj.....	45
	Profil 2: Kejdi Mehmetaj.....	46
	Profil 3: Krenar Cenollari .....	47
	Profil 4: Jorida Tabaku .....	48
6.2.2	Të rinjtë në politikëbërje, pjesë të organizmave rinore politike dhe shoqërisë civile.....	49
	a) Pikëpamjet e të rinjve të forumeve rinore të partive politike në lidhje me përfshirjen e të rinjve në politikë e vendim-marrje .....	49
	b) Pikëpamjet e të rinjve të shoqërisë civile në lidhje me përfshirjen e të rinjve në politikë e vendim-marrje.....	55
<b>7.</b>	<b>Praktika të mira të organizatave rinore lidhur me pjesëmarrjen e të rinjve në politikë-bërje e vendim-marrje .....</b>	<b>60</b>
7.1	<i>Bordi Rinor Këshillimor, risia në Bashkinë e Tiranës</i> .....	60
7.2	<i>Iniciativa fuqizuese për të rinjtë nga të rinjtë e Rrjetit Rinor</i> .....	62
7.3	<i>Akses në edukimin seksual gjithëpërfshirës</i> .....	64
7.4	<i>Të rinjtë e Durrësit të përfaqësuar në nivel lokal</i> .....	65
7.5	<i>Përmirësimi i jetës së të rinjve në qytetin e Pukës përmes pjesëmarrjes</i> .....	66
7.6	<i>Ngritja dhe monitorimi i legjislacionit lokal për të rinjtë në qytetin e Vlorës</i> .....	67
7.7	<i>Të rinjtë e zonave informale të Tiranës, aktorë vendim-marrës</i> .....	68
<b>8.</b>	<b>Përfundime .....</b>	<b>69</b>
<b>9.</b>	<b>Rekomandime .....</b>	<b>73</b>
	<b>Referencat .....</b>	<b>77</b>

## Lista e shkurtimeve

CRCA	-	Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri
FR	-	Forum Rinor
FRPP	-	Forume Rinore të Partive Politike
FRPS/FRESSH	-	Forumi Rinor i Partisë Socialiste
FRPD	-	Forumi Rinor i Partisë Demokratike
FRPR	-	Forumi Rinor i Partisë Republikane
FGD	-	Diskutim në Fokus Grup (Focus Group Discussion)
LSI	-	Lëvizja Socialiste për Integrim
LRI	-	Lëvizja Rinore për Integrim
KQZ	-	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
MMSR	-	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
OJF	-	Organizata Jo-Fitimprurëse
OJQ	-	Organizata Jo-Qeveritare
OSHC	-	Organizata të Shoqërisë Civile
OKB	-	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OPIC	-	Olof Palme International Center
PS	-	Partia Socialiste
PD	-	Partia Demokratike
PR	-	Partia Republikane
PBDNJ	-	Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut
PDIU	-	Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet
PDS	-	Partia Demokratike Sociale
PSV 91	-	Partia Socialiste e Vërtetë '91
PDK	-	Partia Demokristiane e Shqipërisë
AD	-	Aleanca Demokratike
PSDSH	-	Partia Socialdemokrate e Shqipërisë
PKVR	-	Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë

## Lista e grafikëve

- Grafiku 1.** Roli i Forumeve rinore sipas partive politike në Shqipëri
- Grafiku 2.** Pikëzimi i Forumeve Politike Rinore sipas rolit të tyre në parti
- Grafiku 3.** Të rinj në Qeverinë Shqiptare – Mars, 2015
- Grafiku 4.** Zëvendës Ministra në Qeveri, Mars 2015
- Grafiku 5.** Deputetë të rinj në Parlamentin e zgjedhur në 23 Qershor 2013, e përditësuar sipas ndryshimeve deri në Mars 2015
- Grafiku 6.** Deputetë të rinj sipas gjinisë në Parlamentin e zgjedhur në 23 Qershor 2013, e përditësuar sipas ndryshimeve deri në Mars 2015
- Grafiku 7.** Të rinj në krye të Bashkive në rang vendi
- Grafiku 8.** Mosha e këshilltarëve në Këshillat Bashkiakë në Shqipëri
- Grafiku 9.** Numri i këshilltareve vajza/gra në Këshillat Bashkiakë të Shqipërisë shprehur në %
- Grafiku 10.** Numri i grave dhe vajzave anëtare të Këshillave Bashkiakë e krahasuar me burrat në Këshilla
- Grafiku 11.** % e grave dhe vajzave anëtare të Këshillave Bashkiakë e krahasuar me burrat
- Grafiku 12.** Mosha e këshilltarëve meshkuj në Këshillat Bashkiakë 2011-2015 (në %)
- Grafiku 13.** Forca politike e këshilltarëve nën 35 vjeç 2011-2015 (në Nr.)
- Grafiku 14.** Forca politike e këshilltarëve djem/burra nën 35 vjeç 2011-2015 (në Nr.)
- Grafiku 15.** Forca politike e këshilltareve vajza/gra nën 35 vjeçe 2011-2015 (në Nr.)

## Mirënjohje dhe falenderime

Studimi *"Pjesëmarrja e të rinjve në politikë dhe vendim-marrje në Shqipëri"*, u bë i mundur falë mbështetjes së Olof Palme International Centre (OPIC) me financim të Qeverisë Suedeze. CRCA dhe OPIC, që prej vitit 2006, i janë dedikuar avancimit të të drejtave politike të grave dhe të rinjve. Së bashku ne kemi ngritur një sërë modelesh dhe praktikash të avancimit të grave dhe vajzave, të grupeve të marginalizuara dhe atyre të përfaqësuar. Në këtë aspekt kishte ardhur koha që ne të mbështesim realizimin e këtij studimi, si një përpjekje për të patur një tablo të plotë të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të të rinjve në politikëbërje dhe vendim-marrje, si një ndër grupet sociale më të mëdha në Shqipëri.

CRCA dhe ekipi i studjuesve dëshirojnë të falenderojnë përzemërsisht të gjithë anëtarët e stafit të organizatës dhe ekipin ndihmës që u përfshinë në procesin e konsultimeve me grupet rinore, e që mundësuan dhe lehtësuan mbledhjen e informacionit nga organizatat rinore në vend, pushteti vendor dhe ai qëndror. Pa ndihmën e tyre, realizimi i këtij studimi do kishte qenë i pamundur.

Në mënyrë të veçantë ne do të deshëm të falenderojmë të gjitha partitë politike parlamentare në Shqipëri, të cilat ndanë me ne një kopje të statuteve të tyre; Forumet Politike Rinore që u përfshinë në procesin e konsultimit dhe fokus-grupeve si dhe që konsultuan herë pas here të dhëna specifike në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë e tyre brenda partive politike; dhe së fundi, të gjithë organizatat anëtare të Lidërshiptit të të Rinjve në Tiranë, që morën pjesë në mënyrë aktive në të gjitha fokus-grupet dhe konsultimet që u organizuan për qëllimet e këtij studimi.

CRCA Shqipëri falenderon në mënyrë të veçantë znj. Fatlinda Berisha, znj. Irena Shtraza dhe z. Altin Hazizaj për përgatitjen e këtij studimi, që është i pari i këtij lloji në Shqipëri dhe që përmban të dhëna të detajuara për pjesëmarrjen e të rinjve në të gjitha nivelet e vendim-marrjes, të dhëna të cilat asnjëherë nuk janë publikuar më parë në Shqipëri.

Ne dëshirojmë që gjetjet dhe konkluzionet e këtij studimi të ndihmojnë së pari, partitë politike në Shqipëri në procesin e rishikimit të statuteve të tyre, në mënyrë që pjesëmarrja dhe përfaqësimi i të rinjve, të jetë një proces i gjerë dhe me pjesëmarrje; së dyti, ne nxisim forumet politike të të rinjve të të gjitha partive politike, por edhe organizatat e shoqërisë civile të të rinjve, që t'i përdorin këto të dhëna për të ndërtuar aksione avokatësie, të cilat mund të sjellin përmirësime serioze të rolit, të drejtave dhe pozicionit që të rinjtë duhet të kenë brenda partive politike dhe ndër-veprimit të tyre me shoqërinë civile, për ta kthyer pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e të rinjve në vendim-marrje dhe politikë në një proces sa lokal aq edhe kombëtar.

### CRCA Shqipëri

## 1. Përmbledhje Ekzekutive

Pavarësisht se të rinjtë nën-moshën 25 vjeç përbëjnë gjysmën e popullsisë në shumë vende në zhvillim dhe 1 të 5-tën e popullsisë në botë, pjesëmarrja e të rinjve në politikë dhe në vendim-marrje mbetet në nivele shumë të ulta. Të dhënat globale tregojnë se vetëm 1.65% e Parlamentarëve të të gjitha vendeve janë rreth moshës 20 vjeç dhe vetëm 11.87% e tyre janë deri në moshën 30 vjeç. Ndërkohë, mosha mesatare e deputetëve që janë pjesë e Parlamenteve në të gjithë botën është rreth 53 vjeç për burrat dhe 50 vjeç për gratë. Kjo situatë sfidon përfaqësuesit e sistemit politik dhe mund të çojë drejt ndarjes apo fragmentizimit të qytetarëve tanë të rinj. Për më tepër, kjo bën që të përforcohen stereotipet që i kategorizojnë të rinjtë si njerëz të pa-interesuar për çështje politike, apo thjesht si objekte të politikave sociale.

Të rinjtë janë në zemër të asaj që shumë studiues e quajnë si “kriza e përfaqësimit në demokraci”. Numri i ulët i të rinjve që votojnë për Parlamentin Europian, në Evropën Perëndimore ose në zgjedhjet lokale në Evropën Qëndrore dhe Lindore, ulja e numrit të të rinjve në institucione tradicionale si partitë politike, organizatat tregtare e madje edhe organizatat rinore në Evropën Perëndimore dhe Jug-Lindore, në krahasim me fund vitet ‘80 dhe fillim vitet ‘90, janë të gjitha shenja të akumulimit të problemeve në lidhje me pjesëmarrjen politike të të rinjve.

Në të gjitha vendet post-komuniste, rinia ka luajtur një rol të rëndësishëm në ndryshimin e sistemit, nga ai mono-partiak drejt sistemit pluri-partiak. Në tre dekadat e fundit çështjet e të rinjve janë parë nën këndvështrimin e problemit, ku rinia është përballur me sfida që erdhën bashkë me demokracinë, si papunësia, pabarazitë, përjashtimi social, problemet e varësisë, etj. Edhe në vendin tonë post-komunist e me demokraci të brishtë, situata e të rinjve, paraqitet problematike, sidomos kur vjen fjala për pjesëmarrje dhe vendim-marrje të vërtetë, si pranë partive politike, ashtu edhe në radhët e shoqërisë civile. Të dhënat për rininë rrallë janë renditur nën indikatorët e fuqizimit dhe janë kufizuar në nisma sporadike të shoqërisë civile, pa ofruar asnjëherë një panoramë të plotë të pjesëmarrjes së tyre reale në nivele të ndryshme të vendim-marrjes dhe politikëbërjes.

Ky studim sjell një kontribut të parë dhe të vetëm, i cili rendit *të dhëna sasimore dhe cilësore të mbledhura nga disa nivele të vendim-marrjes në Shqipëri*, duke filluar me panoramën e pjesëmarrjes së të rinjve në qeverinë dhe parlamentin Shqiptar, në qeverisjen lokale (bashki dhe këshilla bashkiakë) bazuar në rezultatet e zgjedhjeve vendore të vitit 2011 dhe te vitit 2015, në partitë politike dhe forumet rinore të tyre dhe duke e përmbyllur me pjesëmarrjen e të rinjve në organizatat e shoqërisë civile.

Sipas të dhënave të mbledhura e të analizuara në këtë studim, **ndër gjetjet kryesore** mund të përmendim:

- Shqipëria ka ndërtuar një *imazh deri diku pozitiv në drejtim të përgatitjes së politikave kombëtare për të rinjtë*, përfshi edhe pjesëmarrjen e tyre në politikë dhe vendim-marrje, por ndonëse janë bërë hapa përpara në drejtim të demokratizimit të jetës së saj politike, këto hapa nuk janë shoqëruar me nisma ligjore për të mbështetur pjesëmarrjen e të rinjve;
- Të gjitha partitë politike në Shqipëri, në *statutet e tyre parashikojnë role dhe përgjegjësi specifike për forumet rinore*, pavarësisht se në disa prej tyre këto funksione janë të limituata



apo në raste të tjera të vendosura nëpërmjet zbatimit të kuotave. Roli i forumeve vjen duke u zvogëluar kur vjen puna tek përfshirja e të rinjve në pozicione vendim-marrëse brenda partisë apo në nivel qendror dhe vendor;

- *Numri i të rinjve në nivelin qendror dhe ekzekutiv të qeverisjes mbetet ende i vogël, vetëm 7.1% në nivelin e përfaqësimit në Legjislativin Shqiptar (parlament). Në nivelin lokal të përfaqësimit, pavarësisht se shumica e kryetarëve të bashkive vazhdojnë të jenë mbi moshën 35 vjeç, përsëri zgjedhjet vendore të vitit 2015 shënuan një rritje të rëndësishme të të rinjve nën-moshën 35 vjeç për antarë të Këshillave Bashkiakë;*

- *Përqindja e të rinjve pjesë e vendim-marrjes në partitë politike është mjaft e ulët, pasi shumica e partive nuk e kanë të sanksionuar të drejtën e përfaqësimit të të rinjve. Kështu ata privohen nga mundësia për të patur rol pro-aktiv dhe influencuar ligjet, politikat dhe programet e reja, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel lokal. Ndërkohë ndarja gjinore e kësaj përqindjeje mbetet e pakënaqshme dhe ndryshon nga partia në parti;*

- *Varësia financiare dhe mospasja e burimeve të mjaftueshme të financimit është një fakt shqetësues për çdo Forum Rinor. Mungesa e buxhetit është një pikë nevralgjike për fuqizimin e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të të rinjve në vendim-marrjen e brendshme të partive;*

- *Çështjet e të rinjve jo gjithmonë marrin vëmendjen që meritojnë nga strukturat vendim-marrëse e politikëbërëse, si kryesitë e partive, parlament, qeveri, dhe këshilla bashkiakë dhe ky përbën një fakt mjaft shqetësues. Nga ana tjetër, organizimi i vetë të rinjve për kauzën e tyre është shumë i vakët, si për shkëmbimin e informacionit, ashtu edhe për koordinimin e aksionit në lidhje me çështjet e të rinjve;*

- *Të rinjtë shpesh angazhohen në shoqërinë civile si një urë drejt vendim-marrjes e politikëbërjes. Përfshirja e të rinjve në vendim-marrje shpesh pengohet nga filozofia e anëtarëve tradicionalë të partive politike, sepse të rinjtë shihen si pa përvojë.*

Për të ndryshuar situatën e të rinjve dhe për të rritur pjesëmarrjen e tyre në nivele të ndryshme të vendim-marrjes e politikëbërjes, në fund të këtij studimi janë renditur ***një sërë rekomandimesh*** për kuvendin, qeverinë, strukturat politikëbërëse e vendim-marrëse brenda partive politike, në nivel vendor dhe qendror, por edhe për vetë të rinjtë e forumeve rinore të partive politike e organizatave rinore të shoqërisë civile.

*Mes rekomandimeve kryesore gjejmë: Nevoja për miratimin e ligjeve “për Rininë” dhe për “Vullnetarizmin”; Vendosja e një kuote minimum prej 20% për të rinjtë në Kodin Zgjedhor; Përfshirja shumë më e përqëndruar e çështjeve dhe problematikave rinore në axhendën parlamentare; Krijimi i Aleancës së Deputetëve të Rinj; Alokimi i të gjitha fondeve që kërkohen për të bërë të mundur zbatimin e PKVR 2015-2020<sup>1</sup>; Vendosja e kuotave rinore për çdo strukturë drejtuese dhe vendim-marrëse brenda partive; gjetjen dhe zbatimin e modeleve të reja të financimit të forumeve politike të të rinjve; transformimi i FRPP-ve në struktura fuqizuese e motivuese për të rinjtë; krijimi i një organizmi për të bërë bashkë zërin rinor të të gjithë FRPP-ve; Përmirësimi i klimës dhe diskursit politik; etj.*

---

<sup>1</sup> Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, VKM 383, datë 06.05.2015, Fletore Zyrtare Nr. 79, viti 2015.

Të gjithë aktorët së bashku, nëse përfshijnë në axhendën e tyre edhe çështjet e rinisë dhe harmonizojnë aksionin për të rritur pjesëmarrjen reale të të rinjve në politikë e vendim-marrje do të sillnin një ndryshim që nuk i takon vetëm të rinjve, por që rrit demokracinë dhe klimën e bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe të gjitha hallkave që i përfaqësojnë ata.

Është shumë e rëndësishme të kuptojmë që ndryshimet politike të pranishme në mesin e brezave të rinj sot, do të kenë pasoja afatgjata në të ardhmen e demokracisë nesër. Për shkak se të rinjtë po e 'zbulojnë' politikën në një periudhë përfshirjeje të cunguar, mosbesimi, proteste dhe abstenimi në rritje, këto parametra të reja të marrëdhënieve të tyre me politikën do të vazhdojnë të ndikojnë qëndrimet dhe sjelljet e tyre të ardhshme<sup>2</sup>.

## 2. Hyrje

Pjesëmarrja në vendim-marrje është një term i gjerë që përfshin disa kuptime të pjesëmarrjes direkte të qytetarëve në jetën politike, ekonomike, sociale dhe shumë fusha të tjera. Idealisht, pjesëmarrja në vendim-marrje kërkon që çdo aktor të ketë zërin e tij/saj në vendimet që ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në jetën e tij/saj. Kjo formë qeverisjeje fuqizon në këtë mënyrë vetë qytetarët, duke u dhënë atyre kontroll dhe duke e bërë marrjen e vendimeve dhe zbatimin e tyre më të qëndrueshëm.

*Rinia është ajo që bën revolucionin, që ndërton të ardhmen e që ndihmon zhvillimin* (Bell, et al. 2008). Nismat rinore janë një pjesë e rëndësishme në përfshirjen direkt të tyre dhe angazhimin qytetar në komunitet. Iniciativat e ndërmarra nga të rinjtë i lejojnë ata që të jenë të përfshirë në mënyrë aktive dhe të drejtpërdrejtë në punën në komunitetet e tyre lokale dhe për këtë arsye janë një trampolinë për pjesëmarrje dhe angazhim qytetar. Pjesëmarrja aktive e të rinjve në vendimet dhe veprimet në nivel lokal dhe më gjerë është thelbësore në qoftë se ne duhet të ndërtojmë një shoqëri më demokratike dhe më përfshirëse. Por politikat lokale dhe qëndrore jo domosdoshmërisht konsultohen, zhvillohen apo zbatohen *me* dhe *nga* vetë të rinjtë. Pavarësisht se në bazë të legjislacionit në fuqi, në qeverisjen lokale duhet të ekzistojnë komitete qytetare, faktet tregojnë se këto komisione janë fiktive dhe në shumë raste e drejta e të rinjve për të marrë pjesë në to mbetet vetëm në letër. Përvoja tregon se kjo mungesë e pjesëmarrjes aktive, dëmton interesat e të rinjve dhe e bën zërin e tyre jo-ekzistent.

Ndryshimi i formës së angazhimit qytetar dhe politik, kushtëzohet nga konteksti i ndryshueshëm socio-ekonomik i vendeve. Në këtë këndvështrim, jeta e të rinjve është ndryshuar thelbësisht në dekadat e fundit. Autorët e fushës akademike, veçanërisht sociologët, kanë adresuar ndryshimet sociale që prekin qytetarët (e rinj), në shoqëritë demokratike. Sipas tyre, jeta e të rinjve është përcaktuar më pak nga strukturat tradicionale sociale dhe më shumë nga *zgjedhja* dhe *risku* (Furlong & Cartmel, 2007), ndryshime këto që ndikohen dhe reflektojnë tranzicionin nga rinia drejt pjekurisë (Arnett, 2004). Duke qenë se qytetarët e vendeve me demokraci të re janë të prirur më tepër drejt përmirësimit të

---

<sup>2</sup> Youth and Politics: Towards a new model of citizenship in advanced democracies, (fq. 26-27). [http://pjp-eu.coe.int/documents/1017981/8422373/26\\_chapter\\_3.pdf/36718682-8625-41c4-8082-9b1fdc2f9db8](http://pjp-eu.coe.int/documents/1017981/8422373/26_chapter_3.pdf/36718682-8625-41c4-8082-9b1fdc2f9db8)

kushteve të jetës së tyre (Giddens, 1991) edhe pjesëmarrja qytetare dhe politike është vënë në funksion të ndryshimeve socio-ekonomike që kanë ndikuar edhe në ndryshimin e vlerave.

Pjesëmarrja e të rinjve në sferat me ndikim të lartë shoqëror, në shoqëritë post-komuniste është orientuar në drejtime të ndryshme, që lidhen me kontekstin kulturor dhe qëllimet e këtyre shoqërive. Nën diktaturën komuniste, pjesëmarrja e të rinjve ishte e sanksionuar dhe e drejtuar nga mono-partitizmi politik. Aktivizmi rinor që kontribuoi në rënien e regjimit komunist, nuk funksionoi për kohë të gjatë dhe aktualisht mund të themi se pjesëmarrja e të rinjve në vendet post-komuniste, nuk është në nivelet e kërkuara nga Bashkimi Evropian (veçanërisht për ato vende të cilat janë Kandidate të afërta të BE)<sup>3</sup> (Kovachev, 2000).

Në të gjitha vendet post-komuniste, rinia ka luajtur një rol të rëndësishëm në ndryshimin e sistemit, nga ai mono-partiak drejt sistemit pluri-partiak. Në tre dekadat e fundit çështjet e të rinjve janë parë nën këndvështrimin e problemit, ku rinia është përballur me sfida që erdhën bashkë me demokracinë, si papunësia, pabarazitë, përjashtimi social, problemet e varësisë, prostitucioni, etj. Rinia e këtyre vendeve është orientuar fort drejt konsumizmit, është ndikuar nga liria e veprimit dhe kaosi që shoqëron zhvillimet demokratike (Mitev & Riordan, 1996; et al, 1998). Edhe ndryshimet në sferën e përfshirjes politike të të rinjve, nuk kanë kaluar pa lënë shenjë, në formimin e brezave post-komunistë. Në vitet e para post-komuniste, të rinjtë tentonin të mbështesnin partitë pro-demokratike, ndërkohë që sot, brezat e rinj janë më të lirë në zgjedhjet e tyre politike, e madje këto zgjedhje janë shpesh të ndikuara nga pragmatizmi personal apo familjar.

Koncepti i përfshirjes rinore ka evoluar, nga *rinia si problem* (rinia vulnerabël, në vështirësi, e përjashtuar; rinia që përballlet me varfërinë, kufizimet në edukim, forma të ndryshme diskriminimi dhe mundësi të kufizuara punësimi), *drejt rinisë si burim* (dimensioni i adresimit të rinisë si burim ndryshimi dhe force) siç përmendet edhe në Dokumentin e Bardhë të BE, 2001. Rinia sot, adresohet në politika rinore si burim i fuqishëm i një force kreative dhe inovative, që ndikon politikën, përmes pjesëmarrjes, si një katalizator i rëndësishëm në sistemet politike dhe mundësitë ekonomike.

Sidoqoftë *situata e pjesëmarrjes së të rinjve mbetet problematike*, kur vjen fjala për pjesëmarrje dhe vendim-marrje të vërtetë, si pranë partive politike, ashtu edhe në radhët e shoqërisë civile. Të dhënat për rininë rrallë i gjejmë të renditura nën indikatorët e fuqizimit dhe janë të kufizuara në nisma sporadike të shoqërisë civile, pa ofruar asnjëherë një panoramë të plotë të pjesëmarrjes së tyre reale në nivele të ndryshme të vendim-marrjes dhe politikëbërjes. Ndaj, ne besojmë se **ky studim sjell një kontribut të parë dhe të vetëm**, i cili rendit të dhëna të mbledhura nga disa nivele të vendim-marrjes e politikëbërjes në Shqipëri.

Dëshirojmë që ky studim të jetë një mjet *për të rritur ndërgjegjësimin në mesin e të rinjve për të drejtat dhe mundësitë* që ata kanë për të marrë pjesë në politikëbërje dhe në proceset vendim-marrëse. Gjithashtu, shpresojmë të shërbejë si *një kujtesë për politikanët, vendim-marrësit dhe zyrtarët publik* lidhur me detyrimin e tyre për të zbatuar politikat ekzistuese për të siguruar pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e të rinjve në të gjitha nivelet.

---

<sup>3</sup> Kovachev, S., (2000). *Keys to youth participation in Eastern Europe*. Council of Europe

Studimi "Pjesëmarrja e të rinjve në politikë dhe vendim-marrje në Shqipëri" si i pari në llojin e vet, *synon të bëjë një analizë të mundësive që kanë aktualisht të rinjtë shqiptarë për të marrë pjesë dhe të përfaqësohen në strukturat qendrore dhe vendore vendim-marrëse, si dhe në partitë politike*. Kjo analizë i ngre bazat në legjislacionin shqiptar dhe politikat që mundësojnë pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e të rinjve në politikë dhe vendim-marrje, në aspektin teorik.

Studimi gjithashtu *synon të masë nivelin real të pjesëmarrjes së të rinjve në politikëbërje* nëpërmjet aktivizimit në mekanizma konsultativë si borde, këshilla, etj. Përpos kësaj, synohet të hulumtohet edhe rreth përfaqësimit të tyre aktual në strukturat vendim-marrëse, të tilla si parlamenti, qeveria, bashki, këshillat e bashkive, partitë politike etj, duke bërë më pas një krahasim në mes asaj që është shkruar dhe promovuar në letër dhe zbatimit të tyre në praktikë.

Në këtë studim do të gjeni gjithashtu *disa modele pozitive* lidhur me pjesëmarrjen e të rinjve në politikë e vendim-marrjen qendrore e vendore, si dhe *një sërë praktikash të mira politikëbërëse*, të zbatuara nga organizatat rinore të shoqërisë civile.

Në mbyllje, theksojmë se ka pasur në këto dekada një ndryshim të thellë politik në dinamikën mes gjeneratave dhe të vetë procesit të shoqërizimit. Qytetarët e ardhshëm nuk do të jenë qytetarët e të djeshmes. Ata me shumë gjasa do të jenë më kritikë, më shumë të prirur që të abstenojnë, më shumë të gatshëm për të protestuar, më të sofistikuar dhe do të kenë më pak besim në politikë. Në këtë kuptim, ekziston vërtet një hendek i qartë mes gjeneratave. Prandaj, transformimet që vërehen sot do të kenë një ndikim jo vetëm në mënyrën se si politika praktikohet dhe shprehjen e zgjedhjeve politike, por edhe më gjerë ato do të ndryshojnë të ardhmen e demokracisë<sup>4</sup>. Më shumë të rinj në politikë e vendim-marrje sot, do të thotë demokraci më e konsoliduar dhe politikë më e mirëbesuar nesër.

*Shënim:* Dëshirojmë të cilësojmë se, **përkufizimi "të rinj"** ndryshon në varësi të rrethanave nga një shtet në tjetrin, veçanërisht në varësi të ndryshimeve demografike, financiare, ekonomike dhe socio-kulturore. Megjithëse përkufizimi që përdoret nga Kombet e Bashkuara<sup>5</sup> për qëllime statistikore lidhur me vlerësimin e nevojave dhe sigurimin e udhëzimeve për zhvillim të të rinjve përfshin grupmoshën 15-24 vjeç, për disa organizma moshë kufizuese për termin "të rinj" shkon deri në moshën 35 vjeç. Duke marrë në konsideratë faktin se moshë mesatare e popullsisë shqiptare është 35 vjeç (*Census, 2011*) dhe pjesëmarrjen e ulët të të rinjve në vendim-marrje e politikëbërje në Shqipëri, ky studim konsideron si "të rinj" grupmoshën më të gjerë, nga 15 deri 35 vjeç.

---

<sup>4</sup> Muxel, A. *Youth and politics: towards a new model of citizenship in advanced democracies*, (fq. 26-27). [http://pjp-eu.coe.int/documents/1017981/8422373/26\\_chapter\\_3.pdf/36718682-8625-41c4-8082-9b1fdc2f9db8](http://pjp-eu.coe.int/documents/1017981/8422373/26_chapter_3.pdf/36718682-8625-41c4-8082-9b1fdc2f9db8)

<sup>5</sup> <http://www.un.org/esa/socdev/documents/youth/fact-sheets/youth-definition.pdf>

### 3. Metodologjia

Qëllimi i këtij studimi është të masë nivelin real të pjesëmarrjes së të rinjve në politikëbërje dhe të hulumtojë rreth përfaqësimit të tyre aktual në strukturat vendim-marrëse e politikëbërëse në Shqipëri, bazuar tek rezultatet e Zgjedhjeve Vendore të vitit 2011, Zgjedhjeve Parlamentare të vitit 2013 dhe Zgjedhjeve Vendore të Qershorit 2015. Ky kapitull ofron një këndvështrim të detajuar mbi metodat e përdorura në këtë studim, në funksion të objektivave dhe qëllimit të kërkimit, duke përshkruar popullatën e studimit, metodat e analizës së të dhënave, konsideratat etike dhe kufizimet e tij.

#### 3.1 Tipologjia e studimit

Ky studim synon të masë nivelin real të pjesëmarrjes së të rinjve në politikëbërje dhe të hulumtojë rreth përfaqësimit të tyre aktual në strukturat vendim-marrëse, nëpërmjet analizës dytësore të të dhënave statistikore, bazuar në treguesit e listës së moshës së të zgjedhurve të Kuvendit të Shqipërisë, kryetarëve/eve të njësive vendore dhe të rinjve në kryesinë e Partive Politike parlamentare.

Për të përmbushur qëllimin dhe objektivat e këtij kërkimi dhe për të adresuar pyetjet kërkimore të studimit, është përzgjedhur një përfaqëse metodologjike mikse (e përzier). Përmes përdorimit të metodës mikse, studimi krijon kuptueshmëri më gjithpërfshirëse mbi fushën studimore, gjë që nuk do të arrihej vetëm me përdorimin e një metode (Creswell dhe Plano Clark, 2007). Për më tepër, ndërthurja e të dy metodave, asaj sasiore dhe cilësore, na tregon sesi natyra kontekstuale e të dhënave cilësore, mund të përdoret për të plotësuar përfaqësueshmërinë dhe për të përgjithësuar gjetjet sasiore (Greene & Caracelli, 2003).

Termi metoda mikse perkufizohet si procedura e mbledhjes, analizës dhe integritit të të dhënave sasiore dhe atyre cilësore në një qëllim të përgjithshëm kërkimor (Bryman, 2006<sup>6</sup>; Tashakkori & Creswell, 2007). Përmes përdorimit të kësaj qasje kërkimore, është realizuar edhe procesi i trekëndëzimit të informacionit, ku përmes trekëndëzimit metodologjik, përdorimit të metodës cilësore për të eksploruar gjetjet sasiore, u fitua më shumë kuptueshmëri mbi gjetjet e studimit. Përdorimi i saj na lejon, që gjetjet nga një metodë të bien në kontrast me ato të një metode tjetër, gjë e cila përbën krahasim midis metodash dhe krijon mundësinë e kontrollit të informacionit nga studjuesit, duke bërë të mundur që gjetjet të mund (i) të vërtetohen duke krahasuar të dhënat të përfuara nga burime të ndryshme dhe (ii) të plotësohen duke shtuar diçka të re dhe të ndryshme nga një metodë në një tjetër.

---

<sup>6</sup>Bryman, A. (2006). Integrating quantitative and qualitative research: How is it done? *Qualitative Research*, 6(1), 97–113.

## 3.2 Instrumentet kërkimore dhe mbledhja e të dhënave

**Rishikim dokumentash e raportesh** - Në fazën e parë të studimit u rishikuan një sërë dokumentash në lidhje me përfshirjen e të rinjve dhe situatën aktuale të tyre në vendim-marrje dhe politikëbërje në Shqipëri e më gjerë. Kjo fazë e studimit u përqëndrua gjithashtu në shqyrtimin e dokumentave dhe kuadrit ligjor për rininë. Pjesë e kësaj analize janë gjithashtu edhe treguesit dhe gjetjet nga analiza, raporte vlerësimi dhe studime kombëtare e ndërkombëtare në këtë fushë.

Të dhënat për këtë studim u mblodhën në periudhën Janar-Mars 2015. Siç u përmend edhe më sipër, për të hulumtuar këtë fushë studimore, u përdorën 2 qasjet kërkimore, (i) qasja sasiore dhe (ii) qasja cilësore.

### Qasja Sasiore

**Analiza dytësore e të dhënave/statistikave** ekzistuese mbi moshën dhe gjininë e të zgjedhurve të Kuvendit të Shqipërisë dhe atyre vendorë. Ky komponent i studimit u përdor për të analizuar nivelin real të pjesëmarrjes së të rinjve në politikëbërje në Shqipëri. Për këtë studim u përdorën të dhëna publike të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ), si dhe të dhëna në lidhje me këshilltarët dhe kryetarët e bashkive të marra nga partitë politike parlamentare në Shqipëri.

Në këtë studim janë analizuar treguesit që i referohen të dhënave ekzistuese mbi moshën e të zgjedhurve në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2013 dhe të zgjedhurve vendorë në vitin 2011 dhe 2015. Duke qenë se statistikave ekzistuese ishin të formave të ndryshme dhe jo në funksion të qëllimit të këtij studimi, të dhënat u rihodhën dhe u analizuan pas pastrimit nga variabla jo në rëndësi të këtij studimi, duke identifikuar përqindjet reale të pjesëmarrjes së të rinjve në parlament dhe në qeverisjen vendore.

### Qasja cilësore

#### Fokus grupet me të rinj

**a. Përfaqësues të forumeve rinore të partive politike (FRPP).** FGD-të kishin si qëllim të merrnin informacion në lidhje me përfshirjen reale të të rinjve në vendim-marrjen brenda partive të tyre politike, marrëdhëniet me strukturat e tjera të partive, bashkëpunimin e të rinjve me njëri tjetrin, si dhe diskutime në lidhje me mënyrën sesi mund të ndërhyhet për të përmirësuar situatën e të rinjve në vendim-marrje dhe politikëbërje brenda dhe jashtë partisë. Grupi i punës hartoi një udhëzues i cili u përdor gjatë realizimit të FGD-ve, me qëllim ruajtjen e strukturës së ngjashme nga një fokus grup tek tjetri. FGD me anëtarët e FRPP-ve u zhvilluan në mjediset e organizatës zbatuese, ndërkohë që FGD me liderët e FRPP-ve parlamentare u zhvillua në një sallë neutrale. Gjatë zhvillimit të FGD-ve u krijuan dinamika mjaft interesante, përmes së cilave u identifikuan edhe vështirësitë me të cilat të rinjtë përballen, porë kjo nga këndvështrimi personal i pjesëmarrësve në FGD. Në total, u zhvilluan 2 FGD me këtë grup të synuar dhe kishin përfaqësim nga i gjithë spektri i partive më kryesore në vend, kryesisht parti parlamentare. Mungesa e një përfaqësuesi nga kryesia e FR të Partisë Demokratike në FGD-në me liderët e PP-ve parlamentare, u adresua nëpërmjet një interviste të mëvonshme ku u diskutuan të njëjtat çështje sipas udhëzuesit përkatës. Për

realizimin e FGD-ve u ndërtua një udhëzues me pyetje të hapura të cilat u përdorën në secilin prej FGD-ve të realizuara (*shih shtojcën 1*).

**b. Përfaqësues të shoqërisë civile** (organizma të angazhuar në adresimin e çështjeve të të rinjve). Këto FGD kishin si qëllim marrjen e informacioneve në lidhje me qëndrimin e të rinjve, të cilët janë jashtë politikës, por që kontribuojnë në një mënyrë apo një tjetër në kauzat e të rinjve.

FGD- të me të rinjtë e shoqërisë civile u zhvilluan në mjediset e organizatës zbatuese. FGD- të zgjatën nga 80-120 minuta secili. Ato u regjistruan me audio dhe u zbardhën brenda 24 orëve të para vijuese. Gjatë zhvillimit të tyre u mbajtën edhe shënimet përkatëse për identifikimin e disa prej temave, çështjeve dhe nënçështjeve. Për realizimin e FGD-ve u ndërtua një udhëzues me pyetje të hapura të cilat u përdorën në secilin prej FGD-ve të realizuara (*shih shtojcën 2*).

**Intervista gjysëm të strukturuar me persona të identifikuar** si të suksesshëm në politikëbërje dhe vendim-marrjen e partive politike. U përfshinë ata subjekte që ishin të zgjedhur në Parlamentin e Shqipërisë apo në krye të njësive vendore në momentin e studimit dhe që në kohën e zgjedhjes së tyre ishin më të rinj se 35 vjeç. Subjektet u identifikuan, u kontaktuan nga grupi i projektit dhe u informuan në lidhje me studimin dhe rolin e tyre. Në takimin paraprak u vendos koha e takimit të ardhshëm për zhvillimin e intervistës. Intervistat u realizuan në mjedise neutrale. Për realizimin e intervistave u ndërtua një udhëzues me pyetje të cilat u përdorën në secilën prej intervistave të realizuara (*shih shtojcën 3*).

Intervistat zgjatën nga 60-90 minuta dhe u realizuan në kohën që u përcaktua si më e përshtatshme për të intervistuarit, përfshirë mëngjeset, pasditet e vona apo fundjavat. Në asnjë prej intervistave nuk kishte ndërprerje gjatë zhvillimit të bisedës. Intervistat u regjistruan dhe u transkriptuan brenda 24 orëve nga realizimi i tyre nga vetë studjuesit. Për regjistrimin e intervistave u mor leja e vetë subjekteve të intervistuar.

**Skedat e praktikave të mira në politikëbërje** kishin si qëllim të merrnin përvojat e suksesshme të organizatave që punojnë në fushën e të rinjve, lidhur me angazhimin e grupeve të të rinjve në procese politikëbërëse e vendim-marrëse. Qëllimi i Skedës së Praktikave të Mira ishte marrja e përvojës së atyre organizatave që kanë arritur një ndryshim në një fushë të praktikës nga e cila ndikohen të rinjtë. Përmes këtyre skedave është identifikuar aksioni i suksesshëm i organizatave dhe kjo praktikë është pasqyruar, si model për organizata të tjera të të rinjve. Këto skeda u shpërndanë tek organizatat rinore të shoqërisë civile në të gjithë Shqipërinë dhe ishin me vetë-administrim. Kjo skedë u hartua në formën e një pyetësi, në përbërje të së cilit kishte edhe pyetje të mbyllura dhe të hapura (*shih shtojcën 4*). Skeda e Praktikave të Mira u shpërnda elektronikisht tek organizatat e synuara dhe u plotësuan elektronikisht prej disa prej tyre, për t'u dorëzuar më pas tek ekipi i studjuesve për analizë dhe përdorim në këtë studim.

**Vëzhgimi i Statuteve të partive politike në Shqipëri** kishte si qëllim njohjen më nga afër me “kushtetutën” e çdo partie politike parlamentare në Shqipëri, për të parë nga afër se cili është roli dhe përgjegjësia që kanë organizatat / forumet politike të të rinjve dhe çfarë të drejtash dhe funksionesh luajnë ato brenda partisë. Po ashtu vëzhgimi ligjor pati si qëllim që të identifikonte masat lehtësuese, që statutet e partive zbatojnë, për të bërë të mundur mbështetjen dhe fuqizimin e forumeve rinore politike dhe vetë të rinjtë që aderojnë në

partitë politike. Studimi arriti të sigurojë kopjet e statuteve të partive politike parlamentare në Shqipëri dhe bazuar tek të dhënat e gjetura ndërtoi një matricë krahasuese të pjesëmarrjes, rolit dhe përgjegjësive të të rinjve dhe forumeve të tyre brenda çdo force politike.

### 3.3 Popullata e studimit

Popullata e këtij studimi ishin të rinj shqiptarë, deri në moshën 35 vjeç, të cilët janë pjesë e partive politike, forumeve rinore të tyre si dhe pjesë e shoqërisë civile që punojnë për të rinjtë, në të gjitha fushat e praktikës. Sipas metodës së përdorur, më poshtë paraqitet popullata konkrete e targetuar sipas secilit instrument të kërkimit.

**Analiza dytësore e të dhënave:** kampioni i këtij komponenti të studimit, ishin të gjithë të rinjtë e përfshirë në listat e partive politike (të zgjedhur nga listat e partive politike të vitit 2013 dhe të zgjedhurit vendorë të vitit 2011). Lidhur me të zgjedhurit vendorë, duke marrë në konsideratë riorganizimin e njësive të qeverisjes vendore (vetëm në 61 bashki, duke eliminuar komunat) në kuadër të Reformës së Re Administrativo-Territoriale<sup>7</sup>, në fokus të këtij studimi ishin vetëm 65 bashkitë e vendit dhe 11 minibashkitë e Tiranës, duke lënë jashtë vëzhgimit tonë 308 komunat që do të shkrihen pas zgjedhjeve vendore të 21 Qershorit 2015. U përfshinë vetëm ata të zgjedhur të cilët deri në ditën e zgjedhjeve (parlamentare dhe lokale) ishin më të rinj se 35 vjeç dhe ishin pjesë e listës fituese të kandidatëve. Sipas këtij variabli u realizua edhe analiza e mëtejshme e të dhënave për të identifikuar përqindjen reale të të rinjve të zgjedhur në parlament dhe në nivel lokal (kryetarë/e komunash dhe bashkish).

**Fokus grupet (FGD):** kampioni i fokus grupeve ishin të rinj (lider dhe anëtarë) të forumeve rinore të partive politike (FRPP) dhe nga shoqëria civile. 2 prej fokus grupeve u zhvilluan me përfaqësues të FRPP-ve dhe 2 me përfaqësues nga shoqëria civile. Profili i pjesëmarrësve ishte të rinj nga mosha 18-35 vjeç, lider dhe anëtarë të FRPP-ve të angazhuar në politikë dhe aktivë brenda strukturave partiake (FGD-të me FRPP-të) si dhe drejtues organizatash dhe aktivistë të shoqërisë civile (FGD-të me OSHC-të). Në FGD ishin pjesëmarrës rreth 27 të rinj (9 vajza, 18 djem).

**Profili i të intervistuarve:** Personat që u përzgjedhën si raste suksesi të pjesëmarrjes të të rinjve në politikë dhe ju përgjigjën thirrjes sonë për bashkëpunim, ishin të zgjedhur në parlament (deputetë) apo si kryetarë/e në qeverisjen vendore. Grupmosha e tyre varion nga 20-35 vjeç. Vetëm 3 deputetë/e dhe 1 kryetar i një njësie vendore iu përgjigjën pozitivisht kërkesës sonë të përsëritur për intervistë, nga 7 të rinj të përzgjedhur për t'u intervistuar si raste suksesi.

**Skedat e praktikave të mira:** Skeda e Praktikave të Mira u shpërnda elektronikisht në më shumë se 50 organizata të shoqërisë civile që punojnë për/me të rinjtë dhe që veprojnë në të gjithë Shqipërinë. Skeda u plotësua nga 10 organizata në total. Grupi i punës përzgjedhi 7 praktika të mira relevante për t'i reflektuar në këtë studim.

---

<sup>7</sup>Ligji 115/2014, datë 31 korrik 2014: [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2014/PDF-2014/137-2014.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/137-2014.pdf)



### 3.4 Konsideratat etike

Në ndjekje dhe respektimin e parimeve etike, mbi të cilin është ngritur ky studim, në asnjë prej rasteve studiuesit nuk ushtruan presion gjatë rekrutimit dhe përfshirjes në studim. Subjektet e mundshme u pyetën nëse ishin të interesuar për të marrë pjesë në studim dhe u informuan në lidhje me kontributin e tyre dhe rreziqet e mundshme nga pjesëmarrja në këtë studim. Në disa raste, subjektet e përzgjedhur vendosën të mos merrnin pjesë në studim. Këto subjekte u zëvendësuan me subjekte të tjerë.

Subjekteve të kërkimit iu bë e qartë se pjesëmarrja e tyre nuk ishte e detyrueshme dhe ishte e drejta e tyre për të mos marrë pjesë apo për t'u tërhequr nga studimi në çdo kohë, apo edhe e drejta për të mos iu përgjigjur pyetjeve që mund të ishin të ndjeshme për ta.

Subjektet u informuan paraprakisht për përzgjedhjen e tyre, qëllimin e studimit dhe kohëzgjatjen e intervistave dhe ju kërkua të jepnin miratimin e tyre për t'u përfshirë ose jo në studim. Asnjë prej intervistave nuk u ndërpre gjatë zhvillimit të saj.

*Studiuesit u treguan mjaft të kujdesshëm në respektimin e konsideratave etike, si:*

- *Fshehtësia dhe mirëbesimi i plotë* – të dhënat e marra për qëllimin e këtij studimi u trajtuan në formë të fshehtë dhe në mirëbesim të plotë vetëm nga studiuesja dhe nuk u përdorën për qëllime të tjera, përveç atij të shpallur.
- *Anonimati* – të gjithë FGD-të me të rinjtë u zhvilluan duke respektuar të drejtën e të rinjve për të ruajtur anonimat. Për shkak të ndjeshmërisë së çështjes, subjektet u siguruan që informacioni i dhënë prej tyre do të trajtohej në terma të përgjithshëm, duke pasur kujdes që pikëpamjet e tyre të mos lidhen drejtpërdrejt në nivel individual me asnjë nga pjesëmarrësit. Në rastet e intervistave të përdorura për hartimin e profileve të të rinjve të suksesshëm në politikë, të gjithë të intervistuarit u informuan paraprakisht dhe iu mor paraprakisht dakortësia në lidhje me publikimin e informacionit të ndarë prej tyre në këtë studim.
- *Mosgjykimi* – FGD-të dhe intervistat u kryen nga vetë studiuesit. Ata u kujdesën që pjesëmarrësit në asnjë rast të mos gjykoreshin për stilin e tyre të jetës, përkatësinë politike, vlerat apo vendimet e marra gjatë karrierës së tyre.

### 3.5 Kufizimet e studimit

Ky studim nuk merr përsipër të përgjithësojë gjetjet e tij përtej grupit të synuar të studiuar. Të gjitha mendimet e ndara nga subjektet e këtij studimi, janë ruajtur në formën e tyre origjinale dhe nuk mund të përgjithësohen përtej rasteve të studiuar. Grup i synuar i këtij studimi janë vetëm të rinjtë, aktivë në politikë apo shoqëri civile, të zgjedhur në Parlamentin Shqiptar në zgjedhjet 2013 dhe në ato vendore të vitit 2011 dhe 2015. Duke qenë se ky studim u ndërtua krejtësisht brenda qëllimit të tij dhe mbi të dhëna që nuk kishin si qëllim të përshkruanin pjesëmarrjen e të rinjve (siç janë të dhënat e publikuara nga KQZ), mund të thuhet se përmban një kontribut të parë për të bërë një analizë, parë nga këndvështrimi i të rinjve. Konkretisht autorët janë të ndërgjegjshëm në lidhje me kufizimet e këtij studimi, që burojnë nga vështirësia e mbledhjes së të dhënave dhe statistikave apo mungesa e tyre dhe madhësia e kampionit të përfshirë në FGD dhe intervista.

## 4. Të rinjtë shqiptarë: pjesëmarrje dhe përfaqësim i kufizuar në politikë dhe vendim-marrje

**“Pavarësisht se ju nuk shfaqni interes për politikën**

**kjo nuk do të thotë që politika nuk është e interesuar për ju”**. Perikliu

Rritja e rëndësisë të çështjeve lidhur me rininë në axhendën e zhvillimit ndërkombëtar, ka bërë që çështja e pjesëmarrjes së tyre në vendim-marrje të kthehet në një prioritet për shumë shtete. Në nivel global, ekziston një rritje domethënëse e ndërgjegjësimit që të rinjtë, jo vetëm kanë të drejtë të vendosin se si alokohen burimet, por dhe se ata gjithashtu kanë të gjitha njohuritë dhe pikëpamjet e duhura për t'u përcjellë në nivele vendim-marrëse. Për sa i përket mekanizmave, proceseve dhe strukturave për pjesëmarrjen e të rinjve në vendim-marrje, teorikisht ekzistojnë disa rrugë e nivele të ndryshme nëpërmjet të cilave të rinjtë mund të angazhohen. Shkalla në të cilën të rinjtë janë në gjendje të përfitojnë nga këto mundësi në praktikë, kryesisht varet nga rëndësia që mbartin strukturat dhe shkalla e hapjes së strukturave të ndryshme vendim-marrëse, si dhe kapaciteti dhe dëshira e të rinjve për t'u angazhuar në mënyrë proaktive në këto struktura.

“Kriza e përfaqësimit në demokraci” ka në epiqendër të saj vetë të rinjtë. Disa prej çështjeve më alarmante, të ngritura nga mbështetësit e teorisë së krizës së demokracisë, kanë të bëjnë me ç'thurjen e sistemeve politike, institucioneve dhe elitave sociale në shumë vende të Evropës Perëndimore dhe Jug-lindore (Newton, 2001; et al, 1997). Shkencëtarët socialë janë munduar të dokumentojnë atë që ata, unanimisht e perceptojnë si rritje të nivelit të “pakënaqësisë” së qytetarëve evropianë dhe më gjerë në institucionet demokratike të përfaqësimit (Norris, 1999; Torcal and Montero, 2006). Numri i ulët i të rinjve që votojnë për Parlamentin Evropian, në Evropën Perëndimore ose në zgjedhjet lokale në Evropën Qëndrore dhe Lindore, ulja e numrit të të rinjve në institucione tradicionale si partitë politike, organizatat tregtare e madje edhe organizatat rinore në Evropën Perëndimore dhe Jug-Lindore, në krahasim me fund-vitet '80 dhe fillim-vitet '90, janë të gjitha shenja të akumulimit të problemeve në lidhje me pjesëmarrjen politike të të rinjve. Këtyre koncepteve u është referuar si “disenfranchisement” (Adsett, 2003), “depolitizim i të rinjve” (Vrcan 2002), “vulnerabiliteti social” (Tivadar dhe Mrvar, 2002), etj.

Rënia e pjesëmarrjes së të rinjve, në formën e saj konvencionale është bërë një temë thelbësore për akademikët dhe politikëbërësit dhe është parë si tregues i një krize në qytetarinë aktive (Macedo, Alex-Assensoh, & Berry, 2005; Stoker, 2006). Shkencëtarët socialë ja kanë atribuar këtë “krizë” të supozuar disa faktorëve, përfshirë uljen e pjesëmarrjes në jetën civile (Putnam, 2000), niveleve të ulëta të besimit në institucionet politike (Maier, 2000; et al, 2007), individualizimin e stilit të jetës, vlerave dhe rreziqeve (Beck, 1992; et al, 2005), depolitizimin e politikave publike (Hay, 2007) dhe rritjen e cinizmit rreth politizimit të medias (Cappella & Jamieson, 1997; Stoker, 2006).

Ajo çka është e qartë është fakti se demokracitë e vendeve të zhvilluara industrialisht janë karakterizuar nga ulja e numrit të votuesve (Franklin, 2004; et al., 2002, 2007) dhe vjetërimin e anëtarësive të partive politike (van Biezen, Mair, & Poguntke, 2012). Këto

trende janë më të dukshme tek të rinjtë (nga mosha 15-24 vjeç), të cilët janë alienuar nga politika (Dionne, 1999; et al. 2003). Sipas Pippa Norris (2003), “disangazhimi politik” mendohet se ndikon të gjithë qytetarët, por të rinjtë mendohet se janë veçanërisht të zhgënjyer rreth institucioneve të përfaqësimit të demokracisë, duke i lënë ata apatikë (në rastin më të mirë), apo të distancuar (në rastin më të keq).

Një numër i madh studimesh, kanë analizuar ndryshimin e natyrës së politikës dhe të qytetarisë aktive, në vendet në zhvillim, duke u përqëndruar në trendin e zakonshëm të angazhimit politik dhe civil dhe duke eksploruar arsyet që qëndrojnë pas këtyre tendencave (Dalton, 2008; et al., 2004, 2011). Studime të tjera mbi të rinjtë, kanë analizuar natyrën e pjesëmarrjes së të rinjve në vende të caktuara (Dalton, 2009; et al., 2012) dhe ndërkombëtarisht (Norris, 2003; et al., 2010).

Në këtë kontekst, janë të rinjtë ata të cilët diversifikojnë angazhimin civil dhe politik (Norris, 2002); nga politika konsumiste, tek fushatat komunitare e rrjetet online; nga rruga e komunitetet lokale drejt internetit; nga partitë politike e lëvizjet sociale drejt rrjeteve sociale. Për më tej, *nga të dhënat e studimeve të shumta, mund të kuptohet lehtësisht se të rinjtë nuk janë apatikë në lidhje me politikën. Ata kanë këndvështrimet e veta dhe përfshihen në “politikë”, në shumë mënyra, që janë të përshtatura me jetën e tyre të përditshme* (Dalton, et al., 2009, 2007).

Në demokracitë më të stabilizuara, të rinjtë janë më të prirur të marrin pjesë në politikë si një mjet proteste për të shfaqur këndvështrimet e tyre, madje janë më të prirur edhe se gjeneratat e mëparshme për të nënshkruar peticione, për t’u bashkuar me protesta dhe për të marrë pjesë në demonstrata të ndryshme (Inglehart & Welzel, 2005). Edhe pse këto forma angazhimi duket se ulin pabarazitë e pjesëmarrjes bazuar tek mosha dhe gjinia, ato tentojnë të rrisin pabarazitë që vijnë nga statusi socio-ekonomik (Marien, Hooghe, & Quintelier, 2010; Sander & Putnam, 2010).

Aftësia përfaqësuese e politikanëve të rrjedhës qendrore dhe të institucioneve politike tradicionale, është dobësuar mjaft në vitet e fundit. Nxitësit socialë, ekonomikë dhe teknologjikë, kanë ndikuar mjaft edhe në kulturën politike – duke thyer ndasitë e klasës tradicionale me anë të një tregu pune më fluid (Beck, 1992; Roberts, Clark, & Wallace, 1994), duke riformëzuar komunitetet përmes shfaqjes së rrjeteve sociale (Castells, 2000; McClurg, 2003) dhe revolucionarizimit të Internetit (Bennett, Freelon, & Wells, 2010). Politikanët dhe partitë politike kanë luftuar për t’u adaptuar me këto ndryshime. Edhe pse qytetarët janë përqëndruar më tepër tek politikën dhe strategjitë sesa tek vetë politika (Bang & Esmark, 2009; Norris, 2003), aftësia drejtuese e politikanëve, është nënvleftësuar nga mbingarkesa e grupeve të interesit dhe transferimi i fuqisë drejt grupeve të ekspertëve (si komisionet qeveritare), ekonomia ndërkombëtare (si bankat ndërkombëtare) dhe organizatat ndërkombëtare (si Bashkimi Europian). Të gjithë këto mekanizma e kanë ulur fuqinë e politikës për të *shpërndarë* burime në komunitet e më tej.

Për më tepër, të rinjtë në vendet e zhvilluara, përballen sot me një mjedis më konkurrent, buxhete të reduktuara për shërbime publike (të rinjtë i përdorin shumë këto shërbime) dhe me tregun e punës i cili është i egër ndaj të rinjve (norma të larta papunësie në shumicën e vendeve të Evropës Perëndimore dhe Jug-lindore). Kaosi i krijuar nga kriza ndërkombëtare financiare na ka zbuluar mungesën e solidaritetit ndër-breznor (një cikël natyral ndërrimi i cili supozohet të funksionojë). Nga përkeqësimi i varfërisë së fëmijëve, drejt përdorimit të shtuar të mjeteve për përfitim pa punuar (të rinjtë janë më të prirur të jenë të papunë),

drejt uljes së shpenzimeve për shërbime dhe buxhetit të arsimit, rritjes së pagesës në universitete. Ndaj mund të themi me bindje se e gjithë politika e zbatuar në përgjigje të krizës mbarë botërore, ka rritur barrën drejt të rinjve. Edhe pse këto zhvillime mund të inkurajojnë të rinjtë për t'u përfshirë në forma alternative të politikës (për të protestuar drejt politikës publike), ata sërish janë më të zhgënjyer me politikën si p.sh. rasti i demonstratave në Londër (Dhjetor, 2010), apo i të rinjve në Evropë (të ashtu quajturit “indignados” – kundër normës së lartë të papunësisë, 2011) dhe lëvizja “occupy” në SHBA e përtej (nga 2011 e më tej).

Ka pak studime përsa i përket pjesëmarrjes së të rinjve në vendim-marrje në Shqipëri. Kështu, rishikimi i literaturës për pjesëmarrjen rinore në vendim-marrje në praktikë në vendin tonë ishte paksa i vështirë, si pasojë e mungesës së studimeve në këtë drejtim. Megjithatë, me rëndësi duken gjetjet nga literatura që lidhen me faktorët që ndikojnë në nivelin dhe cilësinë e pjesëmarrjes së të rinjve në vendim-marrje, ku spikat ndikimi i rëndësishëm i kulturës së vendit tek të rinjtë, duke i përjashtuar apo nxitur ata drejt përfshirjes në vendim-marrje.

Për fat të mirë, literatura që disponojmë është e vlefshme në mënyra të tjera. Ajo ofron më shumë njohuri për kushtet përmes të cilave ndodh zhvillimi i të rriturve dhe ndryshimet organizative që shfaqen. Gjithashtu literatura, ofron një kontekst të fortë socio-historik për të kuptuar lëvizjet që përfshijnë të rinjtë në vendim-marrje, me implikime të qarta për sfidat dhe mundësitë për lëvizjet që mund të marrin udhë në të ardhmen. Për më tepër, literatura vendase na ofron një pasqyrë rreth zhvillimit të adoleshentëve dhe të rinjve lidhur me kontributin e tyre për të rritur zhvillimet organizative, duke mbajtur në mendje që “rinia e një kombi është administratorja e besuar e të ardhmes së tij”, siç është shprehur dhe Benjamin Disrael<sup>8</sup>.

Një studim (FES, 2002) lidhur me pjesëmarrjen rinore në vendim-marrje, tregon ndër të tjera se nevoja për rritjen e angazhimit të të rinjve në politikë ndodh kryesisht për këto arsye:

- a. Së pari për arsye numerike, pasi të rinjtë përbëjnë  $\frac{1}{4}$  e popullsisë. Sipas Censurit të vitit 2011, në Shqipëri moshë mesatare e popullsisë rezidente është 35,3 vjeç, 45 % e popullsisë së saj është nën moshën 30 vjeç;
- b. Nevoja për të sjellë frymë të re në politikë, një frymë më bashkëkohore, për të çliruar qarqet e mbyllura të politikës tradicionale. Për shembull, për 20 vitet e fundit politika ka qenë e mbyllur vetëm për njerëzit e saj, pa marrë në konsideratë apo vlerësuar meritat dhe kontributet që mund të ofrojë secili/a në jetën e tij/saj profesionale dhe frymën e re që mund të sjellë në politikë;
- c. Nevoja që shoqëria të aktivizojë një nivel të ri politikanësh në bazë të meritave dhe vlerave individuale dhe jo në bazë përzgjedhjesh të njëanshme nga politikanët apo nga drejtuesit e partive politike;
- d. Adresimi i pasivitetit në angazhimin politik, duke filluar që nga pjesëmarrja në zgjedhje (pavarësisht nga arsyet), nga përfshirja apo puna në komunitet, vullnetarizmi, deri tek pjesëmarrja në hartimin e politikave lokale, zgjedhja në forumet lokale, të lagjes, komunës etj;

---

<sup>8</sup> Politikan anglez

- e. Ndryshimi i ambientit shoqëror i cili është tejskajshmërisht i polarizuar. Për politikë flitet kudo, pasi ajo është e lidhur pikë së pari me kushtet e jetesës, por aktivizimi i të rinjve në politikë rrit ndërveprimin mes tyre, kujdesin për ta si edhe zbut klimën politike.

Distancimi i të rinjve nga angazhimi politik vihet re më shumë se tek grupmoshat e mëdha.<sup>9</sup> Megjithatë nivele të ulëta të pjesëmarrjes rinore mund të lidhen me një përfshirje të ulët politike të popullsisë në shoqëritë post-komuniste ku pjesëmarrja në votime në përgjithësi është më e ulët në krahasim me zgjedhjet e para ashtu siç edhe ndodhi në Shqipëri në fillim të viteve '90.

Literatura bashkëkohore që studion pjesëmarrjen rinore në nivele të ndryshme të vendim-marrjes sugjeron se angazhimi politik është i lidhur me shkallën e zhvillimit dhe cilësinë e demokracisë, me besimin që qytetarët krijojnë me demokracinë funksionale të një vendi. Për shoqëritë në tranzicion standardi më i ulët i jetesës, ecejakja e vlerave dhe anti-vlerave si dhe mungesa e një kulture politike të trashëguar shtojnë dozën e problematikave me të cilat përballet vendi. Gjithkush i mbërthyer mes të djeshmes dhe të sotmes, të moralshmes dhe të pamoralshmes, mes përhumbjes dhe pushtetit voton për atë më praktiken që i siguron mbijetesën apo fuqizimin.

Një gjetje interesante e disa studimeve në vend, na tregon se ekziston një lidhje mes bindjeve politike të të rinjve dhe atyre të familjes si edhe fenomenit të aktivizimit të tyre në politikë si rrjedhojë e nevojës për punësim. Edhe pse në krahasim me më parë kemi një rritje të konsiderueshme të numrit të të rinjve që angazhohen në politikë, lufta për pushtet mbetet motivi kryesor që drejton shoqërinë shqiptare. Kështu, nga shumë të rinj angazhimi në politikë konsiderohet si e vetmja mundësi për një punë apo të ardhme. Për këtë qëllim ata nuk angazhohen në mënyrë vullnetare në organizma si klubet rinore, organizatat rinore, etj., pasi lidhen me formacione politike si mundësi për të gjetur punë. Akoma mjediset militante, bastionet politike, familja, etj., influencojnë në qëndrimin politik ose zgjedhjen politike të rinisë. Kjo vjen nga fakti se nuk votohet për ide, program apo platforma politike, por vetëm për interesa të ngushta dhe përfitime afatshkurtra.

Gjithsesi, jo aq tronditëse duket situata kur shohim se në realitet ka plot të rinj që shprehin dëshirën dhe vullnetin për t'u angazhuar në politikë. Studimet kanë evidentuar se në vitet e fundit vihet re se të rinjtë shqiptarë janë shumë më të përfshirë në iniciativa dhe aktivitete të organizuara nga partitë kryesore, sesa nga komuniteti apo shoqëria civile. Pavarësisht formave të ndryshme të kontributit politik dhe synimeve që gjithësecili kërkon të arrijë nëpërmjet politikës, përfshirja e brezit të ri në të, përpos frymës së re përçon edhe domosdoshmërinë për përmirësimin e politikave të lidhura me të. Angazhimi i rinisë, qoftë edhe vetëm si dekor nëpër takime elektorale, në mënyrë indirekte i imponon politikanët të kthejnë sytë tek ajo dhe të përmbushin detyrimisht pikat minimale në këmbim të votës së saj. Nga ana tjetër, përkrahja e një force politike dhe bashkëveprimi me të, rrit disi formimin politik të të rinjve, por në disa raste mund të shkaktojë edhe distancim total.

---

<sup>9</sup> UNICEF and the World Bank (2002). *“Youth in the South Eastern Europe”*. Macmillan Press, Civitas foundation 2002, New York.

Një nga arsytet që shkurajon të rinjtë dhe i largon nga politika është edhe mjedisi jo-miqësor brenda kahut politik, por jo vetëm. Lufta për pushtet që prodhon vetvetiu edhe atë brenda llojit ndikon negativisht në perceptimin e të rinjve për ta kundruar politikën si mjet në dobi të interesit publik. Shkelja flagrante e vlerave dhe e parimeve për hir të përfitimeve personale, kalimi tashmë i zakonit nga një forcë politike në tjetrën, ngjizja jo-organike e koalicioneve pushtet-prurëse si edhe mosreflektimi i pjekurisë politike shuan besimin e pastër të të rinjve te politika. Po kështu, edhe vetë ligjërimi apo diskursi politik i ashpër, në vend të frymës së bashkëpunimit dhe kompromisit kultivon atë të përçarjes dhe urrejtjes. (FES, 2012. f. 36)

Nëse do të përmendim një përmbledhje gjetjesh të tjera interesante nga studime mbi të rinjtë shqiptarë, ato do të ishin të listuara si më poshtë:

- Origjina rurale apo urbane si dhe prejardhja krahinore janë dy faktorët kryesorë të diskriminimit që hasin të rinjtë;
- Në përgjithësi të rinjtë janë tolerantë dhe të hapur ndaj grupeve të ndryshme shoqërore, por ata karakterizohen nga një ndjenjë e theksuar paragjykimi ndaj homoseksualëve;
- Vetëm 16 % e të rinjve janë përfshirë në aktivitete vullnetare;
- Vlerat e sotme më të rëndësishme për të rinjtë janë dinjiteti vetjak, toleranca dhe korrektësia;
- Shumica e të rinjve shqiptarë, rreth 80 %, e identifikojnë veten si besimtarë të një feje të caktuar dhe vetëm një e pesta e tyre pohojnë se nuk janë të tillë;
- Vajzat përbëjnë shumicën e të rinjve që ndjekin arsimin e lartë, mbizotërimi i numrit të vajzave përkundrejt djemve rritet në mënyrë proporcionale me nivelin e shkollimit;
- Mesatarisht, të rinjtë shqiptarë shpenzojnë 2-3 orë në ditë për të studjuar, ku djemtë i kushtojnë shumë më pak kohë këtij procesi;
- Të rinjtë në Shqipëri nuk janë shumë të interesuar mbi zhvillimet politike në vend, pasi besojnë se vota e tyre apo pjesëmarrja e tyre në votime nuk ka ndonjë ndikim në mënyrën se si do të qeveriset vendi. Vetëm një pakicë shumë e vogël e të rinjve mund të konsiderohet që shfaq interes.

Përpos objektivave të këtij studimi, qëllimi ynë është që me anë të kësaj analize të shkurtër të prezantohet sa më mirë gama e plotë e informacionit që është në dispozicion, duke maksimizuar kështu aksesin e informacionit në mënyrë që ajo të mund të përdoret nga hulumtuesit.

## 5. Nga lëmosha drejt pjesëmarrjes? Kuadri ligjor dhe statutor për pjesëmarrjen e të rinjve në vendim-marrje dhe në politikë në Shqipëri

**Askush nuk ka lindur si një qytetar i mirë; asnjë komb nuk ka lindur në demokraci. Përkundrazi, të dyja janë procese që vazhdojnë të zhvillohen përgjatë të gjithë jetës. Të rinjtë duhet të jenë të përfshirë që në lindje. Një shoqëri që e ndërpret veten nga rinia e saj është një shoqëri që ka prerë kordonin e shpëtimit të saj; ajo është e destinuar të vdesë.**

— Kofi Annan, ish-Sekretar i Përgjithshëm i OKB-së.

### 5.1 Shkallët e pjesëmarrjes në vendim-marrje


Pjesëmarrja e të rinjve në politikë dhe në vendim-marrje është një çështje sa publike aq edhe private. Është një çështje publike, pasi ka të bëjë me qasjen që ka qeverisja në tërësi dhe institucionet publike, partitë politike dhe shoqëria, ndaj të rinjve në tërësi dhe hapësirave apo fushës së veprimit që iu lihet të rinjve për të vepruar, për të marr pjesë apo për të qenë të përfaqësuar.

Çështja është edhe private, pasi të rinjtë, që në fëmijërinë e hershme të tyre, ndërveprojnë me shoqërinë dhe mësimet dhe eksperiencat e përfituara gjatë kësaj kohë, shërbejnë si një udhërrëfyes në jetën e tyre drejt angazhimit civil apo politik, pjesëmarrjes në nisma shoqërore dhe kërkimit të mundësive për përfaqësimin e interesave të të rinjve të tjerë në politikë apo vendim-marrje. Realiteti dhe studimet tregojnë një pamje jo shumë entuziaste të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit rinor në të gjitha nivelet kudo në Botë.

Pjesëmarrja e të rinjve është një çështje moderne e shoqërisë. Ende ka shoqëri dhe vende, përfshi edhe vetë Shqipërinë, ku pjesëmarrja e të rinjve shihet më shumë si lëmoshë sesa si një çështje e rëndësishme e qëndrueshmërisë së demokracisë dhe formimit që në moshë të hershme të drejtuesve të ardhshëm. Edhe në aspektin studimor dhe atë ligjor, kjo çështje mbetet ende e re. Studimet në fushën e ligjit apo edhe në fushën sociale mbeten të kufizuara dhe ende mungojnë meta-analizat shoqërore të ndikimit pozitiv që ka pjesëmarrja dhe përfaqësimi i të rinjve në vendim-marrje dhe në politikë.

“Një komb është demokratik deri në masën që qytetarët e saj janë të përfshirë, veçanërisht në nivel komunitar. Besimi dhe kompetencat për të marrë pjesë duhet të fitohen gradualisht përmes praktikës. Është pikërisht kjo arsya që mundësitë për fëmijët duhet të rriten gradualisht për të marrë pjesë në çdo demokraci aspiruese, dhe veçanërisht në ato vende që janë tashmë të bindura se janë demokratike<sup>10</sup>”.

<sup>10</sup> Hart R., (1992). *From Tokenism to Citizenship*, UNICEF International Child Development Centre, Florence.



Një ndër autorët<sup>11</sup> që është ndalur qartësisht në analizën e konceptit të pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rinjve në vendim-marrje është Roger Hart. Në esenë e tij më të rëndësishme “Nga lemosha drejt qytetarisë”, Hart shkon përtej koncepteve të pjesëmarrjes, duke zhvilluar edhe një model të shkallëve të renditjes së pjesëmarrjes, në atë çka ai e konsideron nga “lëmosha në pjesëmarrjen e vërtetë”.

Nëpërmjet paraqitjes së 8 shkallëve, të ndara në dy grupe kryesore: “jo pjesëmarrje” (ose sa për

lëmoshë: shkalla 1-3) dhe “pjesëmarrje” (shkalla 4-8), në aspektin metodik dhe shkencor ai reflekton se pjesëmarrja më e lartë është ajo ku të rinjtë dhe të rriturit janë të barabartë në marrjen e vendimeve, ndërkohë që shkallët më të ulta të pjesëmarrjes janë: manipulimi (1), sa për dekorim (2), sa për lëmoshë (3).

Shkallët e Hart janë kthyer sot në një ndër metodat më të përdorura të matjes së pjesëmarrjes të fëmijëve, të të rinjve dhe të qytetarëve në vendim-marrje.

*“Manipulimi është shkalla më e ulët e pjesëmarrjes. Ndonjëherë të rriturit mendojnë se qëllimi justifikon mjetin. Një shembull i mirë do të ishte ai i fëmijëve që mbajnë pankarta politike në lidhje me ndikimin e politikave sociale për fëmijët. Nëse fëmijët nuk e njohin çështjen dhe kështu nuk i kuptojnë veprimet e tyre, atëherë ky është manipulim. Një manipulim i tillë nën maskën e pjesëmarrjes është një mënyrë e papërshtatshme për të futur fëmijët në proceset politike demokratike. Ndonjëherë veprime të tilla rrjedhin nga mungesa e ndërgjegjësimit dhe aftësive të të rriturve ndaj fëmijëve.”<sup>12</sup>*

<sup>11</sup> Hart R., (1992). *From Tokenism to Citizenship*, UNICEF International Child Development Centre, Florence.

<sup>12</sup> Idem



## 5.2 Legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar për pjesëmarrjen e të rinjve në politikë dhe vendim-marrje

Pavarësisht se të rinjtë nën-moshën 25 vjeç përbëjnë gjysmën e popullsisë në shumë vende në zhvillim dhe 1 të 5-tën e popullsisë në botë, pjesëmarrja e të rinjve në politikë dhe në vendim-marrje mbetet në nivele shumë të ulta. Ato sfidojnë përfaqësuesit e sistemit politik dhe mund të shpien drejt ndarjes apo fragmentizimit të qytetarëve tanë të rinj. Për më tepër ajo mund të përforcojë stereotipet që i trajtojnë të rinjtë si njerëz të pa-interesuar për çështje politike, si objekte të politikave sociale apo edhe si keqbërës<sup>13</sup>.

Të dhënat globale tregojnë se vetëm 1.65% e Parlamentarëve të të gjitha vendeve janë rreth moshësh 20 vjeç dhe vetëm 11.87% e tyre janë deri në moshën 30 vjeç<sup>14</sup>. Moshë mesatare e deputetëve që janë pjesë e Parlamenteve në të gjithë botën është rreth 53 vjeç për burrat dhe 50 vjeç për gratë.

OKB-ja ka aprovuar një sërë standartesh ndërkombëtare në lidhje me “pjesëmarrjen” si një e drejtë bazë politike. Përpjekja e parë serioze fillon me Deklarata Universale të të Drejtave të Njeriut (1949), për të vazhduar me Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (1996), Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial (1965), Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (1979), për të arritur tek Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (1992), si dhe një sërë Protokolleesh, aktesh apo udhëzimesh, një pjesë e të cilave nuk kanë vlerë detyruese për vendet anëtare.

Në nivel kombëtar gjendja paraqitet edhe më shqetësuese. Ndonëse Shqipëria ka bërë hapa përpara në drejtim të demokratizimit të jetës së saj politike, pas rrëzimit të sistemit komunist, këto hapa nuk janë shoqëruar me nisma ligjore për të mbështetur pjesëmarrjen e të rinjve. Pavarësisht se e drejta e organizimit, e zgjedhjes, e shoqërimit, e fjalës dhe e shprehjes, në Kushtetutën e Shqipërisë janë njohur si të drejta kushtetuese, legjislacioni kuadër nuk është zhvilluar më tej.

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë ka vendosur një kuotë gjinore minimum për gratë dhe vajzat për 30% të listave të kandidatëve për zgjedhjet parlamentare dhe 50% për këshillat bashkiakë, por ai nuk zbaton ndonjë kuotë për pjesëmarrjen e të rinjve në vendim-marrje. Ndërkohë as Ligji “Për Partitë Politike në Shqipëri” nuk përmban ndonjë referencë për të rinjtë në këtë drejtim<sup>15</sup>. Gjatë viteve të fundit ka patur disa tentativa për nisma ligjore si përgatitja e një Ligji “për Rininë” apo për “Vullnetarizmin”, deri në momentin e finalizimit të këtij studimi asnjë nismë e të tillë nuk ishte miratuar në Kuvendin e Shqipërisë.

Pavarësisht të gjitha këtyre zhvillimeve, duhet thënë se ato nuk kanë caktuar ndonjë standard ligjor në lidhje me pjesëmarrjen e të rinjve si një grup i veçantë shoqëror në politikë dhe vendim-marrje. Ndonëse nuk ka ndonjë argument të njohur në këtë drejtim, besohet se fakti se të rinjtë, si në legjislacionin e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar, janë një grup social i ndërmjetëm midis fëmijëve (nën 18 vjeç) dhe të rriturve (+18), atëherë rregullimi ligjor jo detyrimisht është i nevojshëm për këtë grup social.

<sup>13</sup> UNDP (2012). Enhancing Youth Political Participation throughout the Electoral Cycle.

<sup>14</sup> UNDP and IPU (2012). Global Parliamentary Report

<sup>15</sup> Ligj Nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për Partitë Politike”

Megjithatë të dhënat e pjesëmarrjes të të rinjve tregojnë domosdoshmërinë për përgatitjen dhe aprovimin e standardeve të reja për promovimin e pjesëmarrjes të të rinjve në të gjitha nivelet e vendim-marrjes dhe politikës.

Këshilli i Europës ka një qëndrim më pozitiv dhe më të avancuar në lidhje me pjesëmarrjen e të rinjve në vendim-marrje. Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të KE-së, në vitin 1992<sup>16</sup> dhe më pas në vitin 2003 miratuan Kartën për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale<sup>17</sup>. Ky dokument përbën sot për sot një ndër standardet europiane kryesore të nxitjes së pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të të rinjve në nivel kombëtar dhe European, me fokus të posaçëm pjesëmarrjen e të rinjve në vendim-marrjen lokale. Karta Europiane ndalet në të gjitha aspektet e pjesëmarrjes dhe fuqizimit të të rinjve, përfshi edhe shoqërinë civile dhe partitë politike. Ndonëse Karta nuk është e detyrueshme për t'u zbatuar nga vendet anëtare, përfshi edhe Shqipërinë, ajo duhet të shërbejë si një udhëzues për pushtetin vendor në vend, në lidhje me masat që duhen zbatuar për ta kthyer pjesëmarrjen e të rinjve në realitet. Më poshtë kemi shkëputur nga Karta pjesën II.8, pika 54-56, ku flitet në mënyrë specifike në lidhje me pjesëmarrjen e të rinjve në OJQ dhe parti politike:

Një sektor joqeveritar i gjallë, i pavarur dhe aktiv është element i rëndësishëm i çdo shoqërie të vërtetë demokratike. Është gjithashtu e rëndësishme që sektorët e tjerë të shoqërisë civile, të tilla si partitë politike, të jenë të forta dhe aktive në nivel vendor dhe rajonal. Pjesëmarrja në jetën demokratike të çdo vendi, rajoni apo lokaliteti nënkupton votimin më shumë se një herë në disa vjet. Kjo është arsyeja pse pjesëmarrja në OJQ-të dhe partitë politike është aq e rëndësishme, sepse ato ndihmojnë qytetarët të jenë të përfshirë dhe të kenë ndikimin e tyre të vazhdueshëm në vendimet dhe veprimet e marra. Prandaj është e rëndësishme që të rinjtë të inkurajohen dhe të mbështeten për të marrë pjesë në jetën shoqërore në komunitetet e tyre.

Organet vendore dhe rajonale duhet të sigurojnë burime financiare dhe burime të tjera për OJQ-të të cilat promovojnë pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitetet e tyre si dhe në strukturat dhe procedurat demokratike vendim-marrëse.

Organet vendore dhe rajonale, në partneritet me partitë politike dhe në mënyrë jopartiake, duhet të nxisin përfshirjen e të rinjve në sistemin e partive politike në përgjithësi, dhe të mbështesin veprime të veçanta, siç është trajnimi, në veçanti.

<sup>16</sup> Rezoluta 237 e Kongresit të Autoriteteve Lokale të Këshillit të Europës e vitit 1992 jetësoi Kartën e të Rinjve, e cila në vitin 2002 u nënshtrua rishikimit dhe plotësimit. Karta e Rishikuar u miratuar nga Kongresi i Autoriteteve Lokale në vitin 2003

<sup>17</sup> Një kopje e Kartës të Pjesëmarrjes të të Rinjve mund ta gjeni (në anglisht) në link: [http://pjp-eu.coe.int/documents/1017993/1380082/COE\\_charter\\_participation\\_en.pdf/520b9cb4-73a8-4556-913a-c77ee6596c7e](http://pjp-eu.coe.int/documents/1017993/1380082/COE_charter_participation_en.pdf/520b9cb4-73a8-4556-913a-c77ee6596c7e) (dokumenti është aksesuar në datë 25 Prill 2015) Në shqip Karta është e lexueshme në link: [https://www.coe.int/t/dg4/youth/Source/Coe\\_youth/Participation/COE\\_charter\\_participation\\_al.pdf](https://www.coe.int/t/dg4/youth/Source/Coe_youth/Participation/COE_charter_participation_al.pdf)

### 5.3 Politika kombëtare dhe kuadri institucional për nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në politikë dhe vendim-marrje

Shqipëria ka ndërtuar një imazh publik pozitiv në drejtim të përgatitjes së politikave kombëtare për të rinjtë, përfshi edhe pjesëmarrjen e tyre në politikë dhe vendim-marrje. Duke nisur nga viti 2005 e në vijim vendi gjithnjë ka patur të miratuar një Strategji Kombëtare për të Rinjtë dhe respektivisht edhe një Plan Kombëtar Veprimi. Është e vështirë të analizosh impaktin që kanë patur Strategjitë Kombëtare për të Rinjtë përgjatë periudhës 2005-2015, pasi asnjëherë nuk ka patur një analizë të detajuar të zbatimit të tyre, buxhetit të dhënë dhe arritjeve ndër vite.

Olof Palme International Center gjatë vitit 2012 mbështeti përgatitjen e një analize të shkurtër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Rininë (2007-2013) ku ndër tre treguesit bazë në lidhje me pjesëmarrjen e të rinjve në politikë dhe në vendim-marrje, të cilat u morën në analizë nga studimi, raportoi se asnjë prej tyre nuk ishte realizuar<sup>18</sup>.

Qeveria e re që erdhi në pushtet mbas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2013, ndoqi të njëjtat hapa si të gjitha qeveritë para-ardhëse, duke përgatitur dhe miratuar një Plan Kombëtar Veprimi për Rininë për 5 vitet e ardhshme<sup>19</sup>. Në planin institucional, Qeveria vendosi përfundimisht shkëputjen e Drejtorisë së Politikave Rinore, një njësi politikëbërëse e qeverisë në nivel kombëtar, nga Ministria e Kulturës ku ajo ishte vendosur që prej vitit 1995, në Ministrinë e re të sapokrijuar të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë (PKVR) është një përpjekje serioze ndër-sektoriale për të ndërtuar një politikë të re për mbështetjen e të rinjve në Shqipëri. Ai u përgatit në një proces të gjerë konsultues me të rinj nga i gjithë vendi dhe e shtrin veprimin e tij përgjatë një periudhe 5 vjeçare.

Plani cakton ndër të tjera si qëllim arritjen e gjashtë (6) objektivave strategjikë, ku Objektiv 1 i dedikohet nxitjes dhe pjesëmarrjes së të rinjve në proceset/vendim-marrjet demokratike. Paraprakisht mund të thuhet se aspekti pozitiv i Planit është edhe fakti që Ministria ka caktuar edhe indikatorët e matjes së arritjes së objektivave dhe buxhetin përkatës për realizimin e tyre, diçka që nuk kishte ndodhur me strategjitë e kaluara për rininë dhe që mbase ka ndikuar në një masë të madhe në mos-realizimin e tyre.

Në analizën e faktorëve që janë marrë në analizë për nivelin e ulët të pjesëmarrjes së të rinjve në vendim-marrje, ndër të tjera, Plani Kombëtar përmend sa më poshtë:

**“Përfaqësimi i të rinjve në jetën politike dhe sidomos në strukturat e qeverisjes vendore mbetet në nivele tepër të ulëta. Përfaqësimi i tyre në këto struktura bëhet jo sipas ligjeve apo vendimeve në fuqi, por në shumicën e rasteve sipas njohjeve personale apo “dëshirës së mirë dhe vullnetit” të drejtuesve partiakë.<sup>20</sup>**

**... Faktorët që kanë kontribuar: mungesa e kuadrit ligjor që përcakton detyrimet ligjore dhe politikave qeverisëse që nxisin dhe motivojnë të rinjtë të jenë pjesë aktive në proceset dhe vendim-marrjet demokratike.**

<sup>18</sup> Lëvizja Mjaft & Instituti Axfenda, (2012) *Rinia Shqiptare: Problemi apo Investimi i Shkëlqyer*, Tiranë. (Fq. 8)

<sup>19</sup> Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, VKM 383, datë 06.05.2015, Fletore Zyrtare Nr. 79, viti 2015.

<sup>20</sup> Ibid

Pjesëmarrja aktive e të rinjve në procesin zgjedhor dhe sidomos votuesve për herë të parë ka ardhur gjithmonë e në rënie.

Nga ana tjetër, edhe pse ekzistojnë një numër i madh organizatash rinore, një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë mangësi në formën e organizimit, lidhshimit, shkrim dhe menaxhim projektsh. Një tjetër mangësi që haset në sektorin e organizatave rinore (por jo vetëm) është dhe mungesa e bashkëpunimit mes organizatave rinore me grupet e shoqërisë civile, institucioneve apo agjencitë financuese.”

Vetë objektivi strategjik 1 ndahet në katër objektiva specifike dhe shtatëmbëdhjetë aktivitetete mbështetëse, të cilave i korrespondojnë rreth 38 indikatorë të matjes së arritjeve. Kostoja totale e aktiviteteteve të parashikuara për këtë objektiv është 1.048.928 lekë, nga të cilat 52% mbulohen nga buxheti i shtetit, ndërsa 48% janë kosto të pambuluara ende, një faktor që mund të paraqesë probleme në financimin e këtij objektivi apo të të gjithë Planit, por që mund vetë Ministria e ka çmuar se të ardhurat e munguara mund “të sigurohen nga bashkëpunimi me donatorët apo grupet e interesit”.

Ndër të tjera PKVR do të mbështesë krijimin e Shërbimit Kombëtar të Rinisë (një njësi që tashmë është krijuar), Korpusit të Rinisë (një tip shërbimi kombëtar vullnetarizmi) dhe mbështetjen e organizatave rinore apo të Qeverive të Nxënësve dhe atyre Studentore. Në drejtim të pjesëmarrjes së të rinjve në vendim-marrje (Objektiv specifik 1.2 në PKVR) ndër të tjera MMSR dhe Qeveria Shqiptare parashikojnë të mbështesin:

- Takime avokatie me grupimet politike për të nxitur përfaqësimin e të rinjve në nivel 20% në Qeverisjen Vendore.
- Krijimi i Bordit Rinor Këshillimor në MMSR dhe strukturat e qeverisjes vendore, si një strukturë këshilluese nga të rinjtë në të gjitha fazat e vendim-marrjes e hartimit dhe monitorimit të politikave rinore.
- Aktivitete sensibilizuese me qëllim zvogëlimin e stereotipeve/diskriminimit gjinor dhe përfshirjen e vajzave të reja në proceset vendim-marrëse dhe jetën publike.

Në tërësi mund të thuhet se PKVR është një përpjekje e mirë dhe serioze për ndërtimin e politikave publike për/dhe me të rinjtë, përfshi edhe caktimin e objektivave strategjike për nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendim-marrjen publike dhe në politikëbërje. Sidoqoftë aspektet pozitive të Planit mund të kenë tendencën të zbehen për shkak të mos-caktimit të objektivave apo aktiviteteteve të angazhimit publik dhe dialogut me partitë politike në vend, mos ndryshimit të Kodit Zgjedhor për ta kthyer kuotën 20% në një kuotë kombëtare, mungesës së buxhetit për të mbështetur krijimin e një platforme civile dhe politike rinore dhe mungesës së një strukture rinore të pavarur kombëtare që të monitorojë në mënyrë periodike zbatimin e masave të Planit.

## 5.4 Statutet e Partive Politike dhe pjesëmarrja e forumeve politike të të rinjve në vendim-marrje

Studimi ndër të tjera u ndal edhe tek njohja me statutet e partive politike parlamentare në Shqipëri dhe roli që ato kanë parashikuar për Forumet Rinore politike të të rinjve. Një ndër aspektet e rëndësishme të analizës është fakti që të gjitha partitë politike, parlamentare ose jo, dhe statutet e tyre parashikojnë role dhe përgjegjësi specifike për forumet rinore, pavarësisht se në disa prej tyre këto funksione janë të limituara apo në raste të tjera të vendosura nëpërmjet zbatimit të kuotave.

Studimi i këtyre funksioneve ka tendencën të na tregojë sesa të dedikuara janë partitë drejt garantimit të pjesëmarrjes të të rinjve në strukturat e brendshme vendim-marrëse, e cila shërben si një mundësi për të përgatitur kuadrot e rinj politikë dhe drejtuesit e ardhshëm të partisë apo edhe vendit. Në këtë këndvështrim mundësitë dhe hapësirat, të vogla apo të mëdha, që të rinjtë të marrin pjesë në parti dhe forume rinore, janë tregues i demokracisë së brendshme të partisë, por jo vetëm; ato na tregojnë se sa e rëndësishme është rinia dhe avancimi i të rinjve për vetë partitë në Shqipëri dhe se cila do të jetë e ardhmja e partive, ku të rinjtë nuk janë pjesëmarrës apo të përfaqësuar.

“Forumet Rinore politike, jo vetëm që luajnë një funksion të rëndësishëm për rekrutimin politik, por një sërë faktesh na sugjerojnë se këto organizata po humbin anëtarësinë e tyre, shumë herë më shpejt se sa vetë partitë politike. Shifrat lidhur me këtë rënie (në Belgjikë) janë në përputhje me atë çfarë po ndodh edhe në Gjermani dhe Suedi. Kjo nënkupton që, në një të ardhme të afërt, partitë do të ballafaqohen me faktin se një nga burimet e tyre kryesore për anëtarë të rinj po thahet. Kjo konfirmon edhe hipotezën e Katz dhe Mair se partitë politike janë duke u bërë më pak të interesuara në pasjen e një baze të gjerë të anëtarësisë dhe se ato janë gradualisht duke u dominuar fuqishëm nga shqetësimet për pushtetin, sa janë të ekspozuara në media, angazhimin e ekspertizës profesionale për të komunikuar me publikun dhe sigurinë e pushtetit.”<sup>21</sup>

### i) Moshë e anëtarësisë në parti dhe forumet politike të të rinjve

Moshë është një faktor i rëndësishëm nxitës ose frenues i pjesëmarrjes të të rinjve në vendim-marrjen e brendshme të partive politike dhe të forumeve rinore të tyre. Në këtë aspekt, duhet thënë se thuajse të gjitha statutet e partive politike caktojnë moshën 16 vjeç, si moshën minimale të anëtarësisë në parti dhe në forumet rinore. Këtu bën përjashtim Partia Demokratike që moshën minimale e ka 15 dhe PBDNJ që e ka 17 vjeç.

Një aspekt që kërkon vëmendje është edhe zgjedhja e të rinjve në organet vendim-marrëse të partive politike. Është pozitive të shohësh se pjesa më e madhe e partive konsiderojnë si moshë bazë atë 16 vjeç (me përjashtim të PR që e ka 18 vjeç dhe PBDNJ 17 vjeç), pavarësisht faktit se e drejta e votës në zgjedhjet për në parlament ose ato vendore për të rinjtë fitohet kur personi mbush moshën 18 vjeç.

<sup>21</sup> Hooghe M., Stolle D., (2005). Youth organisations within political parties: political recruitment and the transformation of party systems, pg 43-53. Revisiting youth political participation, Council of Europe.


## ii) Roli dhe përgjegjësitë e Forumeve Rinore në Partitë Politike në Shqipëri

Forumet rinore luajnë role të ndryshme brenda partive ku janë krijuar. Në aspektin e ngushtë statutor, siç edhe mund të shihet më poshtë, në **Matriksin e Pjesëmarrjes të të Rinjve dhe Forumeve Rinore në Partitë Politike në Shqipëri**, pjesës më të madhe të forumeve politike të të rinjve, ju caktohen role dhe funksione të kufizuara të pjesëmarrjes në strukturat dhe proceset vendim-marrëse, ndërsa për një pjesë të vogël funksionet janë të gjera dhe përfshijnë të gjitha nivelet e vendim-marrjes.

Nisur nga roli që ju është përcaktuar dhe që mund të luajnë forumet rinore brenda partive politike, si dhe për të lehtësuar procesin e kuptimit të këtij roli, ne ndërtoam një sistem pikëzimi, ku çdo rol që ka forumi në vendim-marrje në nivel lokal apo qëndror dhe në çdo strukturë të partisë u vlerësua duke filluar nga 0 pikë, aty ku forumi dhe/ose të rinjtë nuk kanë asnjë rol statutor të parashikuar, për të vijuar me 1 pikë për çdo rol të caktuar dhe 3 pikë kur pjesëmarrja dhe përfaqësimi është i garantuar me kuota.

Grafiku 1 (më poshtë) paraqet të skematizuar rolin që luajnë forumet politike brenda partive politike në Shqipëri, duke marrë në konsideratë të gjitha nivelet e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes të të rinjve.

Grafik 1: Roli i Forumeve rinore sipas partive politike në Shqipëri




Siç shihet nga Grafiku 1, Forumet Rinore janë të përfshira thuajse që të gjitha në kryesitë qëndrore të partive të tyre thuajse në të njëjtën masë, me përjashtim të LRI, ku roli i tyre në

parti është i caktuar me kuota, që do të thotë se edhe roli që ata mund të luajnë është edhe më i madh. Ndërkohë shohim se roli i forumeve vjen duke u zvogëluar kur vjen puna tek përfshirja e të rinjve në listat e deputetëve, seksionit bazë të partisë apo burimeve financiare që garantojnë funksionimin e forumit rinor politik.

Ndërkohë kur shohim se në cilën parti të rinjtë janë më mirë të përfaqësuar, Grafiku 2 na tregon se pikët maksimale i merr LSI e ndjekur nga PS dhe PD, për shkak se të rinjtë e këtyre tre partive dhe forumet e tyre politike kanë nivelin më të lartë të përfaqësimit në parti, krahasuar me partitë e tjera politike në Shqipëri. Megjithatë kjo nuk do të thotë që pjesëmarrja e të rinjve në LSI apo PS e PD është në nivele të kënaqshme.

Nëse shohim përfaqësimin e Forumeve të të Rinjve në listat për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, vërejmë se asnjë nga forumet nuk e ka të garantuar këtë pjesëmarrje. Të dhënat tregojnë psh. se FRESSH, në përfundim të Zgjedhjeve Parlamentare 2013, nuk kishte asnjë deputet në listën e deputetëve të PS, FRPD ka vetëm një (kryetarin e forumit), ndërsa LRI arriti të nxjerrë një deputete, por vetëm për shkak të dhënies së dorëheqjes të deputetëve të LSI që u bënë Ministra në Qeverinë e re të drejtuar nga kryeministri Rama.



Grafik 2: Forumet Rinore politike dhe roli i tyre në parti

### iii. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi në organet vendim-marrëse vendore të partisë

Partitë politike në Shqipëri janë të organizuara sipas një sistemi vertikal, ku struktura më e lartë ka një rol dhe përgjegjësi shumë herë më të gjerë sesa ajo vendore. Kjo lloj strukture i përgjigjet edhe rolit që mund të luajnë forumet rinore dhe të rinjtë brenda një partie politike. Njësia bazë e partive funksionon në nivelin e lagjes, kjo në varësi edhe të numrit të anëtarëve. Asgjë nga Statutet nuk parashikonte ndonjë rol specifik të Forumeve të të rinjve

në këto njësi, përpos rolit të nën-kuptuar që një i ri/e re mund të jetë anëtar i njësisë bazë. Sa më e madhe partia politike aq më shumë njësi bazë ka dhe aq më shumë shtohen rolet për njësitë e saj vendore.

Po ashtu, me përjashtim të Partisë Socialiste dhe forumit të saj (FRESSH), partitë i konsiderojnë forumet rinore si pjesë integrale të partisë, ndërsa PS e konsideron si organizatë partnere të saj. Në aspektin statutor kjo e dhënë paraqet rëndësi pasi në një strukturë që është pjesë integrale e partisë, bashkë zgjedhja e të rinjve të tjerë, pa një karrierë të mëparshme politike është shumë herë më e lehtë, sesa në rastin e FRESSH që funksionon si një organizatë partnere.

Ajo çka mund të thuhet në tërësi për rolin vendor që luajnë forumet rinore politike, është se ai është i kufizuar dhe përgjithësisht është i fokusuar në garantimin e pjesëmarrjes të një të riu/të reje në organet drejtuese lokale të partisë, me përjashtim të LRI, që pjesëmarrjen e ka të garantuar në masën 30% në të gjitha nivelet e partisë. Në disa raste statutet e partive nuk parashikojnë asnjë lloj roli të forumit rinor në nivelin e kryesisë së partisë së rrethit apo edhe qarkut, siç mund të jetë rasti i PBDNJ, FRD, etj.

#### **iv. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi në organet vendim-marrëse qendrore të partisë**

Thuajse të gjitha forumet politike rinore kanë një rol më mirë të përcaktuar në organet qendrore vendim-marrëse të partisë. Ndonëse për një pjesë të mirë të forumeve rinore nuk është i qartë apo i përkufizuar siç duhet niveli i përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së tyre në Kongresin e Partisë, kur vjen çështja tek pjesëmarrja e tyre në Asamblenë Kombëtare apo Kryesinë e Partisë, shohim se statutet parashikojnë të paktën 1 përfaqësues nga forumi rinor. Përjashtim bën forumi rinor i PR-së, ku statuti nuk iu ka parashikuar këtë të drejtë.

#### **v. Forumet Rinore dhe përfaqësimi i tyre në listat e deputetëve dhe këshilltarëve bashkiakë**

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i të rinjve në listat e kandidatëve për në Kuvendin e Shqipërisë dhe për këshilltarë në Këshillat Bashkiakë është i një rëndësie të veçantë, jo vetëm për të rinjtë, por edhe për demokratizimin e institucioneve publike të zgjedhura dhe përcimin e nevojave të të rinjve në çdo vend ku vendoset për ta. Megjithatë, nuk duhet të çudisë askënd fakti që asnjë forum rinor politik nuk ka asnjë vend të paracaktuar aty ku edhe përfaqësimi dhe pjesëmarrja e tyre është më e rëndësishme, **në Kuvend**: për shkak të ligjeve dhe buxhetit për të rinjtë që miratohen dhe; **në Këshilla Bashkiakë**: për arsye të shërbimeve dhe programeve lokale, që ndikojnë drejtpërsëdrejti në përmirësimin e jetës së tyre dhe të të rinjve të tjerë.

Në asnjë statut që ne morëm në shqyrtim në seksionet që kanë të bëjnë me zgjedhjet, grupin parlamentar, përfaqësimin në pushtetin vendor etj, nuk u gjet ndonjë referencë që mund të garantonte një minimum të mundshëm të përfaqësimit të të rinjve. Ndonëse në dukje kjo mungesë nuk duket e qëllimshme, për më tepër që forumet e të rinjve janë pjesë e



vendim-marrjes në parti kur këto çështje diskutohen dhe miratohen, impakti që një mungesë e tillë përfaqësimi dhe pjesëmarrje ka tek të rinjtë është negativ.

Të rinjtë e partive politike, për shkak të konjunkturave dhe aleancave politike që krijohen, kanë shumë herë më pak mundësi për të luajtur një rol aktiv dhe influencuar ligjet, politikat dhe programet e reja, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel lokal. Për më tepër që ky rol i kufizuar iu jep shumë herë më pak mundësi atyre që të përgatiten për pjesëmarrjen e ardhshme të tyre në ligj dhe politikëbërje, krahasuar me të rinjtë që vijnë nga organizatat e shoqërisë civile, ku këta të fundit kanë mundësi më të mëdha për të ushtruar rolin e tyre.

## **vi. Financimi dhe rregullimi statutor i Forumeve Rinore**

Dy ndër konsideratat finale që u bënë pjesë e studimit dhe analizës sonë kishin të bënin me financimin e forumeve rinore dhe nëse ato janë të rregulluara nga statutet / rregulloret e tyre të veçanta. Në këtë aspekt një konsideratë pozitive është fakti që të gjitha forumet kanë statutet apo rregulloret e tyre, të ndara nga statutet e partive të tyre, pavarësisht rolit që ato gëzojnë brenda partive. Në parim mund të thuhet se patja e statuteve dhe rregulloreve të brendshme të veçanta, fuqizon rolin, pavarësinë dhe procesin e vendim-marrjes së brendshme në këto forume. Megjithatë, ashtu siç kanë deklaruar të rinjtë për këtë studim, nuk kanë munguar rastet kur drejtuesit e partive kanë ndërhyrë në vendim-marrjen e brendshme të Forumeve duke bashkë zgjedhur në pozicione drejtuese të rinj që nuk kanë qenë pjesë e tyre.

Një aspekt që ka një impakt negativ të pamatshëm tek Forumet Rinore është pavarësia e tyre financiare dhe pasja e burimeve të mjaftueshme të financimit. Pavarësisht rolit, fuqisë, aksesit në fonde apo madhësisë së partisë, një fakt shqetësues është mungesa e patjes së buxhetit të veçantë për çdo Forum Rinor. Në asnjë nga Statutet e partive politike, në pjesën ku rregullohen aspektet e menaxhimit financiar, nuk përmendet se cilat janë burimet e financimit apo sesi do të financohen Forumet Rinore nga buxheti i partisë. Kjo merr vlerë edhe më tepër për shkak se, me përjashtim të forumeve rinore të PS-së dhe PDIU-së, të gjitha forumet e të rinjve janë pjesë integrale e partisë, ku ata aderojnë. Në këtë drejtim partia ka një detyrim dhe përgjegjësi direkte për planifikimin dhe ndarjen e fondeve të veçanta për të mbështetur aktivitetet e të rinjve dhe organizatës së tyre.

Mungesa e buxhetit statutor, është një pikë nevrologjike për fuqizimin e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të të rinjve në vendim-marrjen e brendshme të partisë, pasi forumet rinore nuk kanë burime të mjaftueshme të mbështesin anëtarët e tyre me trajnime, aktivitete formuese apo edhe mbështetjen e aktiviteteve në komunitetet ku ata jetojnë. Mungesa e financimeve për forumin rinor, vjen jo vetëm si pasojë e burimeve të kufizuara financiare që një pjesë e mirë e partive politike kanë, por edhe për shkak të tendencës për të mbajtur nën kontroll çdo aspekt të organizimit të aktiviteteve nga ana e të rinjve të forumeve politike rinore në Shqipëri.

## 5.5 Matriksi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të të rinjve në vendim-marrje dhe në forumeve të tyre në partitë politike në Shqipëri

	PR	FRD	PD	LSI	PS	PBDNJ	PDIU
Mosha e anëtarësisë	16	16	15	16	15 /16 <sup>22</sup>	17	Pa limit
E drejta për t'u zgjedhur në organet vendim-marrëse të Partisë	18	16 <sup>23</sup>	15*	16*	16*	17	18
Forumi Rinor është pjesë integrale e organeve të Partisë	Jo	Jo	Jo	Jo	Po	- <sup>24</sup>	Po
Forumi Rinor është organizatë partnere e Partisë	Po	Po	Po	Po	Jo	-	Jo
Forumi Rinor përfaqësohet në Kongresin e Partisë	Po (1)	Jo	Po <sup>25</sup>	Po (30%)	Po (1)	Jo	-
Forumi Rinor është pjesë e Asamblesë Kombëtare <sup>26</sup>	Po (1)	Jo	Po (1)	Po (30%)	Po (1)	Po (1)	-
Forumi Rinor është pjesë e Kryesisë qendrore të Partisë	Jo	Po (1)	Po (1)	Po (30%)	Po (1)	Po (1)	Po (1)
Forumi Rinor është pjesë e Komitetit Drejtues të Partisë në Rreth	Po (1)	Jo	Po (1)	Po (30%)	Po (1)	Jo	Po (1)
Forumi Rinor është pjesë e Kryesisë së Partisë në Rreth	Po (1)	Jo	Po (1)	Po (30%)	Po (1)	Jo	Po (1)
Forumi Rinor është pjesë e seksionit bazë të Partisë	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
Forumi Rinor përfaqësohet automatikisht në Grupin Parlamentar të Partisë	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
Forumi Rinor përfaqësohet në parti me kuota specifike	Jo	Jo	Jo	Po	Jo	Jo	Jo
Forumi Rinor ka në dispozicion burime financiare të caktuara me statut	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
Forumi Rinor ka Statutin / Rregulloren e tij të veçantë	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po

<sup>22</sup> Në statutin e PS-së përmenden dy mosha minimale për anëtarësi: 15 vjeç për në FRESSH dhe 16 vjeç për në parti

<sup>23</sup> Me përjashtim të Partisë Republikane dhe Partisë Drejtësi, Unitet dhe Integritet, asnjë parti tjetër nuk e qartëson nëse të rinjtë e moshës 15-18 vjeç mund të zgjidhen në strukturat drejtuese të Partisë. Mungesa e kriterit “moshë” në statutet e këtyre partive, e le të hapur mundësinë statutores të kandidimit të çdo personi mbi moshën 15-16 vjeç edhe në organet drejtuese të partisë

<sup>24</sup> Në një pjesë të Statuteve nuk ka asnjë lloj reference apo përmendjeje të forumeve rinore apo rolit që ato kanë në forume të caktuara, si në nivel lokal ashtu edhe qendror, të partisë. Për këtë qëllim fushat janë lënë “të bardha”, gjë që tregon edhe nevojën për rregullime të mëtejshme në Statutet respektive, për të shprehur qartë rolet, nivelet, funksionet dhe përgjegjësitë që kanë organizatat rinore brenda partisë

<sup>25</sup> Statuti nuk e bën të qartë sesa është numri apo përqindja e të rinjve që mund të ndjekin Kongresin

<sup>26</sup> Emri *Asamble Kombëtare* është përdorur si një term përgjithësues. Parti të ndryshme përdorin terminologji të ndryshme për këtë organ vendim-marrës të partisë në nivel kombëtar

## 6. Analiza e të dhënave: Të rinjtë në vendim-marrje e politikëbërje në Shqipëri


### 6.1 Të dhëna statistikore rreth përfshirjes së të rinjve në vendim-marrje e politikëbërje

#### 6.1.1 Pjesëmarrja e të rinjve në vendim-marrje e politikëbërje në nivel qëndror në Shqipëri

Shqipëria ka një popullsi relativisht të re krahasuar me vendet e rajonit. Censusi i vitit 2011 tregon se mosha mesatare e popullsisë rezidente është rreth 35 vjeç. Në këtë kapitull është bërë një analizë e treguesve kryesorë të identifikuar për të matur pjesëmarrjen e të rinjve në disa nivele të vendim-marrjes.

##### a) Të rinjtë në Kuvendin e Shqipërisë<sup>27</sup>


Të 140 deputetët e Kuvendit të Shqipërisë zgjidhen nga dymbëdhjetë zonat zgjedhore, analoge me dymbëdhjetë qarqet. Brenda zonave zgjedhore, deputetët zgjidhen me përfaqësim proporcional në lista të mbyllura, me një prag zgjedhor prej 3% për partitë dhe 5% për koalicionet. Në zgjedhjet e qershorit 2013, Partia Socialiste, që fitoi numrin më të madh të deputetëve (61 deputetë), kishte në lista vetëm 4 deputetë të rinj (6.5%), Partia Demokratike nga 46 deputetë (8.6%), sërish erdhi me 4 deputetë të rinj, që u ulën në Parlamentin e vendit. Në përqindjen e përgjithshme, *Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, në raport me partitë e tjera, ka numrin më të madh të deputetëve të rinj* (2 nga 17 të zgjedhur në parlament, ose 11.7%). Ndërkohë që partitë e tjera nuk kanë asnjë të ri në radhët e të zgjedhurve të tyre (Grafiku 3). Përmbledhtazi mund të themi se të rinjtë të ulur në parlamentin shqiptar janë vetëm 7.1%, pavarësisht partive të cilave u përkasin.



Grafik 3: Deputetë të rinj në Kuvendin e Shqipërisë

<sup>27</sup> Deputetë të rinj në parlamentin e zgjedhur në 23 Qershor 2013, e përditësuar sipas ndryshimeve të ndodhura në përbërjen e Kuvendit të Shqipërisë deri në Mars 2015

Ndërkohë, grafiku 4 më poshtë, na njeh me ndarjen gjinore të deputetëve të rinj sipas forcave politike, ku në një total prej 10 deputetësh të rinj (7.1% e totalit të deputetëve në parlament), 6 janë gra (60% e deputetëve të rinj) dhe 4 janë burra (40% e deputetëve të rinj). PS ka numrin më të lartë të deputeteve të reja 3 nga 4 në total (75%), LSI nuk e ruan balancën gjinore, por këtë radhë në favor të vajzave/grave të reja deputete, 2 nga 2 në total (100%) dhe PD ka përfaqësimin më të ulët të vajzave/grave të reja deputete, 1 nga 4 (25%).




**Grafiku 4:** Deputetë të rinj sipas gjinisë në parlamentin e zgjedhur në 23 Qershor 2013 (e përditësuar sipas ndryshimeve deri në Mars 2015)

## b) Të rinjtë në Qeverinë e Shqipërisë

Qeveria e re, e krijuar në shtator të vitit 2013, ka 21 ministra, nga të cilët vetëm 3 ishin në moshën nën 35 vjeç<sup>28</sup>, në kohën e marrjes së këtij posti. Nëse marrim parasysh se rreth gjysma e popullsisë së vendit (45%) është nën moshën 30 vjeç atëherë, kjo është një përqindje relativisht e ulët.


Po të krahasojmë me qeverisjen e shkuar, mund të themi se kemi një përmirësim në përfshirjen e të rinjve në nivelin më të lartë të qeverisjes, duke qenë se në qeverinë paraardhëse nuk kishim asnjë të ri në qeveri dhe kishim vetëm një grua, në pozicionin e Ministres së Integritit. *Grafiku 5* na njeh më në detaje me përfshirjen aktuale të të rinjve në nivel ministrash, ku nga 21 ministra vetëm 14% (3 ministra) e tyre janë të rinj.

<sup>28</sup> Sajmir Tahiri, Ministër i Punëve të Brendshme (PS); Klajda Gjoshja, Ministre e Integritit (LSI); Erjon Veliaj, Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (PS)



**Grafiku 5.** Të rinj në qeverinë Shqiptare – Mars, 2015

Duke patur parasysh të dhënat në grafikun 6, vërehet se nga numri total i 30 zv.ministrave, aktualisht (Mars, 2015) 20% e tyre janë të rinj (6 zv.ministra)<sup>29</sup>, me një balancë perfekte gjinore (3 burra, kundrejt 3 grave të zgjedhura në poste zv.ministrash).




**Grafiku 6.** Zv.Ministra, Mars 2015

<sup>29</sup> Erisa Xhixho, Zv.Ministre e Integritimit Evropian; Gentian Elezi, Zv.Ministër i Integritimit Evropian; Odeta Barbullushi, Zv.Ministre e Punëve të Jashtme; Arbj Mazniku, Zv.Ministër i Arsimit dhe Sportit; Dorian Duçja Zv.Ministër i Energjisë dhe Industrisë, Oliana Ifti, Zv. Ministre e Mjedisit

### 3.3.1 Pjesëmarrja e të rinjve në vendim-marrje e politikëbërje në nivel vendor në Shqipëri

#### a) Të rinjtë në krye të Bashkive

Shqipëria në momentin që u ndërmor studimi (Dhjetor 2014) ishte e ndarë në 65 bashki, ndërsa Bashkia e Tiranës ishte e ndarë në 11 njësi vendore (minibashki). Ndërkohë që në kohën e përfundim të studimit, Shqipëria zbatoi për herë të parë një sistem të ri të ndarjes administrative, ku u eliminuan të gjitha komunat dhe i gjithë teritorri i vendit u nda në 61 Bashki. Rezultatet e zgjedhjeve vendore të vitit 2011 dhe 2015 janë analizuar më poshtë në Grafikon Nr. 7, ku paraqiten sesi ka ndryshuar përfaqësimi i të rinjve në krye të Bashkive në Shqipëri.



Nga të dhënat për kryetarë/e bashkish, ku kemi parasysh Zgjedhjet Vendore të vitit 2011, do të shohim se gjithsej janë 76 kryetarë, nga të cilët vetëm 4 kanë qenë në moshën nën 35 vjeç<sup>30</sup>. Po në këtë vit asnjë prej të zgjedhurve nën moshën 35 vjeç nuk ishte grua/vajzë, ndërkohë që tre prej tyre janë përfaqësues të PS-së dhe 1 është përfaqësues i PD-së. Ndërkohë që në zgjedhjet vendore të vitit 2015, shihet një rritje e vogël prej 3% e kryetarëve të Bashkive që drejtohen nga të rinj nën moshën 35 vjeç, teksa 92% e bashkive anembanë vendit drejtohen nga persona mbi këtë moshë. Të dhënat paraqiten në grafikon 7.

Rezultatet e zgjedhjeve vendore të vitit 2015 gjithashtu tregojnë se meshkujt nën moshën 35 vjeç përbëjnë shumicën me 4 të rinj kryetarë të bashkive dhe vetëm 1 femër kryetare e Bashkisë Prenjas. Po ashtu të dhënat tregojnë se e majta ka 4 të rinj në pozicione drejtuese, ndërsa e djathta vetëm 1, në Bashkinë Devoll.


<sup>30</sup> Krenar Cenollari (PS), Njësia Nr.6. Tiranë; Klement Ndoni (PS), Bashkia Këlcyrë; Alfred Qafa (PD), Bashkia Fushë-Arrëz; Erjon Koka (PS), Kryetar i Njesisë Bashkiake nr.7 Tiranë

## b) Të rinjtë në këshilla bashkiakë në Shqipëri

Kështu po t'i referohemi këshillave bashkiakë në Shqipëri (grafiku 8), në bazë të të dhënave të mbledhura për vitin 2011, rezulton se rreth 85% e personave të zgjedhur janë të moshës mbi 35 vjeç, ndërkohë që 10% e tyre i përkasin moshës nën 35 vjeç. Për rreth 4.6% të tyre mungon informacioni në lidhje me moshën. Po të krahasohet me moshën e kryetarëve të bashkive, kjo është një shifër disi më e lartë, por sërish në vlerë absolute, mbetet mjaft e ulët.

Ndërkohë që rezultatet e zgjedhjeve të vitit 2015, sjellin një panoramë thuajse tërësisht të ndryshme nga ajo e vitit 2011 dhe vihet re thuajse një trefishim i përfaqësimit të të rinjve në Këshillat Bashkiakë. Kështu nga 10% që ishte përfaqësimi në vitin 2011 në fund të Qershorit 2015, të rinjtë në këshilla përbëjnë 26,4% të të gjithë anëtarëve, duke ulur ndjeshëm edhe përfaqësimin e moshës mbi 35 vjeç në Këshilla.


Ndonëse mungon ende një analizë e detajuar e të gjithë faktorëve që kanë çuar në këtë rritje të konsiderueshme të numrit të të rinjve në Këshilla Bashkiakë, studiuesit mendojnë se vendosja e kuotës 50% për pjesmarrjen dhe përfaqësimin e grave dhe vajzave në listat për këshilltarë për çdo parti politike e kombinuar kjo me rritjen e presionit të shoqërisë përkundrejt politikanëve për rinovimin e klasave politike, kanë qenë ndër faktorët kryesorë të rritjes së përfaqësimit të të rinjve dhe të rejave në Këshillat Bashkiakë.



**Grafiku 8.** Moshë e këshilltarëve në këshillat bashkiakë në Shqipëri

Përsa i përket moshës së këshilltareve vajza/gra në këshillat bashkiakë në të gjithë vendin gjatë vitit 2011 u vu re se nën moshën 35 vjeç ishin 17 % e tyre dhe mbi këtë moshë ishin 83 % (Grafiku 9). Ndërkohë, të dhënat paraqesin një panoramë më të ndryshuar, pas daljes së rezultateve të zgjedhjeve të vitit 2015. Në total vajzat dhe gratë e reja nën moshën 35 vjeç përbëjnë 43% të të gjithë numrit të zonjave në Këshilla Bashkiakë dhe ato mbi 35 vjeç


përbëjnë rreth 57%. Ajo çka shihet është një rikonfigurim i gjerë i Këshillave Bashkiakë, ku tashmë përfaqësimi i vajzave dhe gratë të reja është thujse trefishuar.



**Grafiku 9.** Numri i këshilltareve vajza/gra në Këshillat Bashkiakë të Shqipërisë


Pavarësisht se Kuvendi i Shqipërisë në Prill 2015 miratoi vendosjen e një kuote gjinore të barabartë (50-50) midis burrave dhe grave, për përfaqësimin në listat e kandidatëve për anëtarë të Këshillave Bashkiake, rezultatet e zgjedhjeve të vitit 2015 treguan se kjo masë nuk ishte e mjaftueshme që të garantonte përfaqësim të barabartë në dalje, pra një numër të barabartë të anëtarëve fitues për këshilla ndërmjet burrave dhe grave në Shqipëri.

Siç shihet edhe nga grafiku i mëposhtëm (Grafik 10) vajzat dhe gratë në total përbëjnë vetëm 34% të anëtarëve të Këshillave, ndërkohë që burrat kontrollojnë rreth 66% të tyre. Megjithatë siç shihet edhe nga Grafiku Nr. 10, rritja e përfaqësimit të grave dhe vajzave si anëtare të këshillave bashkiake, ka sjellë edhe një ulje me rreth 17% të përfaqësimit të meshkujve në këshilla dhe një rritje me 19% të femrave në to.




**Grafiku 10.** Numri i grave dhe vajzave anëtare të Këshillave Bashkiakë e krahasuar me burrat





**Grafiku 11.** % e grave dhe vajzave anëtare të Këshillave Bashkiakë e krahasuar me burrat

Nga ana tjetër, kur shohim sesi janë të përfaqësuar vetëm djemtë dhe burrat nën moshën 35 vjeç, krahasuar me ata mbi këtë moshë, shohim disa tregues interesantë edhe sesi funksionon politikë-bërja në përgatitjen e listave për anëtarë të këshillave bashkiakë, kur nuk ka kuota të vendosura në lidhje me përfaqësimin e të rinjve në vendim-marrjen lokale.




**Grafiku 12.** Moshë e këshilltarëve meshkuj në këshillat bashkiakë në Shqipëri 2011-2015 (në %)

Siç edhe shihet nga Grafiku Nr. 12, pavarësisht se rezultatet e zgjedhjeve të vitit 2015 sollën një dyfishim të numrit dhe përqindjes së anëtarëve meshkuj nën moshën 35 vjeç si anëtarë të Këshillave Bashkiakë, përsëri numri i tyre është shumë herë më i ultë sesa ai i vajzave dhe grave të të njëjtës moshë. Ka një diferencë të theksuar midis përqindjes të meshkujve nën moshën 35 vjeç, ku gjatë 4 viteve ajo u rrit nga 9 në 18%, krahasuar kjo me meshkujt mbi moshën 35 vjeç, të cilët në vitin 2011 përbënin 91% të këshilltarëve meshkuj dhe në vitin 2015 rreth 82%. Me pak fjalë mund të thuhet që të humburit më të mëdhenj të zgjedhjeve të fundit vendore janë djemtë dhe burrat e rinj nën moshën 35 vjeç.

### c) Ndarja sipas forcave politike e këshilltarëve nën moshën 35 vjeç

Duke u bazuar në të dhënat e grafikut më poshtë (grafiku 13), vihet re se numri i këshilltarëve me moshë nën 35 vjeç në vitin 2011 është më i madh për Partinë Socialiste me rreth 64 këshilltarë, duke vijuar me Partinë Demokratike që arrin në 28 këshilltarë, e ndjekur nga Partia PDIU me 18 këshilltarë në moshë të re. Për të vijuar me partinë e radhës LSI që ka 15 këshilltarë nën moshën 35 vjeç, G99 me 7 këshilltarë, PDS 6 këshilltarë. Ndërkohë që partitë e tjera të vogla janë në vlerën 4 këshilltarë, 2 këshilltarë dhe pjesa më e madhe e tyre në 1 këshilltar nën moshën 35 vjeç.




Zgjedhjet Vendore 2015 prodhuan rezultate më pozitive për pjesmarrjen e të rinjve në vendim-marrjen lokale, krahasuar me rezultatet e vitit 2011. Megjithatë siç shihet nga Grafiku Nr. 13, forcat kryesore politike vazhdojnë të mbajnë peshën kryesore në këtë drejtim. Edhe për vitin 2015, vazhdon ta kryesojë listën e këshilltarëve nën moshën 35 vjeç, Partia Socialiste me 68 këshilltarë bashkiakë në nivel kombëtar, e ndjekur nga PD me 30, LSI me 21 dhe PDIU me 19. Në tërësi mund të thuhet se çdo forcë politike në listat e asaj ka arritur të promovojë të rinjtë, por partitë më të mëdha kanë bërë diferencën në pasjen e një numri më të lartë të anëtarëve të zgjedhur në Këshilla Bashkiakë nën moshën 35 vjeç.

### d) Ndarja sipas forcave politike të këshilltarëve djem/burra nën 35 vjeç


Në këtë grafik (14) mund të shohim se rezultatet e zgjedhjeve vendore 2011 dhe 2015 nuk prodhuan ndonjë diferencë të madhe për djemtë dhe burrat nën 35 vjeç për asnjë nga forcat politike në Shqipëri. Ashtu siç shihet edhe në grafik, rritja e përfaqësimit nga partia në parti, është thuajse neglizhente si në shifra ashtu edhe në përqindje. Të dhënat tregojnë se Partia Socialiste ka numrin më të lartë të këshilltarëve meshkuj nën 35 vjeç, e ndjekur nga PD, LSI, PDIU, G99, PR etj.

**Grafiku 14. Forca politike e këshilltarëve djem/burra nën 35 vjeç**



**e) Ndarja sipas forcave politike të këshilltareve vajza/gra nën 35 vjeç**

Ashtu sic dhe vihet re nga grafiku 15, numri i këshilltareve vajza/gra në moshë të re është më i vogël se grafiku për këshilltarët djem/burra si gjatë vitit 2011, ashtu edhe gjatë vitit 2015. Pavarësisht këtij fakti, është interesant të shihet impakti që ka patur vendosja e kuotës gjinore 50% për të dyja gjinitë, në rritjen e përfaqësimit të vajzave dhe grave nën 35 vjeç, në Këshilla në zgjedhjet e fundit vendore. Diferencën më të madhe e kanë bërë përsëri partitë kryesore parlamentare, si: PS, PD, LSI dhe PDIU. Ndërkohë është evidente që partitë e vogla politike, vazhdojnë të kenë probleme të përfaqësimit të grave dhe vajzave të reja në Këshillat Bashkiakë në Shqipëri.



**Grafiku 15. Forca politike e këshilltareve vajza/gra nën 35 vjeç**

## 3.4 Analizë e të dhënave cilësore

### 3.4.1 Modele sukcesi të të rinjve në vendim-marrje në nivel qëndror e vendor

Me qëllim demonstrimin e disa prej praktikave më të mira të të rinjve në nivele vendim-marrëse, më poshtë gjeni disa profile të të rinjve e të rejave vendim-marrës/e (deputet/e, kryetarë njësisish vendore) përfaqësues të tre partive kryesore në Shqipëri.

Ndërtimi i profileve u bazua mbi bazën e intervistave të realizuara në kuadër të këtij studimi, me qëllim për të kuptuar në vetë të parë përjetimet dhe eksperiencat e disa prej të rinjve të suksesshëm në sferën politike shqiptarë në nivel vendor e qëndror.

Të gjithë të intervistuarit, pavarësisht gjinisë, forcës politike që ata përfaqësojnë, pozicionit që mbartin, nivelit të përfaqësimit (vendor apo qëndror) apo moshës që varion nga 21 deri 35 vjeç ( në momentin e zgjedhjes në pozicionin që mbajnë) shprehen se rrugëtimi drejt suksesit në vendim-marrje e politikëbërje është me shumë pengesa, kërkon shumë mund e sakrificë, ndërkohë lehtësohet në proporcion të drejtë me mbështetjen sociale e politike që u jepet të rinjve.

Ndërkohë që eksperiencat personale që ata ndajnë me ne janë aq sa të ngjashme por edhe të ndryshme nga njëra tjetra, refreni që karakterizon mesazhet e tyre për të rinjtë mbetet i njëjti: “Askush më mirë se të rinjtë nuk mund t’i mbrojë interesat e të rinjve.

Bota e politikës është e komplikuar dhe shumë problematike në Shqipëri, por me përgatitjen e duhur, besim, vullnet e shumë punë, të rinjtë mund t’ja dalin të ngjiten në majat më të larta të vendim-marrjes e politikëbërjes”.

Për më shumë rreth rrugëtimit politik të të rinjve e të rejave të intervistuar/a gjeni më poshtë një përmbledhje të asaj çka ata ndanë me ne.

**Esmeralda Shkja**

**Deputete e Qarkut Durrës**

**Mosha: 32 Vjeç**

**Forca politike: PS**

Esmeralda Shkja është një nga deputetet më të reja të Partisë Socialiste. Pas mbarimit të studimeve në Gjermani vendos të angazhohet me rininë e qytetit të Durrësit. Fillimisht ka qenë koordinatore e disa zonave elektorale në Durrës dhe më pas u bë pjesë e listës së kandidatëve si kryetare e FRESSH-it të qytetit bregdetar. Ajo rrëfen se është përballur me shumë vështirësi, veçanërisht me konkurrencën e egër brenda në forum ku ka patur shumë përplasje, por me vendosmëri si dhe mbështetjen e familjes ajo ja ka dalë mbanë. Sipas saj, angazhimi në politikë sjell vështirësi e shpeshherë bëhet tepër agresiv dhe nevojitet që të jesh i/e fortë dhe i/e vendosur drejt qëllimeve dhe idealeve të tua.

Një nga arsyet që e shtynë atë të angazhohej në politikë ishte dëshira për të ecur përpara në këtë fushë aq sa të bukur por edhe të vështirë. Gjatë këtij rrugëtimi ka patur pranë vetes familjen, shtysën kryesore pa të cilën ajo shprehet se nuk do ishte aty ku është sot.

Esmeralda i këshillon të rinjtë të cilët duan të ndjekin rrugën e saj, se për t'ja dalë mbanë në politikë duhet të mos dorëzohen kurrë, pasi në këtë rrugë duhet shumë punë. Mund të të duhet të punosh pa orare, si dhe të kalosh ditë dhe netë të tëra larg familjes dhe njerëzve të tu më të rëndësishëm për hir të angazhimeve politike, pra të merresh me politikë kërkon angazhim serioz, përgatitje dhe gadishmëri të vazhdueshme për t'ja dalë me sukses.

Si një e re në politikë ajo pranon faktin se të rinjtë shqiptarë hasin vështirësi të mëdha pasi shpesh nuk janë të informuar se ku po përfshihen dhe për çfarë idealesh po japin kontributin e tyre politik. Ndaj ajo mendon se duhet të ndryshojë mentaliteti i organizimit të të rinjve, duke u bërë më të bashkuar dhe më aktivë, të shpallin programin e tyre të rinisë dhe të jenë proaktivë në çdo kohë, dhe jo vetëm gjatë fushatave zgjedhore. Gjithashtu ajo është e mendimit se në rrugën drejt suksesit, nuk ka rëndësi gjinia por përgatitja dhe vendosmëria e individit.

Për të shtuar numrin e të rinjve në vendim-marrje e politikëbërje ajo shprehet se duhet që të rinjtë të vendosen në plan të parë, duke qenë se shqiptarët janë popull i ri dhe rinia në Shqipëri përbën një përqindje të konsiderueshme të popullatës, e për rrjedhojë të drejtat dhe problematikat e tyre duhen trajtuar me rëndësi dhe prioritet të veçantë. Lidhur me të qenit të suksesshëm në këtë rrugëtim, ajo e mbyll këtë rrëfim me fjalët: *“Besoni në politikë, siç besova unë, pasi ndryshimi vjen nga kontributi ynë. Sa më shumë kontribute dhe sakrificat të bëni për të krijuar profilin tuaj në drejtimin politik që keni zgjedhur, aq më me vlerë dhe rëndësi do të jetë angazhimi juaj në arenën politike. Me punë, vendosmëri dhe durim do të arrini të kuptoni se të bërit politikë kërkon seriozitet, punë dhe sakrificë, por në fund sjell frytet e veta.”*

## Profil 2: Kejdi Mehmetaj

### **Kejdi Mehmetaj**

#### **Deputete e Qarkut Tiranë**

**Mosha: 21 vjeç**

**Forca politike: LSI**

Kejdi Mehmetaj është deputetja më e re në historinë e Kuvendit të Shqipërisë dhe përfaqëson Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim, e cila mori mandatin e deputetes në moshën 21-vjeçare. Ka filluar të përfshihet në Forumin Rinor të LSI-së që në moshën 15-vjeçare. Ajo ka qenë gjithmonë e interesuar të jetë pjesë e vendim-marrjes që herët në shkollë duke u bërë pjesë aktive e strukturave vendim-marrëse të shkollës, siç është senati. Familja ka qenë mbështetësja dhe kritikja e saj më e vyer gjatë rrugëtimit të saj të vrullshëm e të hershëm në politikë.

Fillimisht, kur sapo u bë pjesë e forumit rinor të LSI-së ajo ka koordinuar aktivitetet në gjimnazin ku studionte dhe më pas ka vijuar duke koordinuar aktivitetet e partisë për të gjitha gjimnazet e kryeqytetit. Gjatë këtyre organizimeve ajo filloi të krijonte lidhje me një nga grupimet e LSI-së në një njësi vendore të Tiranës dhe në këtë mënyrë, hap pas hapi filloi të lidhej edhe me minibashkitë e tjera. Organizimi i aktiviteteve e bëri atë të njohur në të gjitha njësitë e LSI-së për Tiranën dhe në zgjedhjet e forumit rinor ajo u zgjodh nënkryetare e LRI dhe gjithashtu e gjeti veten pjesë të Kryesisë së Partisë. Angazhimi në forumin rinor të LSI-së i ka kërkuar që të kalojë çdo ditë të javës duke organizuar aktivitete të ndyshme lidhur me forumin. Që nga dita e parë që ka vendosur të jetë pjesë e këtij forumi ajo vazhdon ta frekuentojë atë rregullisht çdo ditë.

Ajo shprehet se kandidimi për deputete në Partinë që ajo i përket është bërë në mënyrë shumë demokratike. Gjithashtu, ajo thekson se me kërkesë të kryetarit të partisë, mes shtatë emrave të parë për kandidatë për deputet në qarkun e Tiranës, dy emra duhet të ishin të rinj. Duke ndjekur këtë udhëzim, drejtuesit e partisë janë mbledhur dhe kanë vendosur lidhur me listën fituese dhe emri i saj u vendos të vihej i shtati në listë. Ajo shprehet se nuk e kishte menduar kurrë se do të mund të arrinte të futej në parlament, por kuotat gjinore kanë bërë të mundur që ajo të bëhej pjesë.

Kejdi tregon se në parlament ajo është trajtuar fillimisht nga kolegët si vajzë e vogël dhe i janë qasur të gjithë me dashamirësi prej të rrituri, por me kalimin e kohës dhe duke punuar shumë ajo po përpriqet që të shihet prej tyre si një kolege me potencial. Moshën e saj të re ajo e sheh si avantazh dhe si një mundësi të artë për të përfaqësuar dy grupime sociale shumë të rëndësishme, të rinjtë dhe vajzat e gratë e Shqipërisë.

Kejdi shprehet e bindur se të rinjtë në LSI kanë mundësi konkrete të përfshihen në vendim-marrje, si dhe në kryesinë e partisë. Sipas saj, kush është i përgatitur, ka vullnet dhe angazhohet me pasion e dëshirë për t'u rritur në politikë, arrin të marrë vlerësimin e merituar dhe i jepet mundësia të bëhet pjesë e vendim-marrjes.

Deputetja më e re në historinë e parlamentit shqiptar ndjek me interes çdo seancë parlamentare dhe çdo komision ku ajo është pjesë. Siç mund të pritët nga një përfaqësuese e të rinjve, shumica e çështjeve që ajo ka ngritur kanë pasur në fokus çështjet rinore. Edhe pse këto janë çështje që nuk janë në fokus të seancave parlamentare ajo vazhdon të adresojë problematikat e të rinjve, sidomos ato çështje që forumi rinor i LSI-së i sheh si prioritare.

### Profil 3: Krenar Cenollari

#### **Krenar Cenollari**

**Kryetar i Njësisë Bashkiake nr.6, Tiranë**

**Mosha: 33 vjeç**

**Forca politike: PS**

Krenar Cenollari, shprehet se vendosi të bëhet pjesë e aktiviteteve politike që ka pasur Njësia Bashkiake nr.6 ndër vite, për të dhënë kontributin e tij personal në zhvillimin dhe ndryshimin e kulturës së vjetër politike, për të qenë pjesë e kontributit dhe ndryshimit real në organizim, duke parë situatat shqetësuese politike, sociale, ekonomike në njësinë ku banonte. Gjithashtu, për të kjo ishte një mënyrë për t'i dhënë mundësi vetes që kapacitetet dhe aftësitë e veta, t'i vinte në funksion të forcës politike në të cilën ai aderonte. Ai beson se të rinjtë kanë vullnetin, energjinë dhe mentalitetin e duhur për të bërë ndryshimin e pritur në politikëbërjen shqiptare.

Krenari prej vitesh ka qenë pjesë kontribuese e Partisë Socialiste. Ai shprehet se nuk ka qenë e lehtë të sfidojë mendësitë brenda partisë lidhur me përfshirjen e të rinjve në vendim-marrje, pasi rruga për të rinjtë ishte e mbyllur duke mos ju dhënë mundësia për të kontribuar me mendime dhe sygjerime. Sipas tij, kishte ardhur momenti për të ndryshuar rrënjësisht mentalitetin e krijuar prej vitesh. Lufta e brendshme ishte shumë e fortë dhe tepër e vështirë, por besimi tek vetja, tek aftësitë dhe njohuritë e tij e bënë që të vazhdonte përpjekjet e tij për të ndryshuar sadopak situatën në njësinë e tij bashkiake.

Krenari na tregon se ndikim të madh në rrugëtimin e tij politik ka pasur fakti që kandidati për deputet i zonës ishte një i ri i cili i mbështeti shumë të rinjtë duke u dhënë prioritet problemeve të rinisë në tërësi. Falë mbështetjes së tij, Krenari u zgjodh si kandidat për drejtimin e Njësisë. Gjatë fushatës ai angazhoi shumë të rinj të tjerë të cilët sollën një frymë të re dhe një imazh të ri në mesin e partisë. Në këndvështrimin e tij, një nga pikat e forta të kandidimit të tij ishte pikërisht përfshirja e të rinjve. Shumë nga ata të rinj që u angazhuan janë sot bashkëpunëtorët e tij në vendim-marrje në drejtimin e Njësisë që ai drejton.

Ai mendon se e ardhmja e çdo shoqërie evropiane dhe demokratike fillon nga rinia, ndaj ai beson se të rinjtë duhet të jenë pjesë aktive në politikë. Vështirësitë janë të shumta për të rinjtë që duan të jenë pjesë e vendim-marrjes. Shpeshherë pengesë për përfshirjen e të rinjve janë politikanët e vjetër të cilët i shohin ata si kërcënim për pozicionet e tyre. Ai këshillon të rinjtë që të bëhen medoemos pjesë e mendimit dhe e diskutimit të çështjeve që kanë të bëjnë me vendim-marrje e politikëbërje që lidhen drejtpërdrejt apo tërthorazi me të ardhmen e tyre.

Duke përfunduar intervistën ai shton se rolin kryesor në këtë proces gjithëpërfshirës të të rinjve e kanë strukturat e partive, të cilat duhet të kenë programe të brendshme për të rinjtë në vendim-marrje duke u dhënë mundësinë atyre të jenë pjesë e stukturave, ku mund të japin mendime për reforma thelbësore në të cilat realisht përfaqësohet qëndrimi i të rinjve.

## Profil 4: Jorida Tabaku

**Jorida Tabaku**

**Deputete e Qarkut Tiranë**

**Mosha: 35 vjeç**

**Forca Politike: PD**

Jorida Tabaku, një nga 6 deputetet e reja të Kuvendit të Shqipërisë, në fillimet e saj në politikë ka qenë një simpatizante dhe pjesë e strukturave të PD-së që nuk e kishte projektuar veten e saj me një të ardhme si politikane. Ka qenë një rastësi që në një prezantim të mbajtur nga Jorida, ka qenë prezent edhe ish-kryeministri i asaj kohe, i cili i ka propozuar të niste karrierën e saj në politikë si zv.ministre e njëkohësisht si e deleguar në një nga zonat më të vjetra të Tiranës. Ajo rrëfëhet se ka qenë një vendim i vështirë dhe tërësisht politik. Kështu, në vitin 2009, Jorida u emërua Zv.ministre e Integritimit Evropian, një pozicion që ajo e mbajti deri në mes të vitit 2011. Në 2011, Jorida kryesoi listën e anëtarëve të Këshillit Bashkiak të Tiranës për PD-në dhe në Korrik 2011 ajo u emërua nënkryetare e Bashkisë së Tiranës. Në zgjedhjet parlamentare të Shqipërisë të vitit 2013, Jorida u zgjodh deputete e PD-së për qarkun e Tiranës dhe aktualisht është edhe zëdhënëse e Grupit Parlamentar të PD-së dhe anëtare e Komisioneve Parlamentare të Ekonomisë dhe Financave, si dhe Integritimit Evropian.

Si çdo profesion tjetër në jetë, ajo ka patur pësimet që i janë kthyer në mësim që i kanë shërbyer në këto vite politike aktive, ku mbështetja konstante në çdo hap ka qenë familja e saj. Ndër pikat e saj të forta ajo përmend dëshirën për të punuar dhe për të arritur qëllimet që i ka vënë vetes, nën parimin se dikush që dëshiron të bëhet një politikan duhet të përpiqet për ta fituar apo edhe për ta ruajtur atë që e arrin, duke u kujdesur të mos shndërrohet në një person pa parime në shërbim të asaj që kërkon. Në stilin e saj të punës, ajo preferon më së shumti të dëgjojë mendime dhe argumentime të ndryshme për të qenë kështu sa më bashkëpunuese e sa më pranë anëtarëve të forumeve rinore por edhe të njesisë ku operon si përgjegjëse. Jorida shprehet se ndër qëllimet e saj kryesore që në fillimin e eksperiencës së saj në vendim-marrje e politikëbërje ka qenë adresimi i çështjeve që prekin të rinjtë, duke qenë se vinte edhe nga një eksperiencë e pasur pune e lidhur drejtëpërdrejtë me të rinjtë.

Në një vend si Shqipëria ku duket se e shkuara komuniste e ka transformuar politikën vetëm në çështje partie, Jorida është e mendimit se të rinjtë, jo për fajin e tyre, janë pre e skepticizmit total ndaj politikës, ndërkohë që një pjesë e këtyre të rinjve besojnë se mund të përfitojnë nga politika atë që nuk e fitojnë dot në një mënyrë të drejtë. Jorida mendon se është e rëndësishme dhënia e mundësive të rinjve për të qenë të përfaqësuar në çdo nivel politik, jo vetëm në bazën e partisë por dhe në strukturat më të larta, duke filluar me qeverisjen lokale si në këshilla bashkiakë e deri në parlament, duke u dhënë kështu një mundësi konkrete të rinjve që të jenë një zë i qenësishëm në politikëbërje dhe në vizionin politik të partisë. Por ajo beson, se *duhet të jenë vetë të rinjtë ata që përpiqen për të fituar të drejtat e tyre*, qofshin edhe kuotat në një parti politike, duke vepruar e mos prititur t'u falen mundësira, sepse ata kanë vullnetin, idealizmin por edhe energjinë për t'i bërë ballë sfidave.



### 3.4.2 Të rinjtë në politikëbërje, pjesë të organizmave rinore politike dhe shoqërisë civile

#### a) Pikëpamjet e të rinjve të forumeve rinore të partive politike në lidhje me përfshirjen e të rinjve në politikë e vendim-marrje

- *Mundësitë reale për përfshirje në strukturat e partisë apo vendim-marrjen qëndrore/vendore*

Megjithëse të dhënat na tregojnë së përqindja e të rinjve në struktura vendim-marrëse dhe politikëbërëse në momentin që u ndërmor ky studim (Dhjetor 2014 – Mars 2015) është shumë e ulët, liderët e FRPP-ve shprehen optimistë në lidhje me mundësitë për të zënë një vend të rëndësishëm në strukturat e partisë, përpos FRPP-ve, për shembull si deputetë, si anëtarë të këshillave bashkiakë, sidomos në zonat ku Partia ka më shumë mbështetje/interes të marrë pjesë (kjo pasi disa parti të vogla për shkak të vetë fokusit të tyre orientohen të punojnë më shumë në zona të caktuara). Sipas të rinjve, historiku i disa partive na tregon se duke punuar më shumë brenda FRPP-ve e përtej, mund të jetë e arritshme që në zgjedhjet e ardhshme qëndrore të mund të jenë pjesë e listave për deputet të partive të tyre. Nuk shihen pengesa madhore nga të rinjtë, sidomos tek FRPP-të e partive më të vogla ku konkurrenca është më e ulët, por edhe marrëdhënia me drejtuesit e partive është relativisht më e ngushtë dhe direkte.

Në disa raste, liderët e FRPP-ve janë aktualisht politikanë apo të përfshirë në detyra të rëndësishme brenda vendim-marrjes partiake, por edhe asaj qëndrore e lokale. Duke qenë se një pjesë e tyre mendojnë se janë aty sepse kanë punuar fort dhe e kanë merituar, e shikojnë si të realizueshme rritjen e tyre brenda partisë, pasi në perceptimin e tyre mbështetja nuk u mungon. Gjithashtu ata nuk e ndjejnë veten të paragjykuar për shkak të moshës së tyre të re. Nga ana tjetër, ka raste kur lider të FRPP-ve shprehen se pavarësisht dëshirës për t'u bërë politikanë aktivë, do të donin që më parë të njihnin më nga afër pjesën administrative dhe më pas të bëheshin pjesë e saj në nivel vendim-marrës, pavarësisht kohës që ky kalim do të kërkonte.

- *Përfaqësimi i të rinjve në vendim-marrje e politikëbërje*

Sipas të rinjve të konsultuar, duhet lobuar sa më shumë dhe me vendosmëri për të bërë të mundur përfshirjen e të rinjve në listat e sigurta të partive. Zgjidhja më e mirë do të ishte krijimi i një mekanizmi që siguron që në lista të ketë më shumë të rinj. Vendosja e një kuote për të rinjtë (sugjerimet variojnë nga 10 deri në 20%) në nivel vendim-marrës sipas tyre mund të lehtësonte këtë proces, sipas modelit të kuotës gjinore.

Gjithashtu ata janë të mendimit që duhet të ketë akte ligjore që mbrojnë FRPP-të dhe sigurojnë respektimin e statuteve/rregulloreve të brendshme përkatëse. Përfaqësimi sa më i lartë në asambltetë e partive gjithashtu vlerësohet si vërtet i rëndësishëm. Ata propozojnë

që të paktën 15% e asambleve të partive të jenë të rinj. Kjo përqindje, mund të vendoset si një tavan fillestar sipas tyre.

Pavarësisht vendosmërisë që ata shprehin lidhur me nevojën për përfaqësim më të lartë të rinisë në struktura vendim-marrëse e politikëbërëse, të rinjtë nuk e fshehin zhgënjimin që vendim-marrësit në fund gjejnë manovra që t'i vendosin të rinjtë në fund të *listës*, siç ndodh me gratë, sipas tyre.

- *Kanalet e përcimit të interesave të të rinjve dhe pavarësia e veprimit të FRPP-ve*

Kryesisht forumet rinore të partive politike në Shqipëri kanë pak a shumë të njëjtën strukturë vendim-marrëse. Çdo grupim rinor (numri për çdo grupim/rreth varion në varësi të forcës politike të partive) është i organizuar në hallka hierarkike dhe përfaqësohet në majë të kësaj hierarkie nga një kryetar, pjesë e kryesisë së rinisë së forumit rinor përkatës. Është kryesia e rinisë ajo që trajton një sërë problemesh që sillen nga kryetarët e grupeve dhe më pas është kryetari i FRPP-së që përçon problematikën në nivel partie duke ia kaluar asaj vendim-marrjen.

Tek partitë e mëdha respektohet me më shumë rigorozitet hierarkia e brendshme pasi këto parti e kanë të detyrueshëm zbatimin e hierarkisë edhe për shkak të numrit të madh të anëtarëve. Nga diskutimet doli se *sa më e vogël është një parti aq më fleksibël janë hallkat hierarkike brenda partisë dhe aq më i lehtë është komunikimi i drejtpërdrejtë i anëtarëve të forumit me drejtuesit më të lartë*.

Sidoqoftë, të rinjtë aktivë të anëtarësuar në FRPP shprehen se nuk është kusht që të ngrihen e trajtohen problematika që sillen vetëm nga anëtarësia, pasi problematikat mund të ngrihen dhe nga të rinj të tjerë që jo domosdoshmërisht janë anëtarë të atij forumi rinor. Nëse adresimi i asaj problematike ngjall interes tek anëtarët e FR-së, mund të bëhen organizime nga të rinjtë e grupit për të mbështetur kauzën në fjalë.

Gjithashtu të rinjtë shprehen se anëtarët e forumit bashkëpunojnë, ulen bashkë dhe diskutojnë për nisma/projekte të ndryshme që mund të ndërmerren edhe pa aprovim nga strukturat e larta të forumit rinor. Pavarësisht kësaj, ata pranojnë se kur nismat duhen konkretizuar me aktivitete, mund të bëhet pengesë mungesa e aprovimit nga kryetarët megjithëse kryesisht mbështetja e kryetarëve nuk mungon.

- *Adresimi i çështjeve rinore në strukturat vendim-marrëse të forumeve rinore dhe partive*

Brenda forumeve rinore ngrihen shumë çështje nga anëtarët e forumit dhe disa prej këtyre çështjeve të cilat vlerësohen si më prioritare përcillen nga kryetarët e grupeve në mbledhjet e kryesisë së forumit. Çështjet që ngjallin më shumë interes dhe nuk bien në kundërshtim me politikën e partisë, përcillen nga kryetarët/et e forumeve në kryesinë e partisë për të vijuar me adresimin e çështjes në nivelet më të larta. Në FR-të e partive të vogla, hallkat e procesit vendim-marrës në strukturat e FR-ve janë më të pakta në numër dhe marrëdhëniet

me liderët e partive janë më direkte. Të pyetur nëse ka pasur raste suksesi kur problematika të ngritura nga të rinjtë janë adresuar në instancat më të larta politikëbërëse e vendim-marrëse, të rinjtë e konsultuar të FRPP-ve shprehen se ka pasur raste suksesi, por disa prej çështjeve që kalojnë përtej pjesës politike nuk janë çuar deri në fund me sukses.

Çështjet e të rinjve jo gjithmonë marrin vëmendjen që meritojnë nga strukturat vendim-marrëse e politikëbërëse, si kryesitë e partive, parlament, qeveri, dhe këshilla bashkiakë. Unanimisht, të rinjtë e FR-ve të konsultuar në fokus grupe, janë të mendimit që në *nivel qëndror por edhe në atë vendor ngrihen dhe rrjedhimisht adresohen shumë pak çështje të të rinjve*. Drejtuesit e FR-ve janë të mendimit se shumë pak nga ato që janë kërkuar janë bërë realisht, pasi promovimi i të rinjve, apo çështjet rinore nuk janë prioritet për ata që janë përzgjedhur.

Ajo që u duket shqetësuese është fakti që nuk flitet fare për rininë edhe nga vetë të rinjtë dhe rrjedhimisht u kushtohet fare pak vëmendje çështjeve rinore dhe në nivel politikëbërës e vendim-marrës. Vëmendja (kryesisht e mediave) tërhiqet vetëm në rastet kur ndodh diçka e jashtëzakonshme. Sipas të rinjve, fakti që të rinjtë nuk janë të përfaqësuar mjaftueshëm në numër në të gjitha strukturat politikëbërëse e vendim-marrëse si në nivel vendor edhe në atë qëndror, ndikon në nivelin e vëmendjes që marrin çështjet rinore në këto struktura. Sidoqoftë, sipas perceptimeve të të rinjve, përfaqësimi cilësor mund të bëjë diferencën, pasi në vendime të caktuara në lidhje me rininë ekzistojnë shembuj pozitivë kur kryetari/ja e FR-së ka lobuar lidhur me një çështje të caktuar dhe ia ka dalë të marrë vëmendjen e dëshiruar, si dhe zgjidhjen e kërkuar.

- *Qasja e partive ndaj forumeve rinore*

Forumet Rinore janë të ndërgjegjshëm për rolin e tyre të domosdoshëm për partitë përkatëse, sidomos gjatë fushatave zgjedhore. Ka parti (LSI) për të cilat FR fiton akoma më shumë rëndësi, për shkak të moshës limit të anëtarëve të FR-së (16 vjeç) të cilët votojnë njësoj si të tjerët për kryesinë, gjë që sipas të rinjve, e bën këtë FR më të fortë në parti. Përveç intensitetit të fushatave zgjedhore, anëtarët e forumeve rinore shprehen se partia ka gjithmonë nevojë për të rinjtë.

Sipas perceptimeve të drejtuesve të FRPP-ve, disa podiume partish janë të hapura për rininë, pasi partitë ofrojnë lirinë e nevojshme për të ngritur çështje të të rinjve. Sidoqoftë, në terma të përgjithshëm mbetet sfida fakti që *filozofia e 'të vjetërve' lidhur me pjesëmarrjen e të rinjve në vendim-marrje e politikëbërje nuk ka ndryshuar me ritmet e duhura*.

- *Intensiteti dhe natyra e aktivitetit të FRPP-ve në varësi të pozicionimit të partive*

Sipas të rinjve të FRPP-ve, megjithëse partia ka gjithmonë nevojë për ta, natyra e angazhimit ndryshon në varësi të faktit nëse partia është në pozitë apo opozitë. Kur partia është në opozitë fokusi kryesor janë protestat, ndërsa kur partia është në pushtet fokusi zhvendoset

tek zgjidhja e problemeve. Ndërkohë, përsa i përket intensitetit të aktivitetit të FRPP-ve, perceptimet janë të ndyshme. Një pjesë e të rinjve është e mendimit që ka më shumë intensitet aktivitetesh kur je në opozitë, pasi nuk kushtëzohesh nga aktiviteti politik dhe rrjedhimisht dhe mënyra e zgjedhjes është më e larmishme, protestat janë më të justifikuara. Të tjerë të rinj janë të mendimit që kur je në pushtet ka më shumë aktivitet pasi ke dhe detyrimin moral për të krijuar një mënyrë zgjidhje.

Fakti që *protesta shikohet si një aktivitet kyç kur një parti është në opozitë*, perceptohet nga të rinjtë si një mendësi problematike mes të rinjve dhe klasës politike. Shembujt e dhënë lënë të kuptosh që çështje që janë adresuar me protestë kur partia ka qenë në opozitë, nuk adresohen më në formë proteste pasi partia protestuese vjen në pushtet edhe nëse çështjet vazhdojnë të mbeten të pazgjidhura. Mesa duket protesta konsiderohet si një formë jo e përshtatshme për FR-në kur partia është në pushtet, megjithëse çështja s'ka gjetur zgjidhje me mënyra të tjera. Sidoqoftë, sipas dëshmive të të rinjve të një prej forumeve rinore, në rastin e një proteste të bërë kundër një vendimi të qeverisë kanë marrë pjesë edhe anëtarë të FR-së të partisë në pushtet dhe kjo nuk ka përbërë problem.

- *Financimi i FRPP-ve*

Mënyra e financimit të Forumeve Rinore të PP-ve shihet si problematike që ka nevojë për përmirësime e ndryshime. Të rinjtë e konsultuar mendojnë që duhet të gjendet një mënyrë për financimin e rregullt të Forumeve Rinore, si për shembull ndarja e një fondi nga vetë KQZ-ja për këtë qëllim, njëlloj siç operohet me partitë. Idealisht, sipas tyre do të ishte mirë që të ishte e përcaktuar shuma për fushatën, në mënyrë që të jepet një fond i veçantë për të rinjtë.

- *Bashkëpunimi mes FRPP-ve*

Deri më sot, bashkëpunimi mes FRPP-ve është inekzistent dhe shihet prej tyre si një problematike shumë e rëndësishme që duhet adresuar. Liderët e FRPP-ve janë të mendimit se është shumë e domosdoshme që të gjendet një mënyrë/formë për të bërë bashkë zërin rinor të të gjithë forumeve rinore partiake, për të unifikuar forcat me qëllim ngritjen e çështjeve lidhur me rininë. Ky 'organizëm' do të shërbente edhe si një mjet presioni për të vendosur çështjet rinore në axhendën politikëbërëse dhe për të institucionalizuar kauzën rinore. Sipas tyre, për të evituar keqinterpretimet dhe stepjet e çdo lloji, kjo nismë idealisht duhet nisur nga shoqëria civile dhe mund të formalizohet më pas përmes një marrëveshjeje bashkëpunimi mes forumeve rinore të partive politike.

Megjithatë, faktet tregojnë që ka organizata të rëndësishme rinore të shoqërisë civile që kanë tentuar të ndërmarrin një nismë të tillë por FRPP-të nuk i janë përgjigjur pozitivisht kësaj thirrjeje. Ka pasur tentativë të mëparshme edhe në nivel më të gjerë (rajonal) dhe janë bërë bashkë forumet rinore në të gjitha trevat ku ka shqiptarë, por i gjithë progresi ndaloi në Tiranë ku ideja nuk u mbështet nga të gjitha FRPP-të.

Ndërkohë të rinjtë e FRPP-ve shprehen optimistë pasi sipas tyre ekzistojnë shembuj të suksesshëm bashkëpunimi të mëparshëm mes FRPP-ve (kryesisht të një kahu politik), megjithëse nuk e fshehin skepticizmin lidhur me bashkëpunimin me ndonjë nga FRPP-të (*kryesisht të kahut të kundërt*) që nuk ka treguar frymë bashkëpunimi deri tani. Ka pasur raste kur janë mbledhur gjithë forumet rinore për çështje shumë të rëndësishme si karta e studentit, krijimi i qendrës rinore multi-funksionale, apo reforma e re arsimore, megjithëse pa rezultate konkrete pozitive deri tani. Sipas tyre, këto përpjekje janë tregues që qasja e të rinjve ndaj politikës po ndryshon, pavarësisht se bashkëpunimi i deritanishëm nuk ka sjellë akoma ndonjë rezultat pozitiv konkret lidhur me çështjet e ngritura.

Sipas liderëve të FRPP-ve, bashkimi i mirëorganizuar i forumeve është një ide shumë e bukur pasi është një rast i mirë për të dalë të bashkuar për çështje që prekin rininë, gjë që mund të sjellë arritje konkrete. Vëmendja që mund të marrë nga mediat një bashkim i tillë mund ta shtojë dozën e impaktit të kësaj tentative. Bashkimi i të gjithë FRPP-ve njëzëri, sipas tyre do të shërbente si model pozitiv bashkimi mes të rinjve, pa gjuhë urrejtje, pasi mes të rinjve ka filluar të kuptohet që gjuha e konfliktit nuk pëlqehet dhe thirrja për bashkëpunim dhe për etikë në diskursin politik nga të rinjtë është një ide shumë e mirë.

- *FRPP-të dhe marrëdhënia me median*

Faktet tregojnë që koha mediatike u jepet kryesisht deputetëve në parlament dhe që partitë nuk kanë një mekanizëm të mirëfilltë që të ndajë hapësirën mediatike për të rinjtë, për gratë etj. Disa nga liderët e FRPP-ve shprehen se brenda forumeve kanë sjellë në vëmendje që disa tema duhet t'i ngrenë dhe t'i përçojnë në media vetë të rinjtë. Pavarësisht se ata konfirmojnë që FRPP-të me grupet e veta të komunikimit mund të ngrenë çështje në media nëse ka ndonjë nismë konkrete, si për shembull me deklarata për shtyp, ata përmendin që çështjet në fjalë më parë kalohen për aprovim në parti në mënyrë që FR-ja të sigurohet që është në një linjë me politikën e partisë. Sidoqoftë, në disa FRPP nuk ka ndonjë diktat lidhur me këtë dinamikë, pasi ka edhe përjashtime kur një çështje e re mund të ngrihet edhe nga ata vetë në media, pa u konsultuar paraprakisht me partinë dhe pa sjellë pasoja negative për FRPP-në.

Në mendimin e të rinjve të FRPP-ve të konsultuara është në interes të partisë që FRPP-të të jenë aktive dhe në media, me deklarata dhe ngritje problematikash, pasi ka pasur raste kur vetë partitë kanë ushtruar presion tek FR-të për të dalë në media dhe për të trajtuar çështje të caktuara.

- *Arsyet e përfshirjes në politikë përmes FRPP-ve*

Arsyet pse të rinjtë përfshihen në forume rinore të partive politike janë nga më të larmishmet. Më poshtë po listojmë disa nga shtysat kryesore të raportuara nga të rinjtë anëtarë të forumeve rinore të partive politike në vend:

- Dëshira për të ndryshuar gjërat në vend lidhur me përfshirjen e të rinjve në politikë;
- Ndikimi nga shokët/ miqtë pjesë të FRPP-ve;

- Pasioni për politikën dhe dëshira për të ecur më lart në politikë;
- Ndikimi nga familja si pikënisje për t'u përfshirë në një parti të caktuar;
- Mundësia për t'u aftësuar në aspektin organizativ dhe drejtues. Forumet shihen si një vend ku të rinjtë mund të kontribuojnë dhe të përfitojnë;
- Dëshira për të kontribuar në zbatimin e një programi partiak që u pëlqen, në udhëheqjen e një lideri tek i/e cili/a besojnë;
- Të qenit pjesë e një grupimi social të caktuar, mbrojtja e të drejtave të të cilit është në fokus të programit të partisë së përzgjedhur.

▪ *Format e angazhimit të të rinjve brenda FRPP-ve*

Angazhimi brenda forumeve rinore kryesisht mbetet në nivel *aktivitetesh*, në nivel qëndror dhe vendor. Aktivitetet kryesisht janë me natyrë fuqizuese për të rinjtë e tjerë (trajnime, sesione informimi) lidhur me organizimin dhe funksionimin e strukturave vendim-marrëse dhe politikëbërëse në nivel qëndror dhe vendor, aktivitete që kanë qëllim rekrutimin e të rinjve në FR-të e partive, vullnetarizëm, apo edhe festa të ndryshme rinore me natyrë politike ose jo. Nuk përjashtohen rastet kur të rinjtë janë përfshirë në adresimin e një problematike të caktuar qoftë duke u bërë pjesë e protestave politike apo jopolitike.

*Ndërgjegjësimi i të rinjve rreth proceseve vendim-marrëse* është një çështje me shumë rëndësi në këndvështrimin e FRPP-ve të partive parlamentare që u konsultuan për këtë studim. Të gjitha FRPP-të pjesëmarrëse konfirmojnë që kanë treguar gjithmonë kujdes të veçantë për të ndërgjegjësuar të rinjtë rreth proceseve vendim-marrëse e politikëbërëse në nivel qëndror dhe vendor. Ata kanë zhvilluar praktika të ndryshme ndër vite, si trajnime me të rinjtë pa (ose pavarësisht) bindje politike në çdo qytet, për sistemin politik qëndror dhe vendor, aktivitete informuese me simulime të një vendimi në një këshill bashkiak në mënyrë që të rinjtë të shohin e të kuptojnë se si funksionon ky organizëm. Ata shprehen se në këtë mënyrë politika bëhet më transparente dhe e kuptueshme për të rinjtë, të cilët ndërgjegjësohen siç duhet rreth dinamikave të proceseve vendim-marrëse dhe rëndësisë që ka dëgjimi i zërit të tyre.

▪ *FRPP-të: pjesë integrale e partive, ishuj apo gadishuj?*

Perceptimi i përgjithshëm i të rinjve të të gjithë forumeve rinore është që FR-të dhe partitë përkatëse janë si organizata bashkëpunuese që konsultohen vazhdimisht për çështje të caktuara dhe janë në mbështetje të njëra tjetrës. Ata e shohin strukturën e tyre rinore si gadishull të partisë mëmë, pjesë e të cilës synojnë të bëhen shumica e anëtarëve të forumit rinor, duke e parë FR-në si një trampolinë shumë e mirë për në parti.

## **b) Pikëpamjet e të rinjve të shoqërisë civile në lidhje me përfshirjen e të rinjve në politikë e vendim-marrje**

### ▪ *Arsyet e angazhimit të të rinjve në shoqëri civile*

Ka shumë organizata rinore që veprojnë në vend. Përqëndrimi i këtyre organizatave është më i madh në kryeqytet, por ka një sërë organizatash rinore që punojnë edhe në rrethe, kryesisht të mëdha. Siç mund të pritet, në Tiranë të rinjtë aktivë në shoqëri civile janë më të shumtë sesa në rrethe, sidomos në qytete të vogla. Kryesisht, sipas opinionëve të mbledhura nga të rinjtë e shoqërisë civile, të rinjtë fillojnë të angazhohen në organizata të shoqërisë civile ekzistuese apo të marrin nisma për të krijuar një organizatë që ka në fokus të rinjtë gjatë viteve të studimeve universitare ose menjëherë pas këtyre studimeve, fazë kjo ku ndërgjegjësimi rreth çështjeve që shqetësojnë të rinjtë është më i lartë dhe interesi për t'u përgatitur për jetën pas-shkollore është maksimal.

*Po përse të rinjtë zgjedhin të bëhen pjesë e këtyre nismave civile? Ja disa nga arsyet që na u dhanë gjatë konsultimeve në fokus grupe me të rinjtë e organizatave rinore të shoqërisë civile:*

- Për të mbushur kohën e lirë;
- Për t'u aktivizuar/përfshirë në veprimtari sociale,
- Për të mundur apatinë sociale, ku zgjidhja pritet vetëm nga jashtë;
- Për të sjellë ndryshim lidhur me çështje rinore nga këndvështrimi i të rinjve;
- Për të testuar aftësitë individuale;
- Për t'u bërë bashkë, pasi kështu ndryshimi është më i lehtë;
- Për të fituar eksperiencë në adresimin e çështjeve rinore lidhur me një çështje të caktuar;
- Për të adresuar çështjet rinore, për t'u ardhur në ndihmë të rinjve;
- Për të punuar në një fushë që u pëlqen, p.sh. me fëmijët, etj;
- Për t'u distancuar nga ndasitë politike që karakterizojnë angazhimin/punësimin në institucione shtetërore;
- Për të adresuar mangësitë e mëdha në zyrat e karrierës të fakulteteve;
- Të shtyrë nga angazhimi në parlamentet rinore gjatë viteve të shkollës së mesme;
- Për t'u rritur profesionalisht;
- Për të krijuar kontakte, të njohur të rinj të tjerë aktivistë;
- Për të bërë diçka që mund të sjellë ndryshim;
- Për të mbrojtur një kauzë tek e cila besojnë.

### ▪ *Mundësitë e të rinjve të shoqërisë civile për të sjellë ndryshim*

Organizatave rinore që janë aktive dhe punojnë fort, dinë si të mbledhin fonde dhe si të organizohen për të avokuar dhe lobuar për interesat që prekin të rinjtë, shpeshherë arrijnë rezultatet e dëshiruara me ndërhyrjet e tyre, sidomos nëse funksionojnë në rrjet. Përpjekjet e tyre kanë çuar në arritjen e disa objektivave të rëndësishme për të rinjtë, si për shembull

përfshirja e përfaqësuesve të rinj në këshillin bashkiak të Tiranës, rritja e buxhetit të shtetit për punësimin e të rinjve<sup>31</sup>, rritja e buxhetit për rininë në nivel vendor<sup>32</sup>, rritja e buxhetit për formimin profesional<sup>33</sup>, hapja e Qendrës Rinore në kryeqytet, futja e kërkesës për Kartën e Studentit në axhendën e këshillit bashkiak Tiranë, etj. Në anën tjetër të medaljes, përvoja e të rinjve ka treguar që jo gjithmonë presioni i grupit ia arrin qëllimit. Ka pasur raste, kur pavarësisht përfshirjes shumë të gjerë të të rinjve me një peticion prej 11.000 firmash, kërkesa e të rinjve nuk u realizua. Ngjarje si këto, sipas tyre shpesh janë dhe si pasojë e mungesës së vazhdimësisë së ndjekjes së çështjeve nga të rinjtë dhe jo domosdoshmërisht janë rezultat i mosdëgjimit të të rinjve nga vendim-marrësit.

Gjithashtu, të rinjtë e shoqërisë civile shprehen se proceset konsultuese nga pushteti qëndror apo ai vendor shpesh çalojnë, si në rastin e Reformës së re Arsimore, vendosja e zërave të buxhetit për rininë, etj, siç shprehen të rinjtë e përfshirë në studim. Mes të rinjve aktivistë ekziston besimi se kur çështja ka lidhje me rininë, të rinjtë janë të parët që duhen konsultuar pasi e dinë më mirë se kushdo se ç'është më e mirë për ta dhe janë të interesuarit parësorë.

\* Sipas të rinjve të konsultuar, këshillat studentore duhet të jenë zëri i të rinjve lidhur me tematika që lidhen me arsimimin, por duket se ato nuk funksionojnë në interes të të rinjve pasi përvoja ka treguar që ato janë shpesh të instrumentalizuar.

- *Angazhimi në shoqëri civile si një urë drejt vendim-marrjes dhe politikës*

A është përfshirja në shoqëri civile një trampolinë për në politikë? A është ky rrugëtim një formulë suksesi? Konsultimet me të rinjtë e shoqërisë civile na ofruan dy perceptime të ndryshme. Për një pjesë të të rinjve, ky kalim nga një sektor i papolitizuar siç është shoqëria civile në politikë është disi problematik, pasi zbehet figura e individit, kur ai/ajo anësohet politikisht dhe për pasojë bie pre e paragjykimeve nga vetë komuniteti që deri në ato momente e vlerësonte pozitivisht atë.

Arsyet *pse ky kalim paragjykohe* janë të shumta sipas tyre, si: eksperiencia të mëparshme që kanë treguar që kur përfaqësues të shoqërisë civile kalojnë në politikë nuk punojnë më me të njëjtin intensitet dhe pasion për kauzat e masës; besimi shumë i vakët tek politikanët në vend; nënvlerësimi i sektorit të shoqërisë civile nga komuniteti, etj. Kështu, të rinjtë shprehen se ndoshta është më mirë që për të mos rënë pre e mosbesimit dhe

---

<sup>31</sup> Inisiativë e Rrjetit Rinor "Leadershipi i të Rinjve të Tiranës" – në nivel qëndror është rritur Fondi për nxitjen e Punësimit të të Rinjve (MMSR) nga 800 mijë USD në vitin 2013, në 1.7 milion USD në 2014 dhe në 4.5 milion dollarë në vitin 2015

<sup>32</sup> Inisiativë e Rrjetit Rinor "Leadershipi i të Rinjve të Tiranës" - në nivel lokal (Bashkia e Tiranës), si rezultat i avokimit të vazhdueshëm buxheti për rininë për Bashkinë e Tiranës, nga 2% është rritur në 5%

<sup>33</sup> Inisiativë e Rrjetit Rinor "Leadershipi i të Rinjve të Tiranës" – pas një pune të gjatë lobuese me MMSR, për vitin 2015 u arrit që të rritej buxheti për 2 Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional nr.1 dhe nr.4. Gjithashtu, këto dy Drejtori nisën të ofrojnë kurse shtesë falas (përveç atyre të gjuhës së huaj dhe kompjuterit) për të gjithë të rinjtë në nevojë



paragjytimeve ndaj të dyja palëve, secila palë të mbetet në fushën e vet të lojës, pavarësisht përfitimeve që do të kishte politika nëse pasurohet me anëtarë të devotshëm të shoqërisë civile.

Siç përmendëm, të rinjtë janë të mendimit se kalimi nga shoqëria civile nuk shihet me entuziazëm prej tyre. Gjithashtu, ata besojnë se përfshirja në organizata të shoqërisë civile nuk vlerësohet sa duhet nga ata që janë jashtë saj, rrjedhimisht, nuk përbën ndonjë shtysë të veçantë për t'u përfshirë më pas në politikëbërje e vendim-marrje. Sidoqoftë, nëse ky do të ishte një qëllim në vetvete, të rinjtë nuk e mohojnë që nëse shoqëria civile funksionon si rrjet mund të arrihet ky qëllim, sidomos nëse individ i interesuar përfaqëson një grup të madh individësh, është dikush që ka treguar që di të punojë mirë dhe që arrin të sigurojë mbështetjen që dëshiron. Fakti që sot një pjesë e politikanëve janë nga shoqëria civile mund të interpretohet si një mesazh inkurajues dhe shpresëdhënës për të rinjtë aktivë të shoqërisë civile që dëshirojnë të angazhohen në vendim-marrje e politikëbërje në të ardhmen, pa qenë domosdoshmërisht pjesë e një force politike.

Të rinjtë aktivistë të organizatave rinore nuk e fshehin vlerësimin e tyre për pavarësinë dhe bashkëpunimin që karakterizon shoqërinë civile. Sipas tyre, gjërat funksionojnë ndryshe në forumet rinore të partive politike që dashje pa dashje mbeten pre e kornizave të interesave të partisë dhe ku shpesh të rinjtë përdoren nga partitë për të arritur objektivat e tyre elektorale. Pavarësisht dashurisë dhe vlerësimit që të rinjtë e shoqërisë civile kanë për sektorin në të cilin bëjnë pjesë, ata shprehen se do të dëshironin që të afrohen sa më shumë të rinj me politikën, që dyert e FRPP-ve të jenë më të hapura për të rinjtë dhe ata të jenë pjesë funksionale e partive. Ashtu si të rinjtë e FRPP-ve, edhe ata janë të mendimit se *vendosja e një quote për të rinjtë* në nivel vendor dhe qëndror do të ndihmonte që të rinjtë të përfaqësoheshin siç duhet në nivel vendim-marrës e politikëbërës.

- *Pengesat e perceptuara të të rinjve për t'u përfshirë në procese/struktura vendim-marrëse e politikëbërëse*

Të rinjtë janë një nga grupet sociale që megjithëse mbartin peshën e ndërtimit të së ardhmes së vendit, nuk e kanë të lehtë të përfshihen, të kërkojnë të drejtat e tyre apo të bëhen pjesë e vendim-marrjes/ politikëbërjes.

Perceptimet rreth pengesave konkrete të të rinjve për t'u përzgjedhur, lidhen shpesh drejtpërdrejt me faktin që *të rinjtë duke qenë se janë në formim e sipër, nuk mund të marrin përsipër pozicione të rëndësishme në vendim-marrje e politikëbërje*. Por në këndvështrimin e të rinjve aktivistë, kjo gjë nuk ka përse të përbëjë në çdo rast një pengesë rrënjësore, pasi pjekuria e të rinjve për t'u angazhuar realisht në vendim-marrje duhet të vlerësohet në varësi të pozicionit/postit që ofrohet. Disa pozicione mund të mbahen shumë mirë nga të rinj të mirëpërgatitur, të aftë, të gatshëm dhe të pjekur mjaftueshëm për të marrë përsipër detyra sfiduese. Në këndvështrimin e tyre, ritmi me të cilin një i ri/e re dëshiron të angazhohet në vendim-marrje nuk duhet të diktohet vetëm nga vendim-marrësit, por edhe

nga dëshira, gadishmëria dhe aftësia e vetë të riut/të resë për t'u angazhuar. Ndërkohë që disa të rinj dëshirojnë të rriten profesionalisht me hapa më të ngadaltë, të tjerë mund të jenë të gatshëm dhe të përgatitur për t'u lançuar më herët në pozicione të rëndësishme.

Në mënyrë të përmbledhur, sipas vetë të rinjve ata e gjejnë veten përballë pengesave nga më të ndryshmet, si:

- *Paragjykimet lidhur me moshën e re dhe mungesën e eksperiencës* bëjnë që fjala e të rinjve të mos dëgjohet apo respektohet sa ç' duhet, si rrjedhojë të mos konsiderohen për pozicione vendim-marrëse;
- *Mungesa e informacionit*, e cila shihet si një nga problematikat më të rëndësishme për mospërfshirjen e të rinjve në struktura vendim-marrëse, sidomos në zona rurale dhe informale ku përfshirja për të rinjtë përkthehet ose kuptohet vetëm si votë, tregues që nuk e kanë aspak të qartë konceptin e përfshirjes;
- *Shpërndarja e informacionit* që nuk është e rrjetëzuar siç duhet, pasi që në universitet duhet të fillojë informimi i mirëfilltë i të rinjve dhe angazhimi i tyre konkret për përfshirje në vendim-marrje (këshilla, borde këshillimore, etj);
- *Mungesë e theksuar dëshire dhe reagimi* mes të rinjve për t'u përfshirë në procese vendim-marrëse e politikëbërëse, derivat i pasivitetit konformist dhe apatisë të të rinjve lidhur me çështjet që i prekin drejtpërdrejt, duke zgjedhur të mos dalin nga zona e komfortit personal;
- *Mungesë dëshire dhe vullneti nga më të mëdhenjtë* për t'i përkrahur dhe inkurajuar të rinjtë që dëshirojnë të përfshihen në vendim-marrje e politikëbërje;
- *Të mos qenit i/e përfshirë në një forcë politike*;
- *Mungesa e forcimit të kapaciteteve të të rinjve të shoqërisë civile*, për të ndihmuar siç duhet të rinjtë që të përfshihen në vendim-marrje e politikëbërje;
- *Praktika/përpjekje të mëparshme demotivuese* lidhur me inisiativa rinore të dështuara apo raste të përfshirjes të të rinjve në vendim-marrje, që bëhen shkas për frenimin e përpjekjeve për t'u angazhuar në pozita vendim-marrëse;
- *Mungesa e organizimit të grupeve rinore dhe bashkëpunimit mes forumeve rinore të partive politike* për të mbështetur të rinj/të reja që synojnë të angazhohen në vendim-marrje;
- *Mungesa e shpresës mes të rinjve* për të sjellë ndryshime të qenësishme;
- *Individualizimi i fitores* nga individët që ia dalin të bëhen pjesë e vendim-marrjes, duke zbehur rolin e rëndësishëm të grupit mbështetës.

Pra, të përfshihesh në procese apo struktura vendim-marrëse nuk është një rrugëtim aq i lehtë sipas të rinjve të konsultuar. Problematika si këto të përmendura më lart, jo vetëm që bëhen pengesë për përfshirjen e sa më shumë të rinjve në vendim-marrje dhe politikëbërje, por çenojnë rëndë demokracinë e vendit.

- *Problematika madhore të perceptuara nga të rinjtë e konsultuar*

Të rinjtë e të rejtat në Shqipëri rriten dhe jetojnë në një kontekst social, politik dhe ekonomik të gjymtuar dhe me shumë problematika. Problematikat social-ekonomike më kryesore që ndikojnë si pasojë edhe në përfshirjen e të rinjve në vendim-marrje sipas tyre janë:

- *Mungesa e mundësive për punësim:* mungesa e alternativave të denja të punësimit në përputhje me kualifikimet e të rinjve është një faktor që perceptohet si mbytës për çdo aspiratë për përfshirje në politikë dhe kthehet në burim të vazhdueshëm stresi për të rinjtë. *‘Në lashtësi të kafshonte një kafshë dhe ti vdisje, sot të kafshon stresi i papunësisë dhe ti vdes megjithëse merr frymë’*, shprehet një nga të rinjtë e konsultuar. Sidoqoftë, në mënyrë kontradiktore, mungesa e punësimit bëhet shpesh një arsye për t’u angazhuar në forume rinore të partive politike, të shtyrë nga shpresa për të përfituar një vend pune nëse partia është apo aspron të kalojë në pozitë. Kjo qasje është tregues i perceptimit të politikës nga të rinjtë si një organizëm problematik, i bazuar në militantizëm dhe jo në meritokraci.
- *Mospërputhja e alternativave për arsimim me tregun e punës:* mungesa e studimeve lidhur me tregun e punës, mbingopja e tregut të punës për disa profesione, si dhe mospërputhja e kërkesave të tregut të punës me kualifikimet që ofron sistemi arsimor zvogëlojnë gjithnjë e më shumë shanset për punësim të të rinjve e të rejave.
- *Cilësia e edukimit që merret në familje dhe në shkolla:* sfidat e shumta në nivel social, politik dhe ekonomik, nuk ndihmohen aspak nga qasja edukuese dhe cilësia e edukimit që shumë të rinj marrin në familjet e tyre dhe në shkolla. Vullnetarizmi vazhdon të shihet si tabu.

## 7. Praktika të mira të organizatave rinore lidhur me pjesëmarrjen e të rinjve në politikëbërje e vendim-marrje

Angazhimi në organizata rinore të shoqërisë civile është një mënyrë alternative angazhimi që mund të çojë drejt realizimit të objektivave konkrete lidhur me çështjet rinore në nivel vendor e qendror, duke u bërë kështu faktorë në politikëbërje në të dy nivelet. Suksesi jo gjithmonë është i garantuar dhe duhet mbështetje e vazhdueshme edhe nga donatorët nëse ndërhyrjet e synuara janë komplekse dhe afatgjata. Me qëllim reflektimin e sa më shumë praktikave të mira të organizatave rinore të shoqërisë civile, lidhur me rezultate konkrete të arritura përmes projekteve/ nismave të tyre, u ftuan të gjitha organizatat rinore në vend që të ndanin me ne eksperiencat e tyre pozitive. Më poshtë, do të gjeni një përzgjedhje të disa prej praktikave më domethënëse dhe përfaqësuese të ndërhyrjeve që kanë rezultuar të suksesshme duke ndikuar politikëbërjen dhe vendim-marrjen në nivel vendor e qendror. Përshkrimet më të detajuara të këtyre praktikave i gjeni në seksionin e shtojcave (*shtojca 5*) të këtij publikimi.

### 7.1 Bordi Rinor Këshillimor, risia në Bashkinë e Tiranës

**Emri i organizatës:** CRCA Shqipëri në bashkëpunim me Leadershipin e të Rinjve të Tiranës

**Emri i nismës:** Bordi Rinor Këshillimor, 2014 – 2015 dhe në vijim

**Qëllimi i nismës dhe impakti i dëshiruar:** Ngritja dhe funksionimi i Bordit Rinor Këshillimor pranë Këshillit Bashkiak në Bashkinë e Tiranës, nga të rinjtë për të rinjtë. Ky grup informues dhe këshillues pranë Këshillit Bashkiak që përfshin përfaqësues të organizatave rinore, forumeve politike rinore, si dhe këshillave studentorë do të jetë një faktor kryesor në hartimin, ideimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave lokale të cilat pasqyrojnë nevojat e vërteta të të rinjve.

**Qasja e organizatës** - tre dimensionale: të rinjtë si grup i synuar; të rinjtë si bashkëpunëtorë; të rinjtë si nismëtarë

**Fusha në të cilën u arrit impakti:** Të rinjtë në vendim-marrje; Ngritje kapacitetesh; Informim; Integrim gjinor/Barazi Gjinore/Buxhetim Gjinor; Buxhetim Rinor; Integrim i të Rinjve të disavantazuar/me probleme sociale; Integrim i të Rinjve më aftësi ndryshe; Krijimtari artistike; Kohë e lirë; Hapësira për të rinjtë; Mbrojtje e mjedisit; Qendra Rinore; Shëndetësia për të rinjtë;

Më specifikojsht Bordi Rinor Këshillimor ka si objektiv:

- a) Nxitjen e pjesëmarrjes së grupeve rinore nga komunitete të ndryshme, përfaqësuar nga Bordi Rinor Këshillimor pranë Bashkisë, për t'i dhënë zë dhe prioritet çështjeve të të rinjve në nivel lokal;

- b) Adresimin e interesave të të rinjve në qeverisjen lokale;
- c) Fuqizimi i të rinjve për të mbajtur të zgjedhurit publikë të përgjegjshëm në ushtrimin e funksioneve të tyre për çështjet e të rinjve;
- d) Përfshirjen e të rinjve në nivel komunitar drejtpërdrejt në ideimin dhe realizimin e veprimeve e nismave të përbashkëta dhe në hartimin e politikave në interes të tyre;
- e) Të rinjtë faktor kryesor në hartimin, ideimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave lokale të cilat pasqyrojnë nevojat e vërteta të të rinjve;
- f) Fuqizimin e të rinjve për të qenë në të ardhmen këshilltarë dhe drejtues lokalë.

**Hapat kryesorë që u ndërmorën:**

- a) Zhvillimi i një takimi konsultues me Kryetarin e Këshillit Bashkiak Tiranë, z. Aldrin Dalipi;
- b) Zhvillimi i një takimi të përbashkët konsultues midis organizatave rinore dhe forumeve politike Rinore për ngritjen e Bordit Rinor Këshillimor;
- c) Zhvillimi i një takimi të përbashkët konsultues mes CRCA Shqipëri, organizatave/forumeve pjesë përbërëse të Lidërshiptit dhe kryetarit të Këshillit Bashkiak Tiranë mbi rëndësinë e ngritjes së Bordit Rinor Këshillimor;
- d) Zhvillimi i një Forumi të Hapur në Sallën e Këshillit Bashkiak ku u ngrit Bordi Rinor Këshillimor dhe u firmos Akti i Themelimit të tij midis Kryetarit të Këshillit dhe drejtuesve/kryetarëve të organizatave/forumeve politike rinore pjesë përbërëse të Lidërshiptit të të Rinjve të Tiranës;
- c) Vijimi i Punës së Bordit Rinor Këshillimor si më poshtë:
  - Lobim dhe avokatësi për futjen në proces rishikimi të Kartës Bashkiake të Studentit;
  - Lobim dhe avokatësi me Këshillin Bashkiak, aktorë të ndryshëm në Bashkinë Tiranë, Komisionin e Ekonomisë (KB) për rritjen e Buxhetit të Rinisë në buxhetin afatmesëm 2015-2017;
  - Lobim dhe avokatësi për rikthimin në funksionalitet të Qendrës Multifunksionale TEN.

**Rezultatet e arritura:**

1. Futja në proces rishikimi i Kartës Bashkiake të Studentit si pasojë e mosfunksionalitetit dhe paaksesueshmërisë së shërbimeve të listuara për ofrim për studentët e Universitetit të Tiranës;
2. Rritja e Buxhetit për Rininë nga 2% në 5% në Buxhetin Afatmesëm të Bashkisë Tiranë.

## 7.2 Iniciativa fuqizuese për të rinjtë nga të rinjtë e Rrjetit Rinor

**Organizata zbatuese:** Rrjeti Rinor “Lidershipi i të Rinjve të Tiranës”

**Emri i nismës/ave:**

1. Manifesti Rinor “Rinia Zgjidhja, Jo Problemi”;
2. Plani i Veprimit “Të Rinjtë-Ofruesit e Shërbimeve”;
3. Kontrata Sociale për të Rinjtë 2015.

**Qëllimi i nismave dhe impakti i dëshiruar:**

- Nisma nr.1: Përmes *Manifestit Rinor*, organizatat rinore dhe forumet politike rinore ngritën zërin se Rinia duhet të jetë protagoniste e së ardhmes së vet, dhe jo vetëm vëzhguese pasive e proceseve të zhvillimit në Shqipëri duke adresuar interesat/prioritetet e tyre si në qeverisjen lokale ashtu edhe në atë qendrore;
- Nisma nr.2: Lidershipi i të Rinjve të Tiranës në kuadër të Metodologjisë së Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisje, në fund të vitit 2013, hartoi *Planin e Veprimit “Të rinjtë – Ofruesit e Shërbimeve”*, si një mekanizëm për të ndikuar drejtpërsëdrejti në politikat rinore që hartohen nga aktorë të pushtetit lokal dhe ata qendror;
- Nisma nr. 3: *Kontrata Sociale* ka për qëllim nxitjen e pjesëmarrjes dhe angazhimit të të rinjve gjatë zgjedhjeve lokale 2015, për të adresuar kërkesat prioritare të tyre tek kandidatët dhe të zgjedhurit vendorë.

**Qasja e organizatës:** dy-dimensionale: të rinjtë si bashkëpunëtorë; të rinjtë si nismëtarë.

**Fushat në të cilën u arrit/po arrihet impakti:** Edukim/Studim; Punësim rinor; Të rinjtë në vendim-marrje; Ngritje kapacitetesh; Informim; Integrim gjinor/Barazi Gjinore/Buxhetim Gjinor; Buxhetim Rinor; Integrim i të Rinjve të disavantazhuar/me probleme sociale; Integrim i të Rinjve me aftësi ndryshe; Krijimtari artistike; Kohë e lirë; Hapësira për të rinjtë; Mbrojtje e mjedisit; Të rinjtë e minoriteteve; Shërbime sociale për të rinjtë; Formim profesional; Karta Bashkiake e Studentit; Mbështetje për organizatat rinore të shoqërisë civile; Infrastruktura rrugore dhe sociale; Qendra rinore multifunktionale; Mbështetje për të rinjtë sipërmarrës.

**Hapat kryesore që u ndërmorën:**

**Manifesti Rinor “Rinia Zgjidhja, Jo Problemi”:**

- a) Zhvillimi i disa fokus grupeve me të rinjtë e Lidershipit dhe të rinj të tjerë që jetojnë në qytetin e Tiranës, për të identifikuar dhe priorizuar problematikat më shqetësuese të tyre;
- b) Hartimi i Manifestit Rinor “Rinia Zgjidhja, Jo Problemi” i përbërë nga 5 fusha kryesore në të cilat adresoheshin problematikat më shqetësuese për të rinjtë e Tiranës;
- c) Takim me kryetarët e partive politike për të lobuar/avokuar që Manifesti Rinor të integrohej në programin e çdo partie politike garuese në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2013;

- d) Monitorimi i zbatimit të Manifestit Rinor pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2013;

**Plani i Veprimit “Të Rinjtë-Ofruesit e Shërbimeve”:**

- a) Zhvillimi i disa fokus grupeve me të rinjtë e Lidërshiptit, për të analizuar çdo shërbim të ofruar për të rinjtë në qytetin e Tiranës;
- b) Zhvillimi i intervistave të thelluara me ofruesit e shërbimeve në nivel lokal;
- c) Workshop i Hapur midis të rinjve të Tiranës dhe ofruesve të shërbimeve në nivel lokal për të hartuar së bashku Planin e Veprimit “Të Rinjtë – Ofruesit e Shërbimeve”;
- d) Monitorimi i Lidërshiptit mbi zbatimin e Planit të Veprimit nga ana e ofruesve të shërbimeve në qytetin e Tiranës;

**Kontrata Sociale për të Rinjtë 2015:**

- a) Zhvillimi i tre fokus grupeve me organizatat rinore dhe forumet politike rinore pjesë përbërëse e Lidërshiptit të të Rinjve të Tiranës;
- b) Organizimi i një Takimi të Hapur me të rinjtë e Tiranës ku 10 problematikat e identifikuar/adresuara (në fokus grupet e zhvilluara) u konsultuan në detaj dhe më pas u votuan e u renditën nga 1 – 10, për nga domosdoshmëria dhe rëndësia e zgjidhjes;
- c) Firmosja e Kontratës Sociale nga Kryetarët e Forumeve Politike Rinore në një Takim të Hapur, i pari për nga formati në historinë e demokracisë së Shqipërisë, ku të rinjtë u mbledhën së bashku për të promovuar kauzën e tyre, pavarësisht bindjeve apo partive politike në të cilat aderojnë;
- d) Firmosja e Kontratës Sociale nga çdo kandidat për kryetar Bashkie në qytetin e Tiranës;
- e) Monitorimi i zbatimit të Kontratës Sociale për 4 vitet e ardhshme të drejtimit të bashkisë Tiranë.

**Rezultatet e arritura:**

1. Rritja e Buxhetit Rinor në Buxhetin Afatmesëm 2015 – 2017 të Bashkisë Tiranë;
2. Rritja e Buxhetit për Nxitjen e Punësimit Rinor nga 800 mijë dollarë në vitin 2013, në 1.7 milion dollarë në vitin 2014 dhe 4.7 milion dollarë në vitin 2015;
3. Hapja e Qendrës Rinore Tiranë;
4. Heqja e tarifës për kurset suplementare (përveç kurseve të gjuhëve të huaja dhe kopmjuterit) të cilat ofrohen nga dy Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional nr. 1 dhe nr. 4;
5. Ngritja e Bordit Rinor Këshillimor pranë Këshillit Bashkiak Tiranë, si një strukturë informuese dhe këshilluese ku përfshihen përfaqësues të organizatave rinore, forumeve politike rinore, si dhe këshillave studentore.
6. Rritja e numrit të të rinjve fitues (vendosja e kuotës 30 % në dalje) në listat për kandidat/e në çdo Këshill Bashkiak për zgjedhjet vendore të 21 Qershorit.

### 7.3 Akses në edukimin seksual gjithëpërfshirës

**Organizata zbatuese:** Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin

**Emri i nismës:** Përfshirja e edukimit seksual gjithëpërfshirës dhe aftësive për jetën në kurrikulat mësimore të nivelit parauniversitar, 2010 - vazhdon

**Qëllimi i nismës dhe impakti i dëshiruar:** Akses në edukimin seksual gjithëpërfshirës (i bazuar tek të drejtat dhe i ndjeshëm ndaj faktorit gjini) për të rinjtë në mbarë Shqipërinë. Të rinjtë në Shqipëri të informohen për të drejtat e shëndetit seksual dhe riprodhues, të fuqizohen për të marrë vendime rreth shëndetit të tyre dhe të aftësohen për të vepruar.

**Qasja e organizatës** - tre dimensionale: të rinjtë si grup i synuar; të rinjtë si bashkëpunëtorë; të rinjtë si nismëtarë.

**Fushat në të cilën u arrit impakti:** Edukim/Studim; Ngritje kapacitetesh; Informim; Shëndet seksual dhe riprodhues; Integrim i të rinjve të disavantazhuar/me probleme sociale; Integrim i të rinjve me aftësi ndryshe; Vullnetarizëm; Hapësira për të rinjtë.

**Hapat kryesore që u ndërmorën:**

- a) Advokim tek Ministria e Arsimit për të zyrtarizuar ofrimin e edukimit seksual gjithëpërfshirës në sistemin arsimor parauniversitar;
- b) Pas miratimit të urdhërit të vitit 2012, në bashkëpunim me Institutin e Zhvillimit të Arsimit (IZHA) janë hartuar kros-kurrikula (ndërdisciplinore-përfshirja e edukimit seksual në disa lëndë si edukimi shëndetësor, edukimi fizik, biologjia etj.) për klasat 4-5, 6-7, 8-9;
- c) Deri në vitin 2016 pritet të hartohen kros-kurrikulat për klasat 10-11-12, miratimi zyrtar i këtyre moduleve si edhe trajnimi i mësuesve, psikologëve, punonjësve social etj. në nivel kombëtar;
- d) Paralelisht, QSHPZH ka ofruar edukim joformal të lidhur më seksualitetin e të rinjve në shkolla dhe jashtë tyre duke organizuar seminare, trajnime, takime, fushata për të rritur ndërgjegjësimin/informimin për këtë çështje në komunitetin e prindërve, mësuesve, liderave të shoqërisë, medias etj.

**Rezultatet e arritura:** Aktualisht hartimi i moduleve, testimi i tyre dhe trajnimi i profesionistëve të cilët janë të përfshirë në edukimin e të rinjve që po koordinohet me IZHA. Procesi po planifikohet hap pas hapi dhe të rinjtë do të vazhdojnë të jenë pjesë e promovimit të nismës dhe zbatimit e monitorimit të saj.



## 7.4 Të rinjtë e Durrësit të përfaqësuar në nivel lokal

### **Organizata zbatuese: Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile (CSDC) Durrës**

**Emri i nismës:** Institucionalizimi i Komisionit Këshillimor Rinor dhe fushata e avokimit për buxhetin e rinisë (Shtator - Dhjetor 2014)

**Qëllimi i nismës dhe impakti i dëshiruar:** Rritja e përfaqësisë së të rinjve të Durrësit në nivel lokal në të gjitha fazat e vendim-marrjes e hartimit të politikave për të rinjtë.

**Qasja e organizatës - tre dimensionale:** të rinjtë si grup i synuar; të rinjtë si bashkëpunëtorë; të rinjtë si nismëtarë.

**Fusha në të cilën u arrit impakti:** Ngritje kapacitetesh; Informim; Vullnetarizëm; Hapësira për të rinjtë;

#### **Hapat kryesore që u ndërmorën:**

- a) Planifikimi i fushatës së avokimit për adresimin e problematikave rinore në qytetin e Durrësit;
- b) Takime të Grupit Rinor Durrës me përfaqësues të ofruesve të shërbimeve në nivel lokal;
- c) Kërkesë drejtuar Bashkisë Durrës për njohjen e Komisionit Këshillimor Rinor, ngritja e Qendrës Burimore për të Rinjtë, krijimi i një zëri më vete për të rinjtë në buxhetin e bashkisë, ngritja e info point etj;
- d) Fushata avokimi në median lokale të shkruar dhe vizive;
- e) Takim i hapur i të rinjve të qytetit të Durrësit në datën 8 Dhjetor 2014, Ditën e Rinisë për adresimin e problematikave rinore;
- f) Firmosja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit nga Kryetari i Bashkisë Durrës dhe Komisioni Këshillimor Rinor (KKR).

#### **Rezultatet e arritura:**

- U arrit firmosja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet kryetarit të Bashkisë Durrës dhe Komisionit Këshillimor Rinor (KKR). Përmes kësaj marrëveshje u institucionalizua njohja e KKR, si partner kyç konsultativ dhe këshillimor për çështjet rinore;
- Gjithashtu, institucioni i Bashkisë Durrës merr angazhimin për të mbështetur me ambiente të aksesueshme për të rinjtë për të hapur një Qendër Rinore.

## 7.5 Përmirësimi i jetës së të rinjve në qytetin e Pukës përmes pjesëmarrjes

**Organizata zbatuese:** Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë

**Emri i nismës:** Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen dhe Buxhetimi me Pjesëmarrje, 2013-2014

**Qëllimi i nismës dhe impakti i dëshiruar:** Rritja e ndjeshmërisë së ofruesve të shërbimeve ndaj përmirësimit të jetës së të rinjve në qytetin e Pukës. Të rinjtë të dinë të përcaktojnë nevojat prioritare për përmirësimin e jetës së tyre.

**Qasja e organizatës - dy dimensionale:** të rinjtë si grup i synuar; të rinjtë si bashkëpunëtorë;

**Fusha në të cilën u arrit impakti:** Edukim/Studim; Punësim; Ngritje kapacitetesh; Informim; Integrim gjinor/ Barazi Gjinore/ Buxhetim Gjinor; Kohë e lirë; Vullnetarizëm; Hapësira për të rinjtë;

**Hapat kryesore që u ndërmorën:**

- a) Takime informuese me stafin e nismës, ofruesit e shërbimeve dhe të rinjtë;
- b) Vlerësimi i shërbimeve ekzistuese nga të rinjtë;
- c) Vlerësimi i shërbimeve nga vetë-ofruesit dhe krahasimi i vlerësimeve;
- d) Përgatitja e planit të veprimit nga ofruesit e shërbimeve dhe të rinjtë, si dhe monitorimi i zbatimit të këtij plan-veprimi përgjatë 2014;
- e) Për buxhetimin me pjesëmarrje u bënë takime informuese dhe më pas u intervistuan grupe të ndryshme për nevojat e tyre dhe të komunitetit për përfshirje në buxhetin vjetor.

**Rezultatet e arritura:**

- Përmirësim i kushteve të infrastrukturës, mësimdhënies, shtimi i informacionit të përditësuar mbi vendimet në lidhje me të rinjtë;
- Të rinj më të informuar dhe të përgatitur për identifikimin e nevojave dhe më të aftë për të kërkuar përmirësimin e kushteve të shkollave dhe hapësirave që mundësojnë aktivitet sa më të pasur shkollor;
- Listimi i nevojave të të rinjve në planin e prioriteteve të bashkisë në parashikimin e buxhetit për Vitin 2015 dhe në buxhetin 2015 – 2017.
- Ndjekja e mbledhjeve të këshillit të bashkisë nga të rinjtë ka bërë që vendim-marrësit të jenë më të ndjeshëm ndaj problemeve që shqetësojnë të rinjtë e sotëm në qytetin e Pukës ku papunësia e të rinjve është problem kryesor.

## 7.6 Ngritja dhe monitorimi i legjislacionit lokal për të rinjtë në qytetin e Vlorës

**Organizata zbatuese:** Qendra Rinore e Vlorës, Vlorë

**Emri i nismës:** Hartimi, realizimi dhe monitorimi i Strategjisë së Rinisë në qarkun e Vlorës për periudhën 2013-2020 dhe Planit Lokal të Veprimit për Rininë në Bashkinë Vlorë për periudhën 2013-2015, *Periudha e zbatimit:* Janar 2012- Dhjetor 2015

**Qëllimi i nismës dhe impakti i dëshiruar:** Ngritja e legjislacionit lokal për të rinjtë në Qarkun Vlorë dhe monitorimi i legjislacionit nëpërmjet Planit të Veprimit në Bashkinë Vlorë

**Qasja e organizatës - tre dimensionale:** të rinjtë si grup i synuar; të rinjtë si bashkëpunëtorë; të rinjtë si nismëtarë.

**Fusha në të cilën u arrit impakti:** Edukim/Studim; Punësim; Ngritje kapacitetesh; Informim; Shëndet seksual dhe riprodhues; Integrim gjinor/ Barazi Gjinore/ Buxhetim Gjinor; Integrim i të rinjve të disavantazuar/me probleme sociale; Krijimtari artistike; Kohë e lirë; Vullnetarizëm; Hapësira për të rinjtë; Promovim i identitetit/ trashëgimisë kulturore; Mbrojtje e mjedisit.

**Hapat kryesore që u ndërmorën:**

- a) Realizimi i një studimi lokal mbi problematikat rinore në qytetin e Vlorës;
- b) Realizimi i strategjisë dhe planit lokal të veprimit;
- c) Shkrimi i strategjisë dhe planit lokal të veprimit, si dhe lobim me autoritetet lokale për aprovimin e dy dokumentave të mësipërm;
- d) Miratimi nga anëtarët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe nga anëtarët e Këshillit Bashkiak të Vlorës në mënyrë ligjore dhe institucionale;
- d) Monitorim i Planit të Veprimit për Bashkinë Vlorë, për vitin 2014 dhe 2015, nëpërmjet disa mënyrave monitorimi të ndërthurura me njëra-tjetrën, sic janë Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen dhe Buxhetimi me Pjesëmarrje;
- e) Përgatitja e raporteve periodike të monitorimit të Planit të Veprimit dhe informimi i të rinjve rreth gjetjeve të monitorimit, ndërgjegjësimi i strukturave lokale mbi rritjen e fondit për aktivitete rinore.

**Rezultatet e arritura:**

- Ngritje e legjislacionit lokal në fushën e rinisë në Qarkun dhe Bashkinë e Vlorës; Ngritje e mekanizmave të monitorimit mbi politikën rinore në nivel lokal;
- Fuqizimi i grupeve rinore për t'u përfaqësuar dhe për të kërkuar më shumë të drejta lokalisht;
- Ngritje e kapaciteteve rinore nëpërmjet trajnimeve, rrjetëzimeve dhe aktiviteteve të vazhdueshme në Vlorë.

## 7.7 Të rinjtë e zonave informale të Tiranës, aktorë vendim-marrës

**Organizata zbatuese:** Shoqata për Integrimin e Zonave Informale (SHIZI)

**Emri i nismës:** Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen, 2013 - 2014

**Qëllimi i nismës dhe impakti i dëshiruar:** Qëllimi i kësaj nisme është nxitja e të rinjve për tu përfshirë në vendim-marrje në nivel lokal.

**Qasja e organizatës – dy dimensionale:** Të rinjtë si grup i synuar; Të rinjtë si bashkëpunëtorë

**Fusha në të cilën u arrit impakti:** Edukim/Studim; Ngritje kapacitetesh; Informim; Kohë e lirë; Vullnetarizëm.

**Hapat kryesore që u ndërmorën:**

- a) Krijimi i rrjetit të të rinjve të përfshirë në këtë iniciativë;
- b) Trajnimi i të rinjve mbi procesin e Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen;
- c) Zhvillimi i takimeve për identifikimin e problematikave;
- d) Zhvillimi i takimeve publike midis përfaqësuesve të autoriteteve lokale dhe të rinjve;
- e) Nisja e procesit të monitorimit dhe lobimit për përmbushjen e premtimeve të autoriteteve lokale.

**Rezultatet e arritura:**

- Të rinjtë kanë hartuar një plan të përbashkët veprimi me autoritetet lokale të Bathores dhe Paskuqanit duke iu përmbajtur pikave kryesore të VKQ-së. Pikat kryesore të planit të veprimit kishin të bënin me përfshirjen e të rinjve në vendim-marrjen lokale;

Disa nga rezultatet e planit të veprimit të hartuar nga të rinjtë dhe autoritetet lokale ishin:

- Disa të rinj janë përfshirë si anëtarë të bordit këshillues të qytetarëve;
- Në diskutimet që janë zhvilluar për Plan Buxhetin e Komunës morën pjesë të rinj të cilët ngritën çështjet që shqetësojnë ata;
- Gjithashtu gjatë hartimit të planit të akiviteteve kulturore janë përfshirë edhe të rinjtë.

## 8. Përfundime

Qëllimi i këtij studimi ishte të ofronte një pasqyrë të çështjeve që lidhen me rininë në Shqipëri dhe veçanërisht me pjesëmarrjen e të rinjve në politikë e vendim-marrje. Sipas të dhënave të mbledhura e të analizuara në këtë studim rezultoi se:

1. **Ndonëse Shqipëria ka bërë hapa përpara në drejtim të demokratizimit të jetës së saj politike, këto hapa nuk janë shoqëruar me nisma ligjore për të mbështetur pjesëmarrjen e të rinjve.** Pavarësisht se e drejta e organizimit, e zgjedhjes, e shoqërimit, e fjalës dhe e shprehjes, në Kushtetutën e Shqipërisë janë njohur si të drejta kushtetuese, legjislacioni kuadër nuk është zhvilluar më tej. Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë ka vendosur një kuotë gjinore minimum për gratë dhe vajzat, por ai *nuk zbaton ndonjë kuotë për pjesëmarrjen e të rinjve në vendim-marrje.* Ndërkohë as Ligji “Për Partitë Politike në Shqipëri” nuk përmban ndonjë referencë për të rinjtë në këtë drejtim. Gjatë viteve të fundit ka patur disa tentativa për nisma ligjore si *përgatitja e një projekt-Ligji “për Rininë” apo për “Vullnetarizmin”,* megjithatë deri në momentin e finalizimit të këtij studimi asnjë nismë e tillë nuk ishte miratuar në Kuvendin e Shqipërisë;
2. **Shqipëria ka ndërtuar një imazh deri diku pozitiv në drejtim të përgatitjes së politikave kombëtare për të rinjtë, përfshi edhe pjesëmarrjen e tyre në politikë dhe vendim-marrje.** *Duke nisur nga viti 2005 e në vijim, vendi gjithnjë ka patur të miratuar një Strategji Kombëtare për të Rinjtë dhe respektivisht edhe një Plan Kombëtar Veprimi.* Megjithatë është e vështirë të analizosh impaktin që kanë patur këto Strategji, pasi asnjëherë nuk ka patur një analizë të detajuar të zbatimit të tyre, buxhetit të dhënë dhe arritjeve ndër vite. *Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020 (PKVR) është një përpjekje serioze ndër-sektoriale për të ndërtuar një politikë të re për mbështetjen e të rinjve në Shqipëri.* Plani ndër të tjera ka si objektiv edhe nxitjen e pjesëmarrjes të të rinjve në proceset/vendim-marrjet demokratike. Në tërësi mund të thuhet se PKVR është një përpjekje e mirë dhe serioze për ndërtimin e politikave publike për/dhe me të rinjtë, përfshi edhe caktimin e objektivave strategjike për nxitjen e pjesëmarrjes të të rinjve në vendim-marrjen publike dhe në politikëbërje. Sidoqoftë, aspektet pozitive të Planit mund të kenë tendencën të zbehen për shkak të mos-caktimit të objektivave apo aktiviteteve të angazhimit publik dhe dialogut me partitë politike në vend, mos ndryshimit të Kodit Zgjedhor për ta kthyer kuotën 20% në një kuotë kombëtare, mungesës së buxhetit për të mbështetur krijimin e një platforme civile dhe politike rinore dhe mungesës së një strukture rinore të pavarur kombëtare që të monitorojë në mënyrë periodike zbatimin e masave të Planit;

3. **Të gjitha partitë politike në Shqipëri, në statutet e tyre parashikojnë role dhe përgjegjësi specifike për forumet rinore, pavarësisht se në disa prej tyre këto funksione janë të limituara apo në raste të tjera të vendosura nëpërmjet zbatimit të kuotave.** Studimi i këtyre funksioneve na tregon se sa të dedikuara janë partitë drejt garantimit të pjesëmarrjes të të rinjve në strukturat e brendshme vendim-marrëse. Në këtë këndvështrim mundësitë dhe hapësirat, të vogla apo të mëdha, që të rinjtë të marrin pjesë në parti dhe forume rinore, janë tregues i demokracisë së brendshme të partisë, por jo vetëm; ato na tregojnë se sa e rëndësishme është rinia dhe avancimi i të rinjve për vetë partitë në Shqipëri;
4. Forumet rinore luajnë role të ndryshme brenda partive ku janë krijuar. **Në aspektin e ngushtë statutor, pjesës më të madhe të forumeve politike të të rinjve, ju caktohen role dhe funksione të kufizuara të pjesëmarrjes në strukturat dhe proceset vendim-marrëse, ndërsa për një pjesë të vogël funksionet janë të gjera dhe përfshijnë të gjitha nivelet e vendim-marrjes.** Ato janë të përfshira *thujse që të gjitha në kryesitë qendrore të partive të tyre.* Ndërkohë shohim se roli i forumeve vjen duke u zvogëluar kur vjen puna tek përfshirja e të rinjve në listat e deputetëve, seksionit bazë të partisë apo burimeve financiare që garantojnë funksionimin e forumit rinor politik. Roli vendor i forumeve rinore, është i kufizuar dhe përgjithësisht vetëm i fokusuar në garantimin e pjesëmarrjes të një të riu/të reje në organet drejtuese lokale të partisë, kurse *në disa raste statutet e partive nuk parashikojnë asnjë lloj roli të forumit rinor në nivelin e kryesisë së partisë së rrethit apo edhe qarkut.* Vetë anëtarët e FRPP-ve janë të ndërgjegjshëm për rolin e tyre të domosdoshëm për partitë përkatëse por këtë rol e shikojnë të lidhur ngushtë me fushatat parazgjedhore apo mitingjet që zhvillojnë partitë politike për kauza të caktuara, pra kryesisht në nivel aktivitetesh. Ndërkohë, të rinjtë e partive politike *ndjehen shpesh të përjashtuar nga ndarja e fitores edhe me ta,* për shkak të individualizimit të kësaj të fundit nga individët që ia dalin të bëhen pjesë e vendim-marrjes, duke zbehur rolin e rëndësishëm të grupit mbështetës;
5. **Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i të rinjve në listat e kandidatëve për në Kuvendin e Shqipërisë dhe për këshilltarë në Këshillat Bashkiakë është i një rëndësie të veçantë, jo vetëm për të rinjtë, por edhe për demokratizimin e institucioneve publike të zgjedhura** dhe përçimin e nevojave të të rinjve në çdo vend ku vendoset për ta. Megjithatë, nuk duhet të çudisë askënd fakti që asnjë forum rinor politik nuk ka asnjë vend të paracaktuar aty ku edhe përfaqësimi dhe pjesëmarrja e tyre është më e rëndësishme, në Kuvend dhe në Këshilla Bashkiakë. *Në asnjë statut nuk u gjet ndonjë referencë që mund të garantonte një minimum të mundshëm të përfaqësimit të të rinjve në Kuvend, Qeveri dhe Këshilla Bashkiakë.* Për shembull, përgatitja e listave për zgjedhjet vendore është një procedurë që gjen zbatim ndryshe nga partia në parti. Janë të pakta rastet kur listat për zgjedhjet vendore për kandidatët për kryetarë bashkish e komunash vendosen në bashkëpunim me forumin rinor, përmes një procedure transparente dhe gjithëpërfshirëse. Ndonëse në dukje kjo mungesë

nuk duket e qëllimshme, për më tepër që forumet e të rinjve janë shpesh pjesë e vendim-marrjes në parti kur këto çështje diskutohen dhe miratohen, *impakti që një mungesë e tillë përfaqësimi dhe pjesëmarrjeje ka tek të rinjtë është negativ*. Në këtë kuptim, të rinjtë e partive politike, për shkak të konjunkturave politike, kanë shumë herë më pak mundësi për të luajtur një rol pro-aktiv dhe influencuar ligjet, politikat dhe programet e reja, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel lokal. Për më tepër që ky rol i kufizuar iu jep shumë herë më pak mundësi atyre që të përgatiten për pjesëmarrjen e ardhshme të tyre në ligj dhe politikëbërje, krahasuar me të rinjtë që vijnë nga organizatat e shoqërisë civile, ku këta të fundit kanë mundësi më të mëdha për të ushtruar rolin e tyre;

6. **Një aspekt që ka një impakt negativ të pamatshëm tek Forumet Rinore është varësia e tyre financiare dhe mospasja e burimeve të mjaftueshme të financimit.** Pavarësisht rolit, fuqisë, aksesit në fonde apo madhësisë së partisë, një fakt shqetësues është mungesa e patjes së buxhetit të veçantë për çdo Forum Rinor. *Në asnjë nga Statutet e partive politike, në pjesën ku rregullohen aspektet e menaxhimit financiar, nuk përmendet se cilat janë burimet e financimit apo sesi do të financohen Forumet Rinore nga buxheti i partisë. Mungesa e buxhetit statutor, është një pikë nevralgjike për fuqizimin e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të të rinjve në vendim-marrjen e brendshme të partisë, pasi forumet rinore nuk kanë burime të mjaftueshme të mbështesin anëtarët e tyre me trajnime, aktivitete formuese apo edhe mbështetjen e aktiviteteve në komunitetet ku ata jetojnë. Mungesa e financimeve për forumin rinor, vjen jo vetëm si pasojë e burimeve të kufizuara financiare që një pjesë e mirë e partive politike kanë, por edhe për shkak të tendencës për të mbajtur nën kontroll çdo aspekt të organizimit të aktiviteteve nga ana e të rinjve të forumeve politike rinore në Shqipëri;*
7. Të rinjtë e partive politike i gjejnë të përfaqësuar në strukturat partiake përmes Forumeve Rinore. Ka raste kur të rinjtë e këtyre forumeve *kanë modele pozitive të përfshirjes në nivele të larta vendim-marrëse si qeveri apo parlament. Sidoqoftë, numri i të rinjve në nivelin qëndror dhe ekzekutiv të qeverisjes mbetet ende i vogël, me numra sporadikë të të zgjedhurve në poste të rëndësishme ekzekutive apo në pushtetin legjislativ (parlament). Niveli lokal njih po të njëjtën situatë,* ku kemi përfaqësim të të rinjve, por ai mbetet ende mjaft i rrudhur dhe nuk i targeton të rinjtë si një grup i veçantë me interesa të ndryshëm. Është e qartë që *rrugëtimi drejt suksesit në vendim-marrje e politikëbërje për të rinjtë është me shumë pengesa, kërkon shumë përkushtim dhe shpesh nuk konkretizohet sipas pritshmërive të të rinjve. Megjithatë të dhënat na tregojnë se përçindja e të rinjve në struktura vendim-marrëse dhe politikëbërëse është mjaft e ulët, liderët e FRPP-ve janë optimistë në lidhje me përfshirjen e tyre në strukturat e partisë;*

8. **Sipas të rinjve, problematika më e madhe me të cilën ata përballen është *filozofia e anëtarëve tradicionalë të partive politike*, gjë që e pengon shpesh ecurinë e tyre dhe e bën më të vështirë rrugën drejt politikës apo vendim-marrjes në të gjitha nivelet.** *Perceptimet rreth pengesave konkrete të të rinjve për t'u përzgjedhur, lidhen drejtpërdrejt me faktin që të rinjtë kanë mungesë përvoja dhe të shprehive profesionale ndaj nuk mund të marrin përsipër pozicione të rëndësishme në vendim-marrje e politikëbërje. Paragjykimet lidhur me moshën e re dhe mungesën e eksperiencës bëjnë që fjala e të rinjve të mos dëgjohet apo respektohet sa ç'duhet, si rrjedhojë të mos konsiderohen për pozicione vendim-marrëse;*
9. Dinamikat brenda partive janë deri diku të pritshme. Tek partitë e mëdha respektohet me më shumë rigorozitet *hierarkia e brendshme* pasi këto parti e kanë të detyrueshëm zbatimin e hierarkisë për shkak të numrit të madh të anëtarëve. **Nga ky studim rezultoi se *sa më e vogël të jetë një parti, aq më fleksibël janë hallkat hierarkike brenda partisë dhe aq më i lehtë është komunikimi i drejtpërdrejtë i anëtarëve të forumit rinor me drejtuesit më të lartë të vetë forumit apo partisë.*** *Brenda forumeve rinore ngrihen shumë çështje nga anëtarët e forumit dhe disa prej këtyre çështjeve përcillen nga kryetarët e grupeve në mbledhjet e kryesive të forumit. Çështjet që ngjallin më shumë interes dhe nuk bien në kundërshtim me politikat e partisë, përcillen nga kryetarët/et e forumeve në kryesinë e partisë për të vijuar me adresimin e çështjes në nivelet më të larta;*
10. **Çështjet e të rinjve *jo gjithmonë marrin vëmendjen që meritojnë nga strukturat vendim-marrëse e politikëbërëse*, si kryesitë e partive, parlament, qeveri, dhe këshilla bashkiakë dhe ky përbën një fakt mjaft shqetësues. Në nivelin e qeverisjes qëndrore e vendore ngrihen e adresohen shumë pak çështje të të rinjve.** *Drejtuesit e FR-ve janë të mendimit se shumë pak nga ato që janë kërkuar janë bërë realisht, pasi promovimi i të rinjve, apo çështjet rinore nuk janë prioritet për ata që janë përzgjedhur;*
11. **Deri më sot, *bashkëpunimi mes FRPP-ve të partive të ndryshme politike në kauzën rinore, ka qenë inekzistent dhe shihet si problematikë mjaft e rëndësishme për t'u adresuar.*** *Të rinjtë ndjejnë mungesën e organizimit të grupeve rinore pavarësisht përkatësisë politike me qëllim mbështetjen e të rinjve që synojnë të angazhohen në vendim-marrje dhe politikëbërje. Iniciativa të tilla mbështetëse për kauzën e rinisë janë thjesht të organizuara nga Shoqëria Civile dhe kanë pak ndikim tek partitë politike;*
12. **Angazhimi në shoqëri civile si një urë drejt vendim-marrjes e politikëbërjes shihet si një mundësi e të rinjve që janë të angazhuar në shoqërinë civile.** *Shumë shpesh ky kalim paragjykohet dhe ky paragjykim i pengon ata që kanë zgjedhur shoqërinë*



civile, për të kaluar në politikë. Pavarësisht kësaj, përfshirja e disa figurave publike të shoqërisë civile në pushtetin ekzekutiv përbën një model pozitiv;

13. **Mungesa e dëshirës, pasiviteti konformist dhe mosdëshira për të prishur konfortin personal janë ndër elementët më të zakonshëm me të cilët përballen të rinjtë e të gjitha niveleve dhe që pengojnë iniciativat e tyre për të ngritur çështje të cilat janë në interes të tyre.** Praktikën apo përpjekjet e mëparshme demotivuese lidhur me iniciativa rinore të dështuara apo raste të përfshirjes të të rinjve në vendim-marrje, u largojnë të rinjve dëshirën dhe motivimin për t'u angazhuar në pozicione vendim-marrëse apo politikëbërëse. Ndërkohë që shpërndarja e parrjetëzuar e informacionit e vështirëson pjesëmarrjen e të rinjve në këshilla, borde këshillimore, etj, si një praktikë e cila mund të zgjerohet më tej edhe në nivel politik apo të shoqërisë civile.

## 9. Rekomandime

Bazuar në analizën e gjetjeve sasiore e cilësore të këtij studimi, si dhe proceset konsultative me të rinjtë e forumeve rinore të partive politike dhe të rinjve të shoqërisë civile si dhe intervistat me të rinj të suksesshëm në vendim-marrje e politikëbërje, dolën një sërë sugjerimesh të cilat janë të listuara më poshtë në formë rekomandimesh konkrete, për t'u mbajtur parasysh si nga kuvendi, qeveria, strukturat politikëbërëse e vendim-marrëse brenda partive politike, në nivel vendor dhe qëndror, por edhe nga vetë të rinjtë e forumeve rinore të partive politike e organizatave rinore të shoqërisë civile.

### PËR KUVENDIN

1. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i të rinjve është i një rëndësie primare për demokracinë në një vend si edhe për përgatitjen e kadrove dhe drejtuesve të ardhshëm politikë. Në këtë drejtim Kuvendi i Shqipërisë duhet të shohë me prioritet **miratimin e ligjeve "për Rininë" dhe për "Vullnetarizmin"**, ndërkohë që duhet të shihet çdo mundësi që në ndryshimet e ardhshme që mund t'i bëhen Kodit Zgjedhor të përfshihet edhe **vendosja e një kuote minimum prej 20%** për të rinjtë si kandidatë për deputetë dhe anëtarë të këshillave bashkiakë. Duke hartuar **nene të posaçme me penalitete që detyrojnë partitë të respektojnë kuotën për të rinjtë**, dekurajohen kështu manovrat e ndryshme që përdoren për t'i vendosur të rinjtë në fund të listave, siç ka ndodhur me kuotën gjinore;
2. Përfshirja shumë më e përqendruar e çështjeve dhe problematikave rinore në **axhendën parlamentare**, me fokus të veçantë edukimin dhe punësimin e të rinjve. Interesi për të adresuar çështjet rinore duhet të jetë i **sinqertë** dhe jo i orientuar nga interesa të momentit apo për thithje fondesh që më pas ri-alokohen për çështje të tjera;

3. Krijimi i **Aleancës së Deputetëve të Rinj** me qëllim krijimin e një grupimi të mirë-organizuar politikëbërësish të rinj që adreson çështjet rinore duke i ngritur ato në struktura vendim-marrëse si Komisionet e Ligjeve, Parlament, etj. Kjo Aleancë mund të bashkëpunojë ngushtësisht me strukturat drejtuese të FRPP-ve për të marrë feedback të përditësuar lidhur me problematikat që prekin të rinjtë;
4. **Përmirësimi i klimës dhe diskursit politik**, që kultivojnë përçarje, urrejtje, distancim të të rinjve nga politika, me qëllim nxitjen e të rinjve për të marrë pjesë në politikë. Është shumë i rëndësishëm krijimi i një mjedisi miqësor brenda dhe midis partive që reflekton pjekuri politike, bazuar mbi vlera e parime të shëndosha, në mënyrë që të rinjtë të fillojnë ta shohin politikën me besim dhe si një mjet në dobi të interesit publik;

## PËR QEVERINË

5. **Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020** (PKVR) është një përpjekje serioze ndër-sektoriale e Qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për të ndërtuar një politikë të re për mbështetjen dhe fuqizimin e të rinjve në Shqipëri. Qeveria shqiptare duhet të shoh me prioritet *alokimin e duhur dhe të të gjitha fondeve që kërkohen për të bërë të mundur zbatimin* e tij. Nga ana tjetër Qeveria dhe MMSR duhet të shohin me prioritet *zbatimin e këtij Plani nga organizatat e shoqërisë civile dhe forumet politike rinore*, duke i financuar ato për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve të Planit;

## PËR PARTITË POLITIKE

6. Në funksion edhe të domosdoshmërisë së rinovimit të kuadrit politik në partitë politike, por edhe për të nxitur edhe më tej pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e të rinjve në partitë politike në Shqipëri, duhet parë me prioritet ***vendosja e kuotave rinore për çdo strukturë drejtuese dhe vendim-marrëse brenda partive***. Vendosja e kuotave, ndonëse në dukje një masë artificiale, aty ku është zbatuar ka treguar se mund të arrijë rezultate pozitive si për vetë të rinjtë, ashtu edhe për partitë dhe avancimin e tyre politik. Në këtë drejtim *krijimi i akademive politike të të rinjve brenda partive politike* mundet që të nxisë edhe më tej një bashkëpunim midis të rriturve dhe të rinjve, si një mjet për shkëmbimin e eksperiencave, por edhe forcimit të sinergjive midis strukturave dhe kuadrove brenda partive politike;
7. Strukturat dhe elitat politike në çdo Parti Politike, kanë nevojë të mendojnë seriozisht për ***gjetjen dhe zbatimin e modeleve të reja të financimit të forumeve politike të të rinjve***. Fuqizimi politik i të rinjve nuk mund të bëhet nga forume rinore të dobëta që varen për çdo financim tek drejtuesi kryesor i partisë. Në këtë drejtim rekomandohet *krijimi i një zëri të veçantë në buxhetin vjetor të partisë për Forumin Rinor*, i cili duhet të menaxhohet nga vetë të rinjtë. Krijimi i mundësive të vërteta për pavarësinë financiare të forumeve rinore, është një tregues i pjekurisë jo vetëm i

forumeve të të rinjve, por për më tepër i partive politike dhe drejtuesve të tyre. Një mundësi mund të jetë *ndarja e një fondi nga vetë KQZ-ja* për këtë qëllim, njëloj siç operohet me partitë. Në të njëjtën kohë *Forumet Rinore politike duhet të studiojnë mundësinë që të regjistrohen si OJF, por të aderuar pranë partisë së tyre*, si një mundësi për të rritur mundësitë e tyre të financimit nga burime të ligjshme si brenda ashtu edhe jashtë vendit;

8. *Rregullimi i të gjitha FRPP-ve me **statute apo rregullore të brendshme** të formalizuara, që reflektojnë të gjitha hapat e mirë-funksionimit të FR-së, procedurat që duhet të ndiqen në procese konsultative e vendim-marrëse, marrëdhënien e varësisë/pavarësisë me partinë, e çdo kriter tjetër rregullues që lidhet me FRPP-në;*
9. ***Përkrahja dhe inkurajimi i të rinjve** që dëshirojnë të përfshihen në vendim-marrje e politikëbërje duke u dhënë mundësi të rinjve të jenë të përfaqësuar në çdo nivel politik, jo vetëm në bazën e partisë por edhe në strukturat më të larta duke filluar me qeverisjen lokale si në këshilla bashkiakë e deri në parlament. **Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar përfshirjes së domosdoshme të të rinjve të minoriteteve** dhe të rinjve nga shtresa të përjashtuara sociale, duke u dhënë mundësinë që të jenë një zë real në politikë-bërje dhe në vizionin politik të partive, duke adresuar rrjedhimisht problematikat e tyre në të gjitha nivelet. Përpos kësaj, *proceset konsultuese nga partia në të gjitha nivelet duhet të jenë gjithëpërfshirëse* duke përfshirë sa më shumë të rinj, sidomos kur çështjet kanë lidhje me rininë, pasi të rinjtë e dinë më mirë se kushdo se ç'është më e mirë për ta dhe janë të interesuarit parësorë;*
10. *Duhet adresuar medoemos **pasiviteti dhe apatia e të rinjve në angazhimin politik**, duke filluar që nga përmirësimi i treguesve të pjesëmarrjes aktive të të rinjve në zgjedhje, përmirësim lidhur me pjesëmarrjen e të rinjve në hartimin e politikave lokale e qendrore, nëpërmjet angazhimit të tyre në struktura këshillimore, këshilla të njëjësive vendore, etj. Gjithashtu është rrënjësore *rritja e ndërgjegjësimit të të rinjve shqiptarë lidhur me **qëndrimet apo zgjedhjet e tyre politike**, duke ju distancuar ndikimit të interesave të ngushta, përfitimeve afatshkurtra, militantizmit, ndikimit nga komuniteti apo familja dhe duke i orientuar ata që të japin kontributin dhe votën e tyre për ide, programe apo platforma politike që adresojnë me ndjeshmëri problematikat e të rinjve dhe të komunitetit të gjerë. Për aq kohë sa vota e të rinjve perceptohet si votë e orientuar nga ndikimet e lartpërmendura dhe jo nga programet e partive, të rinjtë nuk do të përbëjnë një grup që ngjall interes për partitë politike, si lidhur me përfshirjen në politikë, ashtu dhe lidhur me adresimin e çështjeve në interes të tyre;**

## PËR FORUMET RINORE TË PARTIVE POLITIKE

- *Transformimi i FRPP-ve në **struktura fuqizuese e motivuese** për të gjithë të rinjtë e të rejat, përfshirë edhe të rinjtë e minoriteteve dhe ata nga shtresat e përjashtuara*

*sociale*, duke u bërë sa më tërheqëse e kapacitet-ngritëse për ta dhe duke shkuar përtej të konsideruarit të këtyre forumeve si organizma punë-ofrues. *Eliminimi i procedurave fillestare të anëtarësisë në FRPP për të rinjtë*, duke zhdukur formalizmat pengues e duke shtuar gamën e angazhimeve të mundshme të të rinjve, bazuar në interesat e tyre. Procedura e anëtarësimit zyrtar duhet të jetë një hap i mëvonshëm që pason një periudhë reflektimi të të rinjve lidhur me atë çka ofron një FR;

- *Lobimi për hartimin (aty ku s'ka) e një rregulloreje të brendshme/ statuti të FR-së*, të hartuar nga Partia në bashkëpunim me FR-në dhe miratimi i tij duke e bërë më pas transparent për çdo të ri që dëshiron të angazhohet në FR, si dhe *zbatimi me korrektësi i rregullores së brendshme për zgjedhjen e kryetarëve/eve të FR-ve*, nëpërmjet zgjedhjeve të lira e të pakomanduara nga partitë. Gjithashtu nevojitet **rotacion** më i shpeshtë në strukturat drejtuese e organizuese të FRPP-ve, për të angazhuar sa më shumë lider të mundshëm të rinj dhe për të stimuluar angazhimin e vazhdueshëm në strukturat politikëbërëse e vendim-marrëse të partive;
- *Rritja e presionit nga Forumet Rinore ndaj të rinjve në vendim-marrje e politikëbërje* për ngritjen e problematikave rinore, duke ofruar njëkohësisht të gjithë mbështetjen e nevojshme për përfaqësuesit e tyre. **Krijimi i një organizmi për të bërë bashkë zërin rinor të të gjithë FRPP-ve** do të shërbente ndër të tjera si një mjet presioni për të vendosur çështjet rinore në axhendën politikëbërëse dhe për të institucionalizuar kauzën rinore. Bashkimi i të gjithë FRPP-ve njëzëri, do të shërbente gjithashtu si model pozitiv bashkimi mes të rinjve, pavarësisht ndasive politike. *Lehtësimi i procesit të krijimit të këtij organizmi* mund të ndërmerret nga organizatat rinore të shoqërisë civile;

## PËR ORGANIZATAT RINORE TË SHOQËRISË CIVILE

1. *Fokusimi i ndërhyrjeve të organizatave rinore në adresimin e mungesës së informacionit tek të rinjtë*, e cila shihet si një nga problematikat më të rëndësishme për mospërfshirjen e të rinjve në struktura vendim-marrëse, sidomos në zona rurale dhe informale. Rëndësi të veçantë duhet të zërë *shpërndarja e informacionit* tek të rinjtë, duke e bërë atë sa më të rrjetëzuar e mirë-organizuar. Të rinjtë që në moshën e shkollës së mesme dhe sidomos në moshën universitare duhet të jenë në fokus të këtyre ndërhyrjeve informuese rreth angazhimit të mundshëm për përfshirje në vendim-marrje e politikëbërje; *Promovimi i vazhdueshëm i vullnetarizimit* përmes politikave të FRPP-së dhe programeve stimuluese për të rinjtë, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me organizatat rinore të shoqërisë civile;
2. **Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve të të rinjve të shoqërisë civile**, për të ndihmuar siç duhet të rinjtë që të përfshihen në vendim-marrje e politikëbërje.

## Referencat

- Bryman, A., (2007) *Barriers to integrating quantitative and qualitative research*, Journal of Mixed Methods Research, 1, pp. 1-18.
- Creswell, J. W., & Plano Clark, V. L. (2007) *Designing and conducting mixed methods research*. Thousand Oaks, CA: Sage.
- Civitas foundation, UNICEF and the World Bank (2002). *“Youth in the South Eastern Europe”*. New York: Macmillan Press.
- Council of Europe, (2012). *Revisiting Youth Political Participation in Europe*. Council of Europe Publishing, March 2005, Strasbourg.
- Council of Europe, (2000). *Youth participation in Eastern Europe* Council of Europe Publishing, December 2000, Spain.
- Diamond. L. and Morlino. L (2004). *‘The quality of democracy: An overvieë’*. Journal of democracy 15 (4): 20-31.
- Friederich Ebert Stiftung (2012). *Kultura politike e elitës sonë të ardhshme*, Tiranë, fq.8.
- Friederich Ebert Stiftung (2011). *Rinia shqiptare 2011; Mes besimit për të ardhmen dhe dyshimit për të tashmen*. Tiranë, fq. 33.
- Greene, J. and Caracelli, V. (2003). *Making Paradigmatic Sense of Mixed Methos Inquiry*, in *Handbook of Mixed Methods in Social & Behavioral Research*, Tashakkori, A & Teddlie, C. (Eds) 2003, Sage, California.
- Hart, R. (1992). *From Tockenism to Citizenship*, UNICEF International Child Development Centre. Florence.
- Hooghe M., Stolle D., (2005) *Youth organisations within political parties: political recruitment and the transformation of party systems*. Revisiting youth political participation, Council of Europe, Fq. 43-53.
- Instat (2012). *Censusi i popullsisë dhe banesave 2011*. Tiranë.
- Lëvizja Mjaft dhe Instituti Agenda (2012). *Rinia shqiptare: Problemi apo investimi i shkëlqyer: Analizë e politikave Rinore 2012*. Tiranë.
- Kovachev, S. (2000). *Keys to youth participation in Eastern Europe*. Council of Europe Publishing.
- KSHMJ dhe FES,. (2010). *Zgjedhjet dhe Administrimi Zgjedhor në Shqipëri*. Tiranë, fq. 75.
- Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (Prill, 2015). *Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë, 2015-2020*. Tiranë.

- Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile (CSDC), Durrës. (2012). *Angazhimi i të rinjve në jetën publike dhe politike: Perceptime dhe realitete 2012*. Durrës.
- Tashakkori, A & Teddlie, . (2003) *Mixed Methods in Social & Behavioral Research*, T. (Eds), Sage, California.
- UNDP, (2012). *Enhancing Youth Political Participation throughout the Electoral Cycle*.
- UNDP and IPU, (2012). *Global Parliamentary Report*.
- University of Bristol, (2012). *Youth Participation in Europe: Beyond Discourses, Practices and Realities*. Britain, UK.
- Wallace, C & Kovatcheva, S. (1998). *Youth in Society: The construction and Deconstruction of Youth in East and West Europe*.

## Burime Elektronike:

Commonwealth Networks [www.thecommonwealth.org](http://www.thecommonwealth.org)

United Nations <http://www.un.org/esa/socdev/documents/youth/fact-sheets/youth-definition.pdf>

Kuvendi i Shqipërisë, aksesuar në Mars 2015:

[http://www.parlament.al/web/Deputetet\\_sipas\\_qarqeve\\_10029\\_1.php](http://www.parlament.al/web/Deputetet_sipas_qarqeve_10029_1.php)

Ligji 115/2014, datë 31 korrik 2014. [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2014/PDF-2014/137-2014.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/137-2014.pdf)

Ligj Nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për Partitë Politike".

[http://www.parlament.al/web/pub/raport\\_partite\\_politike\\_15557\\_1.pdf](http://www.parlament.al/web/pub/raport_partite_politike_15557_1.pdf)

Kryeministria e Shqipërisë, aksesuar në Mars 2015: <http://www.kryeministria.al/al/qeveria/ministrat>

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, aksesuar në Mars 2015 <http://www2.cec.org.al/sq-al/>

Karta e Pjesëmarrjes së të Rinjve, aksesuar në datë 25 Prill 2015

[https://www.coe.int/t/dg4/youth/Source/Coe\\_youth/Participation/COE\\_charter\\_participation\\_al.pdf](https://www.coe.int/t/dg4/youth/Source/Coe_youth/Participation/COE_charter_participation_al.pdf)

Manual on the Revised European Charter on the Participation of Young People in Local and Regional Life, Council of Europe, February 2008

[https://www.coe.int/t/dg4/youth/Source/Resources/Publications/Have\\_your\\_say\\_en.pdf](https://www.coe.int/t/dg4/youth/Source/Resources/Publications/Have_your_say_en.pdf)

Youth and politics: towards a new model of citizenship in advanced democracies, (fq. 26-27).

[http://pjp-eu.coe.int/documents/1017981/8422373/26\\_chapter\\_3.pdf/36718682-8625-41c4-8082-9b1fdc2f9db8](http://pjp-eu.coe.int/documents/1017981/8422373/26_chapter_3.pdf/36718682-8625-41c4-8082-9b1fdc2f9db8)

Youth, Political Decision-Making and Participation, UNDP, 2013

<http://www.un.org/esa/socdev/documents/youth/fact-sheets/youth-political-participation.pdf>

EACEA 2010/03: Youth Participation in Democratic Life

[http://eacea.ec.europa.eu/youth/tools/documents/lse\\_study\\_on\\_youth\\_participation\\_2013.pdf](http://eacea.ec.europa.eu/youth/tools/documents/lse_study_on_youth_participation_2013.pdf)

Flash Eurobarometer 375, European Youth: Participation in Democratic Life

[http://ec.europa.eu/youth/library/reports/flash375\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/youth/library/reports/flash375_en.pdf)

Youth participation in politics in UK <http://pa.oxfordjournals.org/content/60/4/548.short>

New Voice, Less Equal: The Civic and Political Engagement of Young People in the United States and

Europe <http://cps.sagepub.com/content/47/5/663.full.pdf+html>